

NDARJA E PUSHTETIT
MODEL I RI PËR VENDIMMARRJE NË KOMUNAT
MULTIKULTURORE

Botues:

Asociacioni për Iniciativa Demokratike

Partnerë:

Projekt kordinator: Bekim Abdullahi - Asociacioni për Iniciativa Demokratike
Projekt Oficer: Aleksandar Kërzhalovski - Qendra Maqedonase për Bashkëpunim
Ndërkombëtar
Projekt Asistent: Jovan Ananiev - Qendra për Paqe dhe Demokraci - “Ian Collins”

Kryeredaktor:

Albert Musliu

Redaktor:

Bekim Abdullahi

Ekipi i ekspertëve:

Prof. Dr. Mirjana Maleska – *koordinatore e ekipit, profesore në UEJL - Tetovë*
Prof. Dr. Lidija Hristova – *këshilltare shkencore, Instituti për hulumtime
sociologjike dhe politiko-juridike - Shkup*
Doc. Dr. Jovan Ananiev – *asistent për projekte dhe mësim, Instituti për hulumtime
sociologjike dhe politiko-juridike – Shkup*

Përktheu:

Agim Mustafai

Disejn:

Guinevere Martin

Përgatitja teknike:

Valbon Elmazi

Tirazhi:

600

Shtypi:

Dexel

Autorë:

D-r. Mirjana Maleska - Koordinator i ekipës, profesor në
Universitetin EJL, Tetovë
D-r. Lidija Hristova – Këshilltar shkencor, Instituti për hulumtime sociologjike dhe
politiko-juridike - Shkup
D-r. Jovan Ananiev- docent, Instituti për hulumtime sociologjike
dhe politiko-juridike - Shkup

NDARJA E PUSHTETIT MODEL I RI PËR VENDIMMARRJE NË KOMUNAT MULTIKULTURORE

Raport hulumtues

Shkup, 2006



*Power-Sharing - new concept of decision making process in
multicultural municipalities*

*An EU funded project
Managed by the European Agency for Reconstruction*

PËRMBATJA

PËRSHKRIM	9
I. HYRJE	26
1. Prej konflikti deri në bashkëpunim	26
2. Cilat janë qëllimet e projektit?	28
3. Objekti i hulumtimit: “Ndarja e pushtetit”	29
4. Hipotezat	35
5. Metodologjia	36
II. REZULTATET NGA HULUMTIMI	40
1. Decentralizimi i pushtetit. Shumica si pakicë. Pakicat shumë të vogla	40
1.1. Arsimi si “studim rasti”	46
1.2. . Perceptioni i qytetarëve ndaj opinionit publik për punën e pushtetit komunal	48
2. Participimi politik i pakicave. Pjesëmarrja dhe ndikimi. Simbolet dhe gjuha	52
2.1. Komuna e Kërçovës	56
2.2. Komuna e Gostivarit	67
2.3. Komuna e Strugës	74
2.4. Komuna e Dibrës	83
III. ANEKSET	87
REZYME	94

PËRSHKRIM

1. **Çfarë shoqërie është vendi ynë?** Në titullin e hulumtimit tonë qëndron se është **multikulturore**. Në teorinë politike për shoqëritë të cilat janë ndarë përgjatë vijave etnike flitet si për *shoqëri të ndara ose pluraliste*. Ato janë shoqëritë ku jetojnë më shumë grupe etnike, të cilat dallojnë ndërmjet veti sipas prejardhjes etnike, gjuhës, religjionit, kulturës, dokeve, nivelit ekonomik ose arsimor dhe të cilat kanë parti të veta politike, media, organizata joqeveritare dhe të tjera. Pasi që koncepti **shoqëri e ndarë** menjëherë asocion në konflikt, konsiderojmë se koncepti më adekuat, i cili mund të zbatohet në gjendjen në vendin tonë është **shoqëri pluraliste**. Ky koncept në vete e përmban ndarjen, por njëkohësisht asocion edhe në mundësinë për **bashkëpunim**
2. **“Nuk ka zgjidhje territoriale për konfliktet etnike”:** Marrëveshja paqësore e Ohrit fillon me një mesazh të fortë, i dërguar deri te të gjithë qytetarët e vendit tonë, **se nuk ka zgjidhje territoriale për konfliktet etnike. Ky mesazh ka kuptim vetëm në rast se në mënyrë efikase janë të mbrojtura të drejtat e pakicave në shtet dhe komunë.** Koncepti *të drejtat e pakicave* është komplementar me parimin fundamental të mosdiskriminimit. Të drejtat e pakicave, kështu, mund të definohen si gjenerata ose niveli i dytë i legjislativës jodiskriminuese¹. *Kjo është e rëndësishme të theksohet në çdo rast dhe në çfarëdo mënyrë të afirmohet.* Kënaqësia më e madhe, të cilën e regjistruam gjatë hulumtimit, vjen nga ndjenja e padrejtësisë, jodinjitetit dhe diskriminimit. Thuajse aspak nuk është me rëndësi nëse dikujt i është bërë padrejtësia për shkak të diçkaje të rëndësishme ose për shkak të ndonjë procedure në shikim të parë të pavlefshme e cila është anashkaluar. Kjo është disponimi inicial i cili më pas mbindërton ndjenjën e besimit ose mosbesimit; lojalitetit ose jolojalitetit; bashkëpunimit ose konfliktit.
3. **Locimi i hulumtimit:** Sot, të paktën kur bëhet fjalë për vendet e BE-së dhe atyre të cilat janë në rrugë për t'u bërë të tilla, si vendi ynë, është e pamundur të flitet për qeverisje demokratike në mungesë të participimit efektiv të njerëzve të cilët u takojnë pakicave nacionale në jetën kulturore dhe gjërat publike, sociale dhe ekonomike. **Aspekt kyç i mirëkuptimit modern të të drejtave të pakicave është parimi i participimit të pakicave në procesin e vendimmarrjes për çështje të cilat në mënyrë direkte i tangojnë si në nivel nacional ashtu edhe në nivel lokal.**² Sëkëndejmi, krejt e arsyeshme, objekti i hulumtimit i këtij projekti është përqendruar në komunat multietnike të vendit tonë (Gostivar, Kërçovë, Dibër dhe Strugë, Gostivar, Kërçovë, Dibër dhe Strugë)
4. **Qëllimi themelor i hulumtimit:** “Participimi i plotë dhe efektiv i personave të cilët i takojnë pakicave nacionale (neni 15 nga Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale) nuk është deklaratë politike. Ajo është marrëveshje legale. Vendi ynë është gjithashtu nënshkruese e kësaj marrëveshjeje. Por njëkohësisht ajo është një “dokument i parimeve bazike” për mbrojtjen e pakicave të cilat mund të zbatohen ndryshe në vende të ndryshme në përputhje me situatën e tyre. Plotësimi i fjalës dhe shpirtit të Konventës në

¹ “The concept of minority rights is complementary to the fundamental principle of non-discrimination. One could define minority rights as a second generation-or a second level-of nondiscrimination legislation”, theksohet në më shumë dokumente ndërkombëtare

² “It is not possible to conceive of fully democratic governance in the absence of full and effective participation of persons belonging to national minorities in cultural, social and economic life and in public affairs. Key aspect of modern understanding of minority rights is the principle of participation of minorities in decision-making on the issues directly affecting them”.

vendin tonë është i pamundur pa përcjellje të vazhdueshme të gjendjes, nga komisionet politike dhe eksperte të cilat me raportet e veta do të nxisin dialog për të gjitha problemet.³ Ky Projekt ka pikërisht këtë qëllim: të prodhojë Raport të bazuar mbi monitorimin e procesit të formulimit të politikave në komunat multi-etnike në vendin tonë (Gostivar, Kërçovë, Dibër dhe Strugë), në bazë të së cilës do të hapet dialog në publik dhe lobim për ndryshime pozitive.

5. **Objekti i hulumtimit: “participim i plotë dhe efektiv”.** Në fillim të hulumtimit e parashtruar pyetjen kryesore: Çka është “participimi i plotë dhe efektiv” dhe vallë “participimi i plotë dhe efektiv” ka të bëjë me pakicat në shtet apo me pakicat në nivel lokal? *Fjala dhe shpirti i Konventës Kornizë, të cilat nisen nga e drejta universale për mosdiskriminim, çon në drejtim të njohjes së participimit të plotë dhe efektiv në çdo nivel ku merren vendime të cilat drejtpërdrejt i shqetësojnë pakicat.* Të drejtat nuk mundën automatikisht t’u imponohen personave të cilët i takojnë pakicave nacionale, por ata doemos të kenë të drejtë të zgjedhin a do të jenë më ndryshe të trajtuar ose jo.
6. **Korniza legale e hulumtimit:** Në Raportin eksplanator i cili e shoqëron Konventën kornizë, shtetet inkurajohen që të promovojnë “participim efektiv të personave të cilët u takojnë pakicave nacionale në procesin e vendimmarrjes në të dy nivelet: në organet e zgjedhura në nivel nacional dhe lokal.⁴ Ligji për vetëqeverisje lokale në vendin tonë është hapi fillestar drejt krijimit të kornizës legale, për participim të pakicave në marrjen e vendimeve në komuna. Gjatë hulumtimit erdhëm deri në përfundim se në çfarë drejtimi duhet të zgjerohet ose ndryshohet baza legale për participim efektiv, që do të paraqet bazë për krijimin e opinionit publik dhe lobim në Kuvendin e IRJM-së dhe në komunat.
7. **Definicioni i problemit:** çka është participimi i plotë dhe efektiv i bashkësive pakicë dhe me cilat çështje ka të bëjë? Parimet, anëtarët konkret dhe monitorimi i Konventës kornizë krijuan standarde themelore për atë që nënkuptohet me këtë koncept. *Kjo është pjesëmarrje e pakicave në organet e zgjedhura në nivel lokal dhe qendror në procesin e formulimit të politikave (parashtrimi i qëllimeve të politikës) dhe marrje vendimesh për çështje të cilat drejtpërdrejt i shqetësojnë pakicat si kultura dhe çështjet e gjuhës, arsimin dhe mediave. Por, ky koncept shkon mbi pjesëmarrjen formale dhe e merr parasysh pozitën socio-ekonomike të pakicave.* Do me thënë, participimi efektiv ka dimension të qartë politik, kulturor dhe social. **Ne e hulumtojmë dimensionin politik.**
8. **Zbatimi i modelit në praktikë:** Implementimin e modelit të “ndarjes së pushtetit”, në komunat multi-etnike të vendit tonë, e hulumtuam nga disa aspekte: a) participimi i plotë dhe efektiv i bashkësive pakicë në vendosjen e qëllimeve të politikës në komuna dhe marrja e vendimeve; b) përfaqësimi i drejtë i komuniteteve në administratën komunale,

³ ”In meanwhile, it is “a document of principles”: it offers only basic principles of minority protection that may be implemented differently in different States, according to their concrete situations.

“Compliance of these concrete methods with the letter and spirit of the Framework Convention is verified through monitoring procedures carried out by competent expert body, and improved using constant dialogue, consultations with all parties involved, and taking into account good practices”(eng.)

⁴ (Explanatory Report accompanying the FC), States are encouraged to promote “the effective participation of persons belonging to national minorities in the decision-making process and elected bodies both at national and local level. This formulation would have pointed towards an acknowledgement of special rights of consultation or participation in decision-making of persons belonging to national minorities living in territorially compact areas.(eng.)

- ndërmarrjet publike dhe institucionet dhe c) e drejta e vetos së pakicës, ose e a.q. e drejta e Badenterit (shumica e dyfishtë) dhe d) Komisioni për marrëdhënie ndërnacionale
9. **Modeli i “pakicave shumë të vogla”:** Ky Projekt, do të thotë, merret me një fenomen politik *par excellence*: pushteti dhe participimi i bashkësive pakicë në krijimin e politikës së komunës dhe vendimarrjes. Kjo prodhoi efekt i cili ishte i papritshëm madje edhe për ne. Edhe pse procedurat metodologjike u hartuan në mënyrë që të na japin pasqyrë reale për gjendjen faktike të të gjitha bashkësive etnike të cilat jetojnë në komunat, nga mostra, Raporti në fund u reduktua në masë më të madhe, në participimin e komunitetit maqedonas në komunat ku ajo është pakicë (Gostivar, Dibër dhe Strugë) dhe komunitetit shqiptar si pakicë (Kërçovë). Objektivisht, pakica turke, ajo rome dhe komunitetet tjera më të vogla, mbetën jashtë fokusit të hulumtimit.
10. **Shteti binacional?** “Vendi ynë, me Marrëveshjen kornizë u bë shtet binacional dhe ne ndjehemi në masë të madhe të diskriminuar”, na deklaroi një nga pjesëmarrësit në biseda, i nacionalitetit turk. *“Të drejtën e vetos, objektivisht e shfrytëzoi vetëm komuniteti shqiptar në Kuvendin e IRJM-së, sepse kanë shumicë të madhe; disa komuna të cilat më herët ishin me shumicë turke, u shuan si rezultat i “pazarllëqeve” në dëm tonin të dy bashkësive më të mëdha në vend, kurse përfaqësimi i drejtë vështirë realizohet me disa deputetë jashtë organeve përfaqësuese. Pasi i marrin votat tona në zgjedhje, partnerët tanë të koalicionit në pushtet, na harrojnë.”*
11. **Ku janë romët?** Bashkësia rome është në gjendje akoma më të rëndë, sepse ka statusin e një pakice të vogël të disperzuar. Margjinalizimi, si pasojë thuhet pa përjashtim sjell jobarazi dhe varfëri. *“Ne ende jemi më të diskriminuarit”* ishte deklarata e përfaqësuesve të organizatave joqeveritare rome në komunat. *“Për projektet tona, përveç ndërkombëtarëve, pushtetet lokale nuk kanë sens”*
12. **“Saving clause” për pakicat shumë të vogla:** Në dritën e këtyre njohurive, duhet të përkrahen të gjitha iniciativat për “ulëse të rezervuara në Kuvendin e IRJM-së (vendi ynë si një njësi zgjedhore për komunitetin turk dhe rom) ose madje në këshillat komunale, heqja e pragjeve zgjedhore për pakicat e vogla (e a.q. “saving clause” është garanci për reprezentim në parlament të njerëzve të cilët i takojnë pakicave nacionale, në rast se nuk e kanë fituar numrin e nevojshëm të votave); miratimi i programeve për mbrojtjen e tyre, arsimit dhe zhvillimi; aprovimi i zyrave për të drejtat e pakicave në pushtetin shtetëror dhe komunal, e kështu me radhë. Përvoja të këtilla dhe të ngjashme ekzistojnë edhe në shtete tjera dhe nevojitet vullnet politik, veçanërisht nga ana e partive parlamentare shqiptare, të cilët kundërshtojnë idenë për ulëse të rezervuara.
13. **Cilat janë përvojat dhe standardet në Evropë?** Edhe pse nuk ishte detyra jonë të propozojmë zgjidhje në nivel shtetëror, megjithatë erdhëm deri në disa njohuri të cilat i propozojmë. *Avancimi i pozitës së komuniteteve pakicë i tejkalon kufijtë lokalë të komunave dhe duhet të shihet në kontekst të prevenimit të konflikteve dhe ngritjen e sigurisë dhe stabilitetit të shtetit në një shkallë më të lartë.* Ne kemi përvojat tona, madje edhe zgjidhje tona, si për shembull: funksionar qeveritar përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes kornizë ose nëpunës shtetëror në Ministrinë e arsimit, i ngarkuar për përparimin e arsimit të romëve, Programi nacional për përparimin e pozitës së romëve etj. Megjithatë duhet të kihet parasysh edhe disa përvoja nga shtetet tjera me zyrat speciale të cilat merren me çështje të pakicave dhe të cilat mund të zhvillojnë politikë koherente në

këtë lëmi; Ministër i cili është i emëruar që të merret ekskluzivisht me këtë çështje; Komisar special i kryetarit, si institucion i instaluar për ngritjen e pakicave në nivelin më të lartë; emërimi i funksionarit në Ministrinë e pushtetit lokal i cili do të merret me të drejtat e pakicave në komuna; Këshill konsultativ nacional i cili mund të funksionojë në nivel nacional por edhe në nivel rajonal apo komunal dhe i cili do ta lehtësonte komunikimin ndërmjet pushtetit ligjvënës dhe atij ekzekutiv në lidhje me një sërë çështjesh të këtilla, si për shembull:

- Pjesëmarrje në përgatitjen e strategjisë qeveritare dhe masa të cilat kanë të bëjnë me persona të cilët i takojnë pakicave nacionale dhe do të raportojë për këtë
- Do të luajë rol në forum i cili do ta lehtësonte komunikimin ndërmjet pakicave të ndryshme
- Do të luajë rol në forum i cili do të sigurojë këmbim përvojash ndërmjet deputetëve dhe funksionarëve të pushtetit ekzekutiv
- Do të hartojë ndonjë lloj guide (udhëzuesi) në lidhje me këtë çështje për participim të pakicave në pushtet
- Së bashku me funksionin konsultativ, këto organe mund të kenë edhe funksion ekzekutiv të distribuimit të resurseve të orientuara drejt nevojave kulturore. Në parim ata e përforcojnë legjislativën, por në disa situata konkrete mund të kenë edhe funksione ekzekutive
- Këto organe mund dhe duhet të impenjojnë edhe përfaqësues të shumicave më të vogla. Me këtë rast është e preferueshme që krahas balancës etnike të arrihet edhe balanca e orientimit politik.
- Pushtetet nacionale dhe politike duhet të vendosin *qëllime* dhe ta prezantojnë planin aksionar për atë se si t'i arrijnë ato objektiva (qasje në arsim, trajnime specifike për ata të grupeve nënreprezentuese, regrutim, procedura për emërim dhe përparim etj)
- Ombudsmani:

Konform Ligjit për avokat popullor, institucioni Avokat popullor ka ingerenca në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve të cilat nuk janë shumicë dhe në përparimin e përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të komuniteteve në organet e pushtetit qendror, njësisive të vetëqeverisjes lokale dhe institucioneve dhe shërbimeve tjera publike.⁵

Nga bisedat me persona kompetent në këtë institucion, si dhe nga Raporti vjetor për punën e Avokatit popullor për vitin 2005, konkludua se në aspekt të përfaqësimit të drejtë të bashkësive në administratën shtetërore dhe publike gjendja me komunitetin shqiptar dukshëm është përmirësuar, ndërsa bashkësitë më të vogla edhe më tutje janë të nënreprezentuara. Për shkak të ristrukturimit të njësisive të vetëqeverisjes lokale në relacion pushtet lokal – pushtet qendror, nuk janë kërkuar të dhëna të këtilla nga ana e njësisive të vetëqeverisjes lokale, gjë që ishte handicap i madh për hulumtimin tonë, edhe pse disa tregues arritëm që vetë t'i grumbullojmë nga terreni dhe i prezantuam në pjesën për komunat.

⁵ Në nenin 11 të Ligjit, i cili ka të bëjë me ingerencat, thuhet:

„Avokatii popullit në kryerjen e detyrave që dalin nga kompetencat e tij, ndërmerr veprime dhe masa për të cilat është i autorizuar me këtë ligj me qëllim të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve ose mbrojtjen e parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të qytetarëve tëq cilët u takojnë të gjitha bashkësive kur janë të cenuara nga organet sipas nenit 4 të këtij ligji”

Pasqyrë tabelare e strukturës së punonjësve sipas përkatësisë etnike në vitin 2005 (e shprehur në përqindje) e prezantuar në Raportin vjetor të Avokatit popullor për vitin 2005⁶

	Maqe-donas	Shqip-tarë	Turq	Romë	Vlleh	Serb	Bosh-njakë	Të tjerë
Kuvendi i IRJM-së	81,31	13,18	1,6	1,09	0	1,64	0,54	
Qeveria e IRJM-së	82,52	9,34	1,82	1,42	1,42	2,03	1,01	0,4
Ministritë	85,21	8,8	1,6	0,71	0,91	1,76	0,33	0,61
Organet e pav. shtetër.	89,8	4,91	0,58	0,55	0,67	2,22	0,34	0,9
Fonde	94,52	3,84	0,3	0,15	0,75	0,3	0	0
Ndërmarrjet publike	85,5	7,22	0,74	1,03	0,82	3,23	0,38	1,03
Jurispru-dencë	85,4	8,93	1,27	1,22	1,81	0,58	0,24	0,44
Instituc. Ndëshkuese përmirësuese	81,38	15,15	0	0,43	0,86	0,86	0	1,29

Një nga ingerencat e Avokatit popullor është që të veprojë edhe ndaj ankimeve të parashtruara nga ana e qytetarëve të cilat kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës për përfaqësim të barabartë dhe të drejtë gjatë punësimit në administratën publike. Në periudhën që e hulumtojmë, në vitin 2005 numri i ankimeve ka qenë 13, kurse janë zgjidhur 5 lëndë. E gjithë kjo flet se institucioni avokat popullor duhet të forcohet me përkrahje dhe bashkëpunim të të gjitha institucioneve kompetente dhe publikut, veçanërisht për arsye se avokati i popullit disa herë në publik u ankua për obstrukcione, posaçërsisht nga ana e Ministrisë së punëve të brendshme. Në kompetencat e këtij institucioni, gjithsesi duhet të hyjë përcjellja dhe kujdesi për zbatimin e të drejtave tjera kolektive të pakicave siç janë përdorimi i gjuhëve dhe simboleve, e drejta e vetos së pakicës, e drejta e arsimimit, kulturës, religjionit etj.

14. Në ç' masë modeli i ri i ndarjes së pushtetit u mundësoi pakicave në komunat që të marrin pjesë në procesin e definimit dhe krijimit të politikave me rëndësi për zhvillimin lokal?

Në Ligjin për vetëqeverisje lokale është përcaktuar se qytetarët e realizojnë të drejtën e tyre për vetëqeverisje lokale drejtpërsëdrejti dhe nëpërmjet përfaqësuesve në organet komunale (neni 5). Do me thënë, qytetarët drejtojnë me komunën nëpërmjet formave të demokracisë së drejtpërdrejtë (tubimi i qytetarëve, referendum, iniciativat qytetare) (neni 25) dhe format e demokracisë reprezentative, respektivisht nëpërmjet organeve të zgjedhura: këshilli dhe kryetari i komunës (neni 31).

Format e demokracisë së drejtpërdrejtë. Hulumtimi ynë tregoi se në periudhën e monitorimit (nëntor 2005 - qershor 2006) nuk janë shfrytëzuar format e sipërpërmendura të demokracisë së drejtpërdrejtë, e as format tjera të participimit të qytetarëve, përveçse me përjashtime të vogla, që paraqet deficit të madh demokratik i cili drejtpërdrejt ndikon edhe në mundësinë për pariticipim më të madh të bashkësive pakicë. Bashkësitë lokale, si

⁶ disa institucione nuk kanë paraqitur një pasqyrë të tillë ose kanë paraqitur të dhëna të pakompletuara

formë e rëndësishme potenciale e participimit politik të qytetarëve, faktikisht akoma nuk janë aktivizuar dhe nuk janë kyçur në atë proces. Sa për ilustrim mund të përmendim konkluzionin e qytetarëve nga Bashkësia lokale “Vreshtat e Liqenit” në Strugë, ku njëzëri u konstatua se pushteti komunal dhe kryetari nuk kanë guxuar të marrin vendim për hapjen për trafik të rrugës deri te liqeni e cila kalon nëpër këtë lagje, pa mos i informuar ose pa mos kërkuar mendimin e atyre të cilët më së shumti janë të prekur, qytetarët e kësaj lagjeje! Duhet të kemi parasysh se të gjitha këto forma të demokracisë direkte e nënkuptojnë parimin e shumicës për vendimmarrje, respektivisht se për to nuk kanë të bëjnë mekanizmat e modelit të ri të ndarjes së pushtetit. Mungesa e shfaqjes së këtyre formave të demokracisë në periudhën e monitorimit⁷ nuk na mundësojnë që ta analizojmë veprimin e tyre mbi marrëdhëniet etnike në njësitë e vetëqeverisjes lokale, por në mënyrë hipotetike hap disa çështje. Çka do të ndodh në rast se për një çështje të caktuar nuk merret vendim në seancë të këshillit, për shkak të mospajtimit të pakicave (neni 41 nga LVL), e pastaj për të njëjtën çështje shumica e qytetarëve në komunë pozitivisht deklarohet në referendum? *Për këto arsye, është e nevojshme të rishqyrtohet rregullativa ligjore dhe të anticipohen situatat të cilat do të mund të paraqiteshin në praktikë.*

Demokracia përfaqësuese (representative). Në sajë të faktit se administrimi me njësitë e vetëqeverisjes lokale bëhet përmes organeve të demokracisë përfaqësuese, (format e demokracisë së drejtpërdrejtë, megjithatë, janë vetëm plotësimi i tyre i llojit të vet), kujdesi ynë në hulumtimin ishte i orientuar, para së gjithash, drejt tyre.

Këshilli. Si organ përfaqësues i qytetarëve këshilli i sjell të gjitha dispozitat relevante për funksionimin e komunës dhe për realizimin e kompetencave të tija. Do me thënë, Këshilli krijon politika në nivel të njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe e ndjek të shprehurit e tyre. Vendimet e këshillit, që i shqetësojnë interesat e përditshme por edhe ato më afatgjate të të gjithë qytetarëve të njësisë së vetëqeverisjes lokale, merren me shumicë votash, si parim demokratik i pranuar nga të gjithë për funksionim të organeve përfaqësuese. Në një mjedis multi-etnik kjo do të thotë mundësi për mbivotim të pakicave. Kjo madje, mund të krijojë parakushte për neglizhimin e interesave të një bashkësie të caktuar në dëm të bashkësisë tjetër, ndjenjë përjashtimi nga proceset politike dhe shoqërore, ndjenjë diskriminimi etj.

A kontribuoi dhe si, koncepti i ri për ndarjen e pushtetit në nivel lokal për kapërcimin e këtij deficiti demokratik, ishte një nga çështjet themelore të cilat i parashtruan në hulumtimin tonë. Duke e fokusuar vëmendjen tonë në procesin e vendimmarrjes i cili zhvillohet në Këshillin, në këtë proces në hulumtimin e pranuar në kuptim më të gjerë të fjalës – si mundësi për participim efektiv politik të pakicave, respektivisht si mundësi reale për ndikim të tyre mbi vendimet që i merr Këshilli.

Në këtë kontekst **participimi efektiv i komuniteteve pakicë** në vendimmarrje varet prej disa faktorëve struktural:

(1) **korniza normative (dizajni konstitucional):** Kushtetuta, Ligji për vetëqeverisje lokale, dispozita në nivel komunal (statuti dhe rregullorja), që duhet të krijojnë bazë legale për pjesëmarrje dhe ndikim (participim efektiv) në marrjen e vendimeve

(2) **model i reprezentimit zgjedhor,** që duhet t’u mundësojë komuniteteve përfaqësime adekuat në këshillat dhe më gjerë

⁷ Qytetarët në IRJM kanë përvojë në shfrytëzimin e formave të demokracisë së drejtpërdrejtë. Të përkujtojmë se ata ishin gjerësisht të shfrytëzuar në periudhën e socializmit, për vetëkontribute të ndryshme, për shembull, me të cilin ndërtoheshin objekte me interes publik. Në kohën më të re (v. 2004) u mbajtën rreth 40 referendume si rezultat i pakënaqësisë nga propozimi i Qeverisë së IRJM-së për organizimin e ri territorial të vetëqeverisjes lokale në IRJM.

(3) **etablimi i institucioneve dhe praktikave**, që do ta stimulojnë modelin e pjesëmarrjes efektive në vendimmarrjen (për shembull, vetoja e pakicës, Komisioni për marrëdhënie ndërnacionale etj.)

(1) **Korniza normative.** Me ndryshimet në Kushtetutën e IRJM-së në vitin 2001 u aprovuan elemente të demokracisë konsocionale në sistemin tonë politik. Në këtë kontekst ai krijon një klimë të volitshme për etablim të institucioneve dhe praktikave të cilat dalin nga logjika e kësaj demokracie. Ligji për vetëqeverisje lokale i vitit 2002 praktikisht e ndjek këtë koncept, duke promovuar zgjidhje që e stimulojnë participimin politik efektiv të komuniteteve pakicë në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Më të rëndësishme janë dy:

E para, përdorimi i domosdoshëm i së a.q. E drejta e Badenterit ose e a.q. shumica e dyfishtë në raste të caktuara. Në fakt, neni 41 nga LVL (Ligji për vetëqeverisje lokale) përcakton se e a.q. shumicë e dyfishtë ka të bëjë me “dispozitat të cilat kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhëve dhe shkrimeve të cilat i flasin më pak se 20% e qytetarëve në komunë, si dhe caktimi dhe përdorimi i stemës dhe flamurit të komunës...”

E dyta, në nenin 55 të të njëjtit ligj, është paraparë formimi i Komisionit për marrëdhëniet ndërmjet bashkësive, i cili i shqyrton çështjet të cilat kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet bashkësive që janë të përfaqësuara në komunë, me qëllim që të jep mendim dhe propozime për zgjidhjen e tyre. Këshilli është i detyruar që të shqyrtojë opinionet e këtilla, por ata nuk kanë veprim obligativ për të. Komisioni, i cili është i përbërë prej numrit të barabartë të përfaqësuesve nga çdo komunitet i përfaqësuar në komunë, do të duhej t’i bëjë interesat e pakicave më të dukshme dhe së bashku me të drejtën e Badenterit, të kontribuojë për balancim të marrëdhënieve ndëretnike në komunë.

Në kuptim më të gjerë të fjalës edhe dy zgjidhje tjera, të cilat i parasheh ligji për vetëqeverisje lokale, do të duhej të kontribuojnë për pjesëmarrje efikase të pakicave në vendimmarrje: Mundësia që në punën e këshillit të përdoren edhe gjuhët e pakicave etnike (neni 90), me çka jo vetëm që drejtpërsëdrejti lehtësohet pjesëmarrja në punën e këshillit e përfaqësuesve të pakicave etnike (përdorimi i gjuhës amtare është gjithmonë për impenjim në debat), por forcohet edhe niveli i pjesëmarrjes së tyre si partner i barabartë në atë proces.

Zgjidhja e dytë ka të bëjë me përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të qytetarëve të të gjitha bashkësive në administratën komunale (dhe në shërbimet publike) (neni 59 i LVL). Do të mund të supozohet se anëtarët e këshillit me mirëbesim më të madh dhe liri më të madhe do të kontaktojnë me njerëzit e bashkësisë së vet në funksion të përgatitjes së pjesëmarrjes aktive në seancat e këshillit (të kërkuarit e informatave, materialeve, të kërkuarit e asistencës gjatë përpilimit të propozimit etj.).

15. Autoritetet komunale në Gostivar, Kërçovë, Dibër dhe Strugë nën monitorim:

Këshilli i komunës: Çka tregon funksionimi i deritashëm i Këshillit? Në hulumtimin, vëmendjen tonë e orientuam posaçërisht në dy faktorë:

Procedurat demokratike: Procedurat demokratike sipas të cilave punon Këshilli i komunës, si dhe kapaciteti organizativo-teknik është në korelacion të ngushtë me participimin e pakicave etnike.

Hulumtimi tregoi se Këshillat e komunave, vetëm pjesërisht i kënaqin standardet për vendimmarrje demokratike: konvokimi me kohë i seancave me rend dite të përcaktuar paraprakisht dhe materiale të shpërndara, respektim i dispozitave sipas të cilave seancat zhvillohen në dy (në Gostivar në tri) gjuhë dhe shtypja e materialeve në dygjuhësi, etj. Anëtarët e intervistuar të Këshillave në disa nga komunat, ankoreshin për propozimet të cilat vijnë nga kryetari i komunës dhe administrata, janë të varfra dhe jo mjaft të

argumentuara, sepse nuk është me rëndësi mendimi i individëve. Shumica në Këshill, veçanërisht nëse është nga partia e njëjtë si edhe kryetari, funksionon si “makinë votimi”. Kritikë tjetër u adresua për furnizimin e pajisjes për përkthim simultan. Pasi që punohet për pajisje të shtrenjtë, stërzgjetet furnizimi me të dhe kjo kontribuon për mosefikasitet të seancave dhe për paraqitjen e problemeve në komunikim. Ndoshta do të ishte e tepruar të thuhet se njerëzit janë “të humbur në përkthim”, si heronjtë e filmit me të njëjtin emër, por pengesat në komunikim e shuajnë vullnetin për participim aktiv. Në disa komuna problem paraqet edhe sigurimi i sallës për mbajtjen e seancave, për ç’arsye seancat mbahen në objekte tjera (hotele, për shembull). Vetë seancat e këshillit zhvillohen me respektim formal të procedurave të rëndomta dhe nuk janë vërejtur manipulime gjatë votimit. *Ekzistimi i rrethanave të paraqitura më lartë (me karakter procedural organizativo-teknik) e konsideronim si hipotezë të rëndësishme demokratik për impenjim kualitativ të pjesëtarëve të pakicave etnike në punën e Këshillave.*

16. Sqarim, monitorim, dialog, afirmim dhe implementim i së drejtës së vetos së pakicës (vendimarrje me shumicën e Badenterit). Analiza e treguesve empirik tregon me sa vijon: Në statutet e komunave dhe në rregulloret për punë, neni 41 paragrafi 3 i LVL, e drejta e vetos së pakicës nuk ekziston, edhepse në aktet e këtilla duhet të gjejë vend para gjithë të tjerave. A është konsideruar se ka qenë i mjaftueshëm neni 41 nga LVL? Disa nga bashkëbiseduesit konsiderojnë se as në BNJLV e as në nivel tjetër të shtetit, nuk ekziston vullnet që të zhvillohet dhe të përparojë korniza institucionale për implementim të këtij mekanizmi, që të mos preken tema të ndjejshme ndërtnike. Nëse problemet i fshehim nën tepih, ato nuk ekzistojnë.

Në komunat e mostrës sonë, e drejta e Badenterit nuk u vërejt në asnjë rast në periudhën e shkuar. Sqarimi nga ana e kompetentëve ishte se për një gjë të tillë nuk ka ekzistuar nevoja, sepse çështjet nga lëmi i kulturës, përdorim i gjuhëve, stema dhe flamuri, nuk kanë qenë në rend dite të këshillave. Megjithatë, konstatoam disa raste kur një lloj i tillë i vendimeve janë marrë nga ana e Këshillit të komunës, por njëzëri nga ana e të gjithë këshilltarëve (për shembull, stema dhe flamuri në një komunë, përdorimi i gjuhës në një komunë tjetër etj.). Nga ana tjetër në periudhën e shkuar, publicitet fituan edhe disa raste të cilat e hapën çështjen e bishtërimit të rregullativës ligjore, duke përfshirë këtu edhe nenin 41 të LVL, respektivisht parimi i shumicës së dyfishtë. Rasti i parë i vendimit për ndërtim të përmendores të një pjesëtari të UÇK-së në Strugë, që u soll pa zbatim të vetos së pakicës. Rasti i dytë është marrja e vendimit për stemë dhe flamur të komunës Çair (Çairi nuk ishte në mostrën e hulumtimit, por rasti është karakteristik) dhe vendimi për ndërtim të përmendores së Skënderbeut në Çarshinë e vjetër të Shkupit, me çka janë shkelur disa dispozita ligjore.

Nga bisedat me këshilltarët dhe përfaqësuesit e partive politike, fitohet përshtypja se një pjesë e tyre as që janë të vetëdijshëm për domosdoshmërinë e përdorimit të këtij neni në situatat e përcaktuara me ligj; e dyta, se formulimi ligjor mund të komentohet në kuptim më të ngushtë apo më të gjerë të fjalës (askund nuk është theksuar taksativisht se çka bën pjesë në “kulturë” ose “përdorim të gjuhëve”...), që mund të krijojë probleme gjatë zbatimit; dhe e treta, se një numër i caktuar i bashkëbiseduesve tanë të cilët i takojnë komunitetit shumicë në komuna, janë kundër përdorimit të kësaj rregulle.

Për këto arsye, për shkak të afrimit të kësaj rregulle deri te strukturat komunale dhe deri te qytetarët e asaj komune, do të ishte mirë sikur shumica e dyfishtë të ishte e përpunuar në mënyrë adekuate në LVL, në statutet e komunave, gjegjësisht në rregulloret për punë të këshillave. Si domosdoshmëri shfaqet nevoja për monitorim të zbatimit të saj, instruim të anëtarëve të këshillit dhe kryetarëve të komunave në kuadër të BNJLV dhe forumeve tjera,

të përshtatshëm për këtë qëllim. Injorimi i kësaj të drejte nga ana e pakicës, si dhe keqpërdorimi dhe zbatimi i shpejtë i saj, nga ana e pakicës mund ta shemb idenë për “ndarje të pushtetit” dhe të sjell deri te thellimi i situatave konfliktuozë.

17. Norma problematike ligjore: Observimi i dytë i yni është se në zbatim i normës ligjore të nenit 41 to~ka 3 të LVL mund të jetë problematike. Në fakt, kërkohet “shumica e votave të anëtarëve prezent të këshillit të cilët i takojnë komuniteteve të cilat nuk paraqesin popullatë shumicë në komunat”. Çka do të thotë kjo praktikisht? Në komuna të caktuara, ku në këshill ka 4-5 anëtarë të pakicave, kjo do të thotë se prej tyre prezent duhet të jenë 3 vota, respektivisht vendimi duhet të merret me 2 vota të pakicave etnike. Në rast se përkundër kësaj kihet parasysh shumica e këshilltarëve, si dhe kryetari i komunës, i cili gjithashtu (në parim) i takon komunitetit shumicë, është evidente se (ata që janë pak në numër) pjesëtarët e komuniteteve pakicë do të jenë nën presion të madh. (Ky konstatim nuk ka të bëjë vetëm me zbatimin e të drejtës së Badenterit, por ka të bëjë me vendimarrjen në përgjithësi në Këshill, në rastet kur pakicat etnike janë të përfaqësuara me një numër më të vogël të këshilltarëve). A nuk duhet vallë, në këto raste të kërkohet shumica nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve (shumica absolute) dhe me këtë rast Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive të shihet si një nga solucionet për tejkalimin e këtij disbalanci evident të fuqive në këshill?

18. Vetoja e pakicës: të ngushtohet ose të zgjerohet? Hulumtimi shpalosi se participimi efektiv i komuniteteve pakicë në vendosjen e qëllimeve të politikës së komunës dhe vendimarrjes, vihet në pyetje me zbatim shumë restriktiv të vetos së pakicës vetëm për çështje të kulturës, stemës, flamurit dhe gjuhës. Qëllimet e politikës së komunës formulohen në programin e saj dhe mbështeten me financa nga buxheti. Në rast se përfaqësuesit e komuniteteve pakicë në Këshill mbivotohen, ata objektivisht nuk mund të participojnë në marrjen e vendimeve. Për shembull, vendim nga sfera e kulturës, e cila do të paraqitet ad hoc në Këshill, mund të hedhet poshtë për shkak të asaj se nuk ka mbështetje financiare në buxhet, i miratuar në fillim të vitit në bazë të objektivave të qëllimeve të politikës komunale, të vendosura në Programin e saj. Për këto arsye, marrja e vendimeve me shumicë të dyfishtë, duhet të zgjerohet mbi miratimin e Statutit, Programit dhe buxhetit të komunës.

19. Arsimi dhe vetoja e pakicës: participimi i plotë dhe efektiv i bashkësive, gjithashtu nuk mund të jetësohet pa të drejtën e vetos së pakicës ndaj vendimeve nga sfera e arsimit të cilat i shqetësojnë pakicat. Kjo e drejtë ekziston në nivel të shtetit ku deri më tani udhëhiqej politika arsimore. Tani kjo gjendje ndryshon dhe autoritetet lokale do t'i miratojnë vendimet e paralajmëruara nga arsimimi i qytetarëve të saj. Meqenëse arsimi është faktor i cili me gjasë ka ndikimin më të madh mbi zhvillimin e identitetit të bashkësive, pritet se këtu në të ardhmen do të ketë probleme më të mëdha multietnike. Frika se politika arsimore e komunës do t'i favorizojë nxënësit të cilët i takojnë bashkësisë shumicë është real dhe për shkak të kësaj nuk guxon të orientohet.

20. Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive: ndërmjet normës dhe praktikës

Në rast se e lexojmë me kujdes nenin 55 të Ligjit për vetëqeverisje lokale vijmë në përfundim se ky përmban një jologjikshmëri: ai parasheh formimin e një Komisioni të këtillë vetëm në raste kur të paktën 20% nga numri i përgjithshëm i banorëve i takojnë një bashkësie të caktuar, që më pas të parashihet se në rast se ai (Komisioni) formohet, atë e përbëjnë numër i njëjtë i përfaqësuesve nga secila bashkësi prezente në komunë. Kjo

praktikisht do të thotë se në rast se në komunë ekziston bashkësi pakicë me, për shembull, 19% nga numri i përgjithshëm i banorëve, nuk do të formohet komision, ndërsa ajo bashkësi e cila është mbi 20% shërben si *vizë* për të gjithë bashkësitë tjera në komunë që të përfaqësohen në Komisionin! Meqenëse formulimi “secila bashkësi e përfaqësuar në komunë” nuk është i definuar, dhe në rast se statutet e komunave nuk e trajtojnë atë çështje, siç është rasti në praktikë, parashtrohet pyetja, cilat dhe çfarë bashkësisë do të merren parasysh për formimin e Komisionit.

Si zgjidhet çështja e zgjedhjes së Komisionit? Do të marrim një shembull: Në Komunë parashihet që partitë politike të përfaqësuara në këshill të japin propozime për anëtarë të komisionit, më pas propozimi shkon përmes Komisionit për emërimin..., kurse kryetari i tij zgjidhet nga bashkësia shumicë/partia në Këshill. Një zgjidhje e tillë, konsiderojmë ne, se nuk është më e mirë për shkak të arsyeve në vijim: Përbërja e komisionit do të ishte nën kontroll të plotë të partive politike të cilat e përbëjnë këshillin (që tashmë ekziston për bashkësitë më të vogla të cilat nuk kanë përfaqësues në këshill, për shembull), pastaj propozimi i tyre shkon te Komisioni për emërimet..., ku në përbërjen e tij dominojnë ata të bashkësisë shumicë në komunë. Është interesante se në rastin tonë edhe kryetari i komisionit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive ishte nga bashkësia shumicë në komunë edhe atë nga partia në pushtet. Në njërin nga komunat ku bëmë hulumtimin, marrim vesh se kryetari i komunës propozon kryetarin dhe anëtarët e këtij komisioni! Në bazë të këtij shembulli, përfundojmë se baza për zgjedhje të anëtarëve të këtij komisioni është tejet e ngushtë dhe nën ndikim të fuqishëm partiak. Duket se duhet të bëhen përpjekje që të fitohet përbërje e komisionit, e cila do të shkëputej nga kornizat e ngushta partiake/politike, të cilat jo gjithnjë dhe jo në mënyrë ekskluzive i shprehin interesat e qytetarëve në bashkësinë lokale.

Çfarë është kontributi i deritanishëm i këtyre komisioneve për participim efektiv politik të bashkësive pakicë?

Praktikisht asçfarë. Në të katër komunat nga mostra jonë, këto komisione kanë mbetur vetëm në seancat e veta konstitutive – ata nuk kanë mbajtur asnjë mbledhje. Pse? Morëm përgjigje se për këtë nuk ka pasur arsye. Fitohet përshtypja se, shumë bashkëbiseduesve tanë nuk u është e qartë se a duhet ky Komision të ekzistojë dhe nëse ekziston si do të funksionojë, respektivisht a nuk do të jetë kjo vetëm një burim i konfrontimeve dhe problemeve të reja. Madje te një pjesë e e caktuar e bashkëbiseduesve tanë i dukshëm është qëndrimi se e Drejta e Badenterit dhe Komisionet e këtij lloji perceptohen si indikatorë se zhvillimet në komunë nuk janë të mira, prandaj duhet hezituar. Përafërsisht – ç’na duhet “Badenteri”, ç’na duhen Komisione kur nuk kemi asçfarë probleme në marrëdhëniet ndëretnike! Qëndrimet e këtilla, ndoshta, bazohen edhe në “kohët idilike” që kanë ikur që moti, por gjithsesi ata nuk i shprehin as marrëdhëniet reale në komunat, e as në shtet. Nëse merret parasysh se në mostrën kishim komuna me nivel të ndryshëm të tensioneve ndëretnike, se kishim edhe një shembull të “bishtërimit” tipik të shumicës së dyfishtë, me pasoja evidente mbi marrëdhëniet edhe ashtu të brishta ndëretnike në njësinë lokale (për shembull Strugë), atëherë është evidente se Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive, akoma nuk ka arritur të gjejë vendin e vërtetë në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Duke pasur parasysh faktin se në komunat ani do të zhvillohen proceset e ndryshimit të simboleve, emrave të rrugëve, shkollave, fshatrave e kështu me radhë, se komunat ani do të duhet ta zbatojnë parimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, dhe së fundi, se procesi i decentralizimit do të thellohet, duke rrezikuar pozitën dhe influencën e autoriteteve lokale në administrimin me komunat, mund të pritet se marrëdhëniet ndëretnike do të bëhen gjithnjë më të ndjeshme dhe do të vihen para sprovave të reja. Me këtë rast, duhet të kihet parasysh fakti se, efikasiteti në procesin e

decentralizimit është i ngarkuar, me një sërë rrethanash (moszhvillim ekonomik të komunave dhe shtetit, probleme me funksionimin e parimit të sundimit të së drejtës, korrupsioni etj., probleme të cilat nuk janë vetëm lokale, por nacionale), dhe në këtë kontekst bashkësitë pakicë do të kenë shumë arsye të konsiderojnë se janë të margjinalizuara (me të drejtë apo jo), ose ndoshta janë të diskriminuar. Resurset modeste të shtetit, të cilat tani duhet të pësojnë rishpërndarje (edhe në komunat e mostrës sonë është e evidente se një përqindje e madhe nga punësimet janë në sektorin publik), pritet që të jenë faktor shtesë për tensionimet.

21. Roli i Komisionit: Roli Komisionit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive do të merr kuptim dhe rëndësi në rast se plotësohen disa kushte:

- kandidimi dhe zgjedhja e anëtarëve të vendoset në bazë të gjerë (të del nga kornizat e ngushta të Këshillit dhe partive politike: të impenjohen OJQ-të, publiku, mediat e kështu me radhë)
- të vendos me konsensus
- të jetë e përbërë prej numrit të barabartë të anëtarëve nga të gjitha bashkësitë, me ç'rast kryetari të mos jetë nga bashkësia shumicë në komunë
- ingerencat të jenë qartë të përcaktuara, por edhe më gjerë se në nenin 41 të LVL (respektivisht të ketë të drejtë të debatohet dhe të sjell përfundime edhe për probleme të caktuara në komunë: domethënë të tërheq vërejtjen, të prevenojë, e jo vetëm të merr qëndrim për çështje të cilat janë në rend dite të seancës, për të cilat parashihet shumicë e dyfishtë; të luajë rol këshillëdhënës të kryetarit në lidhje me këto çështje)
- Këshilli dhe kryetari të kenë të drejtë që t'i shqyrtojnë dhe të prononcohen për to, por edhe të japin arsyet me shkrim se pse nuk pajtohen me përfundimet e Komisionit

Komisioni i pozicionuar në këtë mënyrë do të ishte një pikëmbështetje edhe për këshilltarët minoritar dhe do të kontribuonte në dialogun ndëretnik (dhe shpalosjen e problemeve), dhe tërthorazi do ta forconte participimin efektiv politik të bashkësive pakicë në komunë.

22. Kryetari i komunës

Kryetari i komunës nuk ishte objekt i veçantë studimi i hulumtimit tonë por jemi të mendimit se është e nevojshme, krejt shkurtimisht, t'i komentojmë njohuritë e fituara në terren. Në këtë organ është i koncentruar pushteti ekzekutiv i Komunës. Ai e prezanton komunën, kujdeset për realizimin e dispozitave dhe vendimeve të cilat i miraton këshilli (propozuesi i të cilit më së shpeshti është ai vetë), udhëheq me administratën komunale dhe vendos për punësimet në të, zgjedh drejtorë në shërbimet publike të themeluara nga ana e komunës... e të tjera (neni 50 i LVL). Pozita dhe ndikimi i tij në komunën janë mjaft domethënëse, jo vetëm për shkak të ingerencave, por edhe për shkak të faktit se zgjidhet në zgjedhje të fshehta të drejtpërdrejta nga ana e qytetarëve (me parimin e shumicës) dhe që praktikisht nuk mund të ndërrohet për shkak të kryerjes së funksionit. Përveç aftësive dhe kualifikimeve personale, mbi fuqinë e tij reale ndikojnë edhe faktorët struktural në vazhdim: përkatësia e tij partiake, e cila ishte në koalicionin qeveritar në nivel nacional dhe përkatësia e tij partiake e cila e përbën shumicën në këshill. Edhe pse është akoma herët të thuhet nëse ky organ strukturën e pushtetit në komunë ka shumë pak ose për tepër pushtet (për këtë tërheqin vërejtjen edhe bashkëbiseduesit tanë), faktorët struktural me ndikim të përmendur më sipër u treguan si të rëndësishëm edhe në hulumtimin tonë (shih raportet për komunat). *Përse të humbas kohë për do farë procedura: kur kam problem, shkoj direkt te lideri ynë, ai shkon direkt te lideri i tyre dhe problemi zgjidhet, janë fjalët e njërit nga kryetarët të koalicionit në pushtet. Por meqë pushteti ndërrohet, i njëjti kryetar*

komune nesër kur do të gjendet në opozitë, do të protestojë kundër mosrespektimit të procedurave.

Komponenta më e fuqishme është “ndarja e pushtetit”. Kjo mungon nëpër komuna, sepse kryetarin e zgjedhin qytetarët dhe ai gjithnjë do të jetë nga bashkësia shumicë. Mënjanimi i bashkësive pakicë është i legalizuar dhe tani duhet të mendohet se si të vendoset ndonjë balancë. Në të kundërtën, jo vetëm që komunat do të shndërrohen në “pashallëqe” të një ose më shumë pushtetarëve lokalë, por mund të ashpërsohen tensionet ndëretnike.

Konsiderojmë se duhet të ndiqet praktika e shoqërive tjera pluraliste për balansim etnik. Kundërpesha e pushtetit të kryetarit të komunës, mund të jetë kryetari i këshillit, i cili do të ishte nga radhët e bashkësive pakicë. Gjatë zgjedhjes së kryetarëve të komisioneve tjera komunale gjithashtu nevojitet të kihet kujdes në mënyrë rigorozë për atë që ata të jenë nga bashkësi (dhe parti) të ndryshme, që tani nuk është rast gjithmonë në komunat. Komisioni për marrëdhënie ndërnacionale duhet të fitojë funksion më të fuqishëm të një trupi këhilldhënës dhe Këshillit të komunës, mendimi i të cilit do të ketë ndikim mbi vendimet e komunës, posaçërisht atyre të cilat i shqetësojnë bashkësitë pakicë.

- 23. Decentralizimi i pushtetit:** Hulumtimi tregoi se ekziston pakënaqësi nga ajo se si zhvillohet procesi decentralizimit. Ja një deklaratë karakteristike e një anëtari të këshillit: *“Shteti nuk lëshon as para, as ingerenca, as dotacione: në arsim dhe shëndetësi të ketë zhvillim me këtë temp të bartjes së ingerencave; komuna ka obligime vetëm për mirëmbajtje, ngrohje, por jo edhe administrim; bashkëpunimi me shtetin është i mirë vetëm nëse kryetari i komunës ose kryetari i këshillit janë nga partia e njëjtë politike si ata në organet e pushtetit qendror; decentralizimi i mirëfilltë është krejtësisht joadekuat, janë të nevojshme ndryshime në ligjin për TVSh dhe tatimin personal të orientohen drejt komunave...”*

Dy çështje janë veçanërisht të rëndësishme për procesin e decentralizimit, të cilin ne e vëzhgojmë nga aspekti i zgjidhjes institucionale që shkon në favor të preventimit të konflikteve etnike. Nga njëra anë, duhet të vazhdojë decentralizimi i mëtejshëm fiskal, me çka komunat do të bëhen më pak të varura nga pushteti qendror dhe procedurat burokratike për marrjen e dotacioneve. Nga ana tjetër, kontrolli të cilin e kryejnë organet e pushtetit qendror patjetër të jetë shumë më efikas sesa sistemi gjyqësor. Nënkuptohe, patjetër të thuhet se në një gjendje ekonomike në të cilën sot gjendet vendi ynë, nuk është lehtë të arrihen këto objektiva. Raporti nacional për zhvillimin e njeriut të UNDP-së, për shembull, nënvizon se *“është e vështirë të arrihet deri te pavarësia financiare në një gjendje kur prodhimi bujqësor për kokë banori në shtet, është shumë i ulët”*. Hulumtimi tregoi se resurset e dobëta financiare të komunave, papunësia, borxhet e trashëguara dhe korrupsioni, mund t'i ashpërsojnë problemet multi-etnike. Në rast se nuk ka investime dhe zhvillim për absorbimin e papunësisë, atëherë politika “përfaqësimi i drejtë i bashkësive” do të shndërrohet në politikë “zero-sum-game”(që dikush të fitojë, tjetri të humb). Ky problem në momentin e monitorimit nuk ishte shumë i shprehur, përveç në komunën e Strugës, por do të vijë në shprehje në të ardhmen. Arsimi masovik i shqiptarëve do të krijojë një masë të njerëzve të rinj të arsimuar të cilët me të drejtë do të presin që shpresat e tyre për punësim të realizohen. Shpresat e zhgënjyera janë burim i sigurt për konflikte.

- 24.** Hulumtimi i opinionit publik në mostër prej 600 të anketuarish në këto komuna, që e realizoi Brima-Galup, në nivel të frekuencës së përgjithshme, qytetarët e Gostivarit, Kërçovës, Dibërës dhe Strugës **kryesisht janë të kënaqur nga puna e autoriteteve komunale.** Në fakt, 47,1% e qytetarëve i vlerësojnë pozitivisht (“shumë mirë” dhe “kryesisht mirë”) rezultatet nga puna e pushtetit të ri lokal, 27,9% “as të mira as të

këqija”, kurse 15,9% këto rezultate i vlerësojnë negativisht (“ kryesisht keq” ose shumë keq”). Mirëpo, kur të shihen përgjigjet sipas strukturës etnike të qytetarëve të anketuar, bëhet më e qartë ndarja sipas vijave etnike. Maqedonasit nga komunat Gostivar, Dibër dhe Strugë janë shumë më të pakënaqur nga puna e pushtetit lokal, sesa ahqiptarët. Në pyetjen kush është fajtor nëse konsideroni se pushteti lokal ka treguar rezultate të dobëta, maqedonasit dhe “të tjerët” (turqit, romët etj.) përgjigjen “pushteti qendror”, me gjasë duke ndier se janë lënë vetë më vete, kurse shqiptarët përgjegjësinë e shohin te kryetari i komunës.

24. **Simbolet:** Grupet etnike gëzojnë të drejtën e prestigjit, nëpërmjet shprehjes zyrtare të simboleve (flamuj, mbishkrime, gjuhë etj.). Për këtë fenomen mund të përdoret koncepti “alokim autoritativ” ose “konflikt simbolik”. Çfarë është vëllimi dhe intensiteti i sektorit simbolik? Sepse simbolet janë kodeks transparent i “prestigjit dhe vetërespektimit”, politika përveç tjerash, bëhet ritual në të cilin determinohet statusi. Qëllimet e kërkesave për simbole janë afirmimi publik i legjitimitetit, atje ku ky legjitimitet është kontestues. Teoria politike konsideron se simbolizmi është efektiv në konfliktin etnik, sepse i vesh kërkesat etnike me ide dhe asociime të cilat janë të largëta, duke maskuar diçka që ndryshe do të ishte kontraverze. Simbolizmi lejon konfuzion të koncepteve, që të lejë hapësirë në politikën për interpretim të tyre të ndryshëm. Të themi, gjatë kohë në politikën maqedonase ekzistonte “konflikt simbolik”. Shqiptarët kërkonin të drejtë të shprehjes së simboleve të veta, posaçërisht flamurit shqiptar para institucioneve publike, kurse pushteti këtë nuk e lejonte, sepse nuk kishte as vullnet politik e as bazë kushtetuese për këtë, kurse nga ana tjetër, kishte fuqi. Në vitin 1997 një konflikt i tillë në Gostivar përfundoi me gjakderdhje. Tek pas konfliktit të armatosur në vitin 2001 në bazë të ndryshimeve kushtetuese, u soll ligj për përdorimin e flamujve, në të cilin është pacaktuar saktë procedura për shprehjen e flamujve. Kështu, sipas flamujve të cilët valojnë në shtizat para institucioneve publike, und të kuptohet se cila bashkësi çfarë prestigji ka në shtet.⁸

⁸ Me ligj janë përcaktuar situatat kur dhe si përdoren flamujt e komuniteteve dhe flamurit shtetëror. Këtu do t’i përmendim vetëm më të rëndësishmit:

- Para dhe në objektet e organeve të njësisë së vetëqeverisjes lokale *vazhdimisht* janë të shprehur flamuri i IRJM-së dhe flamuri i asaj bashkësie;
- Para dhe në objektet e organeve shtetërore, shërbimet zyrtare dhe personat juridikë *të themeluar nga shteti*, shprehen flamuri i IRJM-së dhe flamuri i bashkësisë në ditët e *festave shtetërore* të Republikës;
- Para dhe në objektet e shërbimeve publike dhe personave juridikë *të themeluara nga njësia e vetëqeverisjes lokale*, shprehen flamuri i IRJM-së së dhe flamuri i bashkësisë në ditët e *festsave shtetërore* të Republikës;
- Para dhe në objektete e organeve shtetërore, shërbimeve publike dhe personave juridikë *të themeluara nga shteti*, shprehen flamuri i IRJM-së dhe flamuri i bashkësisë në ditë të *festave të bashkësisë*;
- Para dhe në objektete e shërbimeve publike dhe personave juridikë *të themeluara nga njësia e vetëqeverisjes lokale*, shprehen flamuri i IRJM-së dhe flamuri i bashkësisë në *ditët e festave të bashkësisë*;
- Para dhe në objektete e organeve shtetërore, shërbimeve publike dhe personave juridikë *të themeluara nga shteti*, shprehen flamuri i IRJM-së dhe flamuri i bashkësisë në ditët të *festsave komunale dhe festave tjera të përcaktuara me vendim të njësisë së vetëqeverisjes lokale*;
- Para dhe në objektete e shërbimeve publike dhe personave juridikë *të themeluara nga njësia e vetëqeverisjes lokale*, shprehen flamuri i IRJM-së dhe flamuri i bashkësisë në *ditët të festave komunale dhe festsave tjera të përcaktuara me vendim të njësisë së vetëqeverisjes lokale*;

Ata, anëtarësia e plotë e të cilëve vihet në dyshim me politikën e mënjanimit, do t'i ashpërsojnë kërkesat për barazi simbolike. Pas shumë e shumë vitesh të kontestimit të së drejtës së komunitetit shqiptar, që zyrtarisht ta shprehin flamurin e tyre, tani shkohet në skajshmëri tjetër – manifestim i mbifuturisë. Vendimi për ngritjen e një përmendoreje imponante të Skënderbeut në komunën e Çairit, me çka janë shkelur disa dispozita ligjore, vendimi për ngritjen e përmendores së komandant Strugës, pa zbatim të “shumicës së Badenterit” siç kërkon ligji, ose shprehje të flamurit shqiptar përgjatë tërë Shtëpisë së mallrave në Bit Pazar, me ç'rast nuk u shpreh flamuri shtetëror siç imponojnë rregullat, (dukuri të ngjashme u vërejtën edhe në disa komuna) vetëm e përdëftojnë padurimin që të shprehen, sa është e mundur më shumë simbolet të cilat flasin për prestigjin e ri të bashkësisë. Mirëpo, e kaluara është e kaluar dhe padrejtësia që i është bërë komunitetit shqiptar duhet të harrohet. Marrëveshja e arritur, ekziston ligj dhe e drejtë dhe të gjithë patjetër t'i përmbahen kësaj, në emër të paqes dhe stabilitetit të të gjithëve. Pakënaqësia nga ajo për çka është rënë dakord, çdokush doemos ta artikulojë vetëm nëpërmjet procedurave demokratike, në institucionet e shtetit.

25. Politika gjuhësore:

Gjuha e definon statusin e grupit i cili e flet dhe e përfaqëson simbolin e dominimit. Grupi i cili kërkon prioritet, kërkon që gjuha e tij të fitojë “vend të drejtë” që do të thoshte të fitojë status ekskluziv zyrtar. Grupi i cili nuk është i sigurt rreth vlerës së vet, me glorifikim, i reflekton aspiratat e veta për vlerësim më të madh statusor. Statusi i gjuhës është simbol i dinjitetit grupor të vendosur tani. Kërkesat për status zyrtar të gjuhës janë indikacion tipik se disa njerëz kanë kërkesa legjitime për respekt, rëndësi dhe vlerë më të madhe në shoqëri, sesa që kanë disa të tjerë. Kërkesat për përdorim zyrtar të gjuhës, shkojnë larg

-
- Para dhe në objektet e organeve shtetërore, shërbimeve publike dhe personave juridikë *të themeluara nga shteti*, shprehen flamuri i IRJM-së dhe flamuri i bashkësisë *me rastin e pritjes dhe përcjelljes së kryetarit të IRJM-së, kryetarit të Kuvendit të IRJM-së dhe kryetarit dhe anëtarëve të Qeverisë së IRJM-së;*
 - Para dhe në objektet e shërbimeve publike dhe personave juridikë *të themeluara nga njësi e vetëqeverisjes lokale*, shprehen flamuri i IRJM-së dhe flamuri i bashkësisë *me rastin e pritjes dhe përcjelljes së kryetarit të IRJM-së, kryetarit të Kuvendit të IRJM-së dhe kryetarit dhe anëtarëve të Qeverisë së IRJM-së;*
 - Para dhe në objektet e organeve shtetërore, shërbimeve publike dhe personave juridikë *të themeluara nga shteti*, shprehen flamuri i IRJM-së dhe flamuri i bashkësisë *me rastin e ardhjes së të ndonjë kryetari ose kryeministri të ndonjë shteti të huaj, si dhe të ndonjë përfaqësuesi sovran ose të lartë të bashkësisë ndërkombëtare;*
 - Vnë objektet e shërbimeve publike dhe personave juridikë *të themeluara nga njësi e vetëqeverisjes lokale*, shprehen flamuri i IRJM-së dhe flamuri i bashkësisë *me rastin e ardhjes zyrtare të kryetarit ose kryeministrit të shtetit të huaj, si dhe të përfaqësuesit të sovran ose të lartë të bashkësisë ndërkombëtare;*
 - Gjatë takimeve ndërkombëtare, gara dhe tubime tjera, (politike, shkencore, kulturore - artistike, sportive e të tjera) ku vetëqeverisja lokale është organizatore, merr pjesë ose është prezantuar, *në rast se shprehet* flamuri i bashkësisë shprehet edhe flamuri i IRJM-së? (me shprehje nënkuptohet para dhe në objektet);
 - Gjatë kremtave, solemnitetëve dhe manifestimeve tjera politike, kulturore, sportive dhe të ngjashme të cilat janë me rëndësi për njësinë e vetëqeverisjes lokale *në rast se shprehet* flamuri i IRJM-së (me shprehje nënkuptohet para dhe në objektet);

kësaj. Ashtu siç kërkesa për një gjuhë zyrtare demonstroi dëshirë për predominim, ashtu edhe kërkesa për paritet gjuhësor është kodeks transparent për barazi në një kuptim më të përgjithshëm të fjalës. Politika mund të përdoret jo vetëm për të përdëftuar statusin e grupit, por edhe për ta avancuar (shembulli me gjuhën maqedonase).

Në politikën maqedonase, ekzistonte luftë me dekada kundër komunitetit shqiptar për gjuhën. Me Marrëveshjen kornizë të Ohrit “konflikti gjuhësor” është tejkaluar dhe sot gjuha shqipe është gjithashtu gjuhë zyrtare. E drejta e përdorimit zyrtar të gjuhës së pakicave kurrë nuk është kontestuar. “Konflikti gjuhësor” i cili simbolizon konflikt më të thellë statusor multi-etnik, ligjërisht paraqitet rreth përdorimit të gjuhës së pakicave në administratë, në

Institucionet gjyqësore dhe institucionet tjera të pushtetit (përdorim zyrtar). Sipas standardeve ndërkombëtare, përdorim i gjuhës nga ana e pushtetit publik zbatohet në rast se janë të plotësuar dy kritere: kur është kjo praktike dhe kur është e logjikshme, në rast se grupi është në numër të konsiderueshëm në një territor të caktuar. Çka është e “e logjikshme” dhe “praktike”? Komiteti adekuat i ekspertëve për zbatim të Konventës kornizë për mbrojtje të pakicave nacionale në sferën e të drejtave gjuhësore (Advisory Committee of experts of the Framework Convention on the Protection of National Minorities in the area of language rights) konsiderojnë se duhet të jenë sa më zemërgjerë dhe më fleksibil në përgjigjen e të drejtave gjuhësore të pakicave. Kjo do të thotë të zbatohet parimi i bazuar i mosdiskriminimit, që do të duhej të aplikohet për të gjitha aktivitetet të cilat janë të lidhura me “autoritete administrative ose publike”: në të gjitha sferat ku paraqitet shteti (gjyqësia, arsimit shtetëror, shëndetësia shtetërore, informimi publik etj.)

Me Marrëveshjen e Ohrit është vendosur prag: “gjuha tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve tjerë gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj...” “Në njësitë e vetëqeverisjes lokale gjuha dhe alfabeti që e shfrytëzojnë së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik”. Kështu administrata bilinguale ekziston në komunat Gostivar, Kërçovë, Strugë dhe Dibër. Në komunën e Gostivar edhe gjuha turke është gjithashtu gjuhë zyrtare.

Në këtë kontekst duam të tërheqim vëmendjen për disa njohuri nga hulumtimi në lidhje me prapenësinë prej 20% të cilin bashkësia turke dhe bashkësitë tjera më të vogla i konsiderojnë si diskriminues. Për shembull, vetëm në komunën e Gostivarit është marrë vendimi për përdorim të gjuhës turke si zyrtare edhe atë para së gjithash si rezultat i “pazarllëqëve” partiake parazgjedhore. Shuarja e disa komunave tradicionalisht me shumicë turke, në mënyrë shtesë e hendikepuan bashkësinë turke, ose përfaqësuesit konsiderojnë se do t’i nënshtrohen një asimilimi më të theksuar. Vendimi për futjen e gjuhës zyrtare në komunat, bashkësive etnike të cilat janë nën 20%, varet nga maqedonasit që është gjithashtu një nga absurdet e LVL. Faktikisht, në rast të një vendimi të tillë zbatohet shumica e Badenterit, respektivisht vetoja që mund ta shfrytëzojnë ose të mos e shfrytëzojnë përfaqësuesit e Këshillit, e këta janë maqedonasit (Gostivar, Strugë dhe Dibër) dhe shqiptarët (Kërçovë), por edhe turqit me të cilët ka të bëjë kjo e drejtë. Prandaj nevojitet, të mendohet mirë nëse ky prag nuk është tepër i lartë dhe se si bashkësia turke të ndikojë mbi vendimet të cilat drejtpërdrejt i shqetësojnë ata. E njëjta mund të thuhet edhe për komunitetin rom, në rast se ekziston në disa komuna koncentrik i kësaj popullate dhe në rast të futjes së gjuhës rome si gjuhë zyrtare, është praktike dhe e logjikshme.

26. Gjuha e vendimarrjes

Bilingualiteti (dygjuhësia) ose trilingualiteti (trigjuhësia) krahas vullnetit politik, kërkon edhe mjete që të mund të zbatohet edhe këtu praktika e komunave është e llojllojshme.

Materialet për seancat kryesisht shpallen në dy ose tri gjuhë. Por në seancat e këshillave, puna komplikohet. Kryesisht, nuk ekziston teknikë për përkthim simultan dhe seancat udhëhiqen në një gjuhë. Kjo jo vetëm që ofendon përfaqësuesit e komuniteteve tjera por i pamundëson ata që në mënyrë efektive të kyçen në procesin e vendimmarrjes. Nëse kësaj i shtohet se propozimet e vendimeve shpeshherë reduktohen në formulime të shkurta pa ndonjë sqarim dhe argumentim më serioz dhe se trupi votues është siguruar paraprakisht, atëherë vështirë mund të flitet për “participim të plotë dhe efikas” të bashkësive pakicë.

27. Shpresat dhe druajtjet: Ajo që e hasëm në komunat gjatë hulumtimit është atmosfera e *shpresave dhe druajtjeve*. Shpresa nga popullata shumicë shqiptare “punët përfundimisht do të nisnin nga e mbara” (para së gjithash që ndërlidhet me “përfaqësimin e drejtë”, zhvillimin ekonomik, punësimin, standardin), dhe druajtjet e popullatës maqedonase se, tani, si pakicë ata do të jenë të diskriminuar dhe do të mbeten në rrugë, pikërisht për shkak të asaj se janë maqedonas. Bashkësia turke ndjehet ngjashëm, kurse ajo rome është tërësisht e marginalizuar në aspekt social dhe politik. Vënia në funksion e mekanizmave të cilat do ta stimulojnë participimin politik efikas të pakicave, për të cilat flet ky hulumtim, mundet deri diku të ndihmojë në relaksim të atmosferës së pasigurive dhe druajtjeve dhe t’i zvogëlojë mosmarrëveshjet eventuale ndëretnike. Më kryesore është që përmes një fjale dhe veprimi të matur të kryetarëve të komunave, partive politike, organizatave joqeveritare dhe shoqatave, të krijohet atmosferë në të cilën qytetarët nga të gjitha komunitetet do ta kenë ndjenjën se së bashku marrin pjesë në ndërtimin e ardhmërisë së komunës së tyre dhe se së bashku i ndajnë problemet dhe frytet e atij zhvillimi. Në këtë kontekst është e rëndësishme të ndërtohet vetëdija për gjendjet objektive në të cilat gjendet komuna përmes respektimit maksimal të procedurave demokratike në vendimmarrje, transparencë gjatë punësimit në ndërmarrjet dhe shërbimet publike etj.). Nevojitet që të përkrahen të gjitha përpjekjet të cilat bëhen në nivele të ndryshme (*BNjLV, forumet politike dhe shkencore*) që të ndërtohet vetëdija se në një komunë multietnike, matura, durimi, mirëkuptimi dhe kompromisi janë shenja të pashmangshme të secilit proces të vendimmarrjes, pa marrë parasysh nëse gjithmonë dhe çdokund ekzistojnë mekanizma formalë, të cilët e mbrojnë komunitetin pakicë nga majorizimi. Nënkuptohe ky është proces dhe për të nevojitet kohë.

28. Projekti është i arsyeshëm? Dhe në fund të përgjigjemi në një pyetje e cila u imponua gjatë hulumtimit: Në rast se vëzhgohet i cili është në fillimin e vet dhe i cili ka vlerë të kufizuar njohurish, cili atëherë është arsyeshmëria e një hulumtimi të këtillë? Do të thonim shumë e madhe: të shohim se a jemi në rrugën e vërtetë, t’i regjistrujmë fillimet, të një formule e cila tani për tani ofron paqe dhe nivel të lakmueshëm të stabilitetit të vendit tonë dhe e cila ndoshta mund të shërbejë si përvojë e shteteve të ngjashme multietnike; t’i ballafaqojmë mangësitë strukturale, insitucionale dhe kulturore; të tërheqim vërejtjen për kahet eventuale të zhvillimit të modelit dhe praktikës. Shteti, nga ana e vet, gjithashtu patjetër të zhvillojë mekanizma monitorimi dhe t’i shpall rezultatet ose të nxit organizata joqeveritare për të zhvilluar hulumtime të këtilla të ngjashme. Në politikë zgjidhja e problemeve të caktuara hap probleme të reja, shpeshherë të paparashikueshme. “Ndarja e pushtetit” i jep vetëm “rregullat themelore të lojës” në të cilën maqedonasit, shqiptarët, turqit, romët dhe komunitetet tjera i artikulojnë interesat e veta, i formulojnë qëllimet dhe kërkesat politike dhe marrin vendime. Kjo mund të ndodhë nëpërmjet një procesi permanent të adaptimit të qetë të njërit ndaj tjetrit (akomodim), në rast se ekzistojnë faktorë të brendshëm favorizues (zhvillim ekonomik dhe pjekuri politike) dhe posaçërisht faktorëve të jashtëm (integrim evropian, stabilitet dhe bashkëpunim regional etj.) ose

nëpërmjet të konfliktit ndëretnik, i cili në rast se del nga kontrolli mund të shndërrohet në luftë qytetare. Bashkësia ndërkombëtare, posaçërisht Bashkimi Evropian dhe liderët e saj, duhet ta kenë këtë parasysh, duke vazhduar me politikë të mbështetjes aktive dhe ndihmës së gjithanshme të akomodimit paqësor të popujve të cilët jetojnë këtu.

I. HYRJE

1. PREJ KONFLIKTI DERI NË BASHKËPUNIM

Vendi ynë është shoqëri në të cilën jetojnë më shumë grupe etnike ose “komunitete”, të cilat dallojnë ndërmjet veti sipas gjuhës të cilën e flasin, alfabeti në të cilin shkruajnë, religjioni të cilin e predikojnë, sipas traditës së tyre, kulturës, mënyrës së jetesës, memories historike dhe prejardhjes. Fakt evident, i cili fitoi rëndësi politike, tek pasi që hapëruam josigurtë në demokracinë. Regjistrimi i popullatës në vitin 2002, i pranuar nga përfaqësuesit politik të të gjitha “komuniteteve” në shtet, si fakt i cili nuk është për nënçmim në një shoqëri multietnike, i treguan proporcionet në vijim të grupeve etnike të cilat jetojnë në shtet: maqedonas - 64,18%; shqiptarë - 25,17%; turq - 3,85%; romë - 2,85%; serbë - 1,78%; boshnjakë - 0,84% dhe të tjerë - 1,04%. Lloje tëkëtitilla të shoqërive, ligjërisht quhen shoqëri plurale, multikulturore ose multietnike. Ne në këtë raport, i cili paraqet analizë politikologjike, si më adekuat do ta përdorim konceptin “shoqëri multietnike” ose “shoqëri plurale”.

Pas kolapsit të sistemit socialist në vitin 1989, shoqëria maqedonase u ballafaqua me një sërë sfidash: transformimi i sistemit njëpartiak në sistem shumëpartiak; privatizim kaotik dhe ngaherë kriminal të ekonomisë shtetërore, e përcjellur me papunësi të madhe dhe mjerim social; bllokada ekonomike dhe luftëra etnike në kufijtë e saj. Deri në vitin 2001 shoqëria maqedonase, arrinte, thujse në mes të zjarrit nga luftërat brutale nacionaliste në hapësirat e Jugosllavisë së dikurshme, t’i shmanget luftës qytetare. Në 15 vitet e kaluara, marrëdhëniet ndëretnike, shpeshherë ishin të tensionuara, madje nga ndonjëherë në teh që të eskalojnë në konflikt të hapur, por megjithatë u shmang më e keqja. Posaçërisht e ndjeshme ishte kërkesa e komunitetit shqiptar, i cili numerikisht është pakicë, që të merr statusin e kombit të dytë në shtet (“popull shtetformues”), me të gjitha implikacionet që dalin prej kësaj. Në një situatë kur federata Jugosllave shkatërrohej në një sërë të luftërave qytetare brutale, kjo kërkesë shkaktonte frikë te maqedonasit, turqit dhe romët nga shkatërrimi i vendit tonë dhe nga një luftë qytetare. Përmirësimi i pozitës së komunitetit shqiptar prolongohej përderisa në fund eskaloi në konflikt të armatosur në vitin 2001. Intervenimi i NATO-s në Kosovë, tërheqja e ushtrisë së Jugosllavisë nga kufiri ndërmjet vendit tonë dhe Kosovës, si dhe nacionalizmi i inkurajuar shqiptar, kontribuuan për të a.q. *spill-over effect*. Gjegjesisht, konflikti u zgjerua prej Kosove në vendin tonë⁹ që sot e

⁹ Në portretin e Ali Ahmetit, që në bisedë me të e bëri gazetarja K. Blazhevskaja (Dnevnik, 2 mara, 2002), shkruan: “Ai konsideron se shqiptarët e IRJM-së nuk kanë qenë të përgatitur për luftë në vitin 1998, kur kanë filluar konfliktet në Kosovë. Por, pasi Perëndimi u ka ndihmuar shqiptarëve të Kosovës që të ngadhënjë, një numër i mjaftueshëm i njerëzve në IRJM kanë qenë të përgatitur të ngrëjnë armët në fillim të vitit 2001.” E dijsa se pa ndihmën e perëndimit nuk do të ngadhënjë. Por nu ke dishim sa janë të përgatitur që të na ndihmojnë”, i ka deklaruar Ahmeti historianit Timoti, Garton Esh”. Sipas tekstit të Ljubov Minçeva: “The Albanian Ethnoterritorial Separatist Movement and the Macedonian 2001 crisis” i botuar në revistën: “New Balkan Politics”, Në 19/2005 jepet edhe një argument i cili e vërteton ekzistimin e “spillover efektit”: “About mid-March 2001 the insurgents stated that they wanted to talk to the Macedonian government. Insurgency goal was articulated in a joint statement by the Kosovar leaders: Ibrahim Rugova, Hashim Tachi and Ramush Haradinaj”.

Në intervistën të cilën Mark Lejti ish zëdhënës i NATO-s në IRJM e dha për New Balkan Politics (“Painful Confrontations” nga M.Maleska), e konfirmoi të njëjtën.

konfirmojnë udhëheqësit e lëvizjes së armatosur autonomiste të shqiptarëve (UÇK ose Ushtria Çlirimtare Kombëtare)¹⁰. Në paraqitjen e tij, pushteti qendror në Shkup me panikë u përgjigj me përdorim të dhunës: dërgimin e ushtrisë dhe policisë në rajonet e krizës. Edhe pse në marrjen e vendimit morën pjesë edhe partitë parlamentare shqiptare, megjithatë shkatërrimet e para luftarake të fshatrave shqiptare dhe viktimat civile, sollën deri në eskalim të armiqësisë ndërmjet shqiptarëve dhe qytetarëve të tjerë. Dy grupet më të mëdha etnike në shtet, të cilat posedonin kapacitet për konflikt, filluan të homogjenizohen, t'i ngjeshin radhët e veta dhe t'i kanosen njëra tjetrës, sidomos “petritët” e tyre politikë. Vendi ynë rrëshqiste drejt tehut të luftës civile deri në momentin kur bashkësia ndërkombëtare vendosi që seriozisht ta merr punën në duart e veta. Falë aksionit diplomatik të BE-së, OKB-së dhe NATO-s, u krijua bërthamë kritike politikanësh nga të dy palët e konfrontuara, të cilat tani ishin të disponuara që të ulen dhe të bisedojnë për zgjidhje politike. Kështu, konflikti i armatosur, me viktima në të dyja palët, armiqësi dhe mosbesim i thelluar reciprok, dëmi i shkaktuar material dhe mbetje prapa në reformat e filluara shoqërore, përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (Ohrid Framework Agreement) më 13 gusht të vitit 2001.

Decentralizimi është një nga provizionet themelore të kësaj Marrëveshjeje, sepse sipas më shumë analizave vendi ynë ishte shtet i centralizuar. Megjithatë, transferi i më shumë ingerencave prej nivelit nacional në atë komunal, pas konfliktit të vitit 2001, duhet të shihet në kontekst të masave dhe politikave për reduktim të konfliktit ndëretnik ose të paktën lokalizimin e tij. Shënimi i sërishëm i kufijve komunal si provizion i dytë i rëndësishëm i Marrëveshjes së Ohrit, e rriti pushtetin e shqiptarëve në nivel lokal. U formuan 28 komuna me popullatë shumicë shqiptare, 4 komuna me popullatë shumicë turke, një komunë me popullatë shumicë rome dhe një serbe. A ishte kjo zgjidhje optimale?

Përvoja dhjetëvjeçare në Ballkan tregon se askush nuk dëshiron të mbetet pakicë para së gjithash për shkak të mbrojtjes joefikase të drejtave të pakicave, frikë nga diskriminimi ose në disa raste, humbje të privilegjeve. Në disa komuna, ku maqedonasit brenda natës dhe pa pajtimin e tyre të shprehur në referendum, mbetën pakicë si në Strugë (në mënyrë potenciale kjo e pret edhe Kërçovën) pakënaqësia u shndërrua në kanosje për sigurinë dhe stabilitetin e shtetit. Ndërsa shqiptarët, nuk janë të kënaqur nga pozita e tyre në ato komuna ku paraqesin pakicë, ndërsa komuniteti turk dhe ai rom ankohe se të gjitha zgjidhjet institucionale për mbrojtjen e të drejtave kolektive shkojnë në drejtim të përjashtimit të tyre dhe shndërrimit të vendit tonë në shtet binacional. Pakënaqësia dhe konfliktet potenciale si dhe jostabiliteti i shtetit, e imponojnë nevojën për hulumtime serioze të gjendjes dhe forcim të të drejtave të pakicave: “ndarje të pushtetit”, “veto të pakicës”, komisione ndëretnike; përfaqësim të drejtë dhe institucione të tjera dhe politika për mbrojtje të të drejtave të pakicave, që do të mundësonin “participim të plotë dhe efektiv (full and effective participation) në pushtetin lokal. Në fund duhet të jemi të vetëdijshëm se të gjitha këto institucione, rregulla ose politika të mbrojtjes së pakicave

¹⁰ Kushtimisht e përdorim termin “autonomiste”, spse mungojnë analiza objektive epr qëllimet fillestare të UÇK-së. Këtu dëshirojmë të theksojmë atë që e thotë D.Horovic” (D.Horowitz), se në lëvizje të këtilla, “calculation of rational interests underlies strategic choice”

shfaqen si kundërpeshë e domosdoshme e kërkesave potenciale për zgjidhje territoriale të konflikteve etnike.

2. CILAT JANË QËLLIMET E PROJEKTIT? (OVERALL AND SPECIFIC OBJECTIVES, eng.)

Në përcaktimet e qëllimeve të përgjithshme dhe specifike (overall and specific objectives) të Projektit u përqendruam në “Qëllimet e programit dhe çështjet prioritare (“Objectives of the programme and priority issues”) të “Projektit për përkrahje të grupeve pakicë/aktiviteteve” në kuadër të programit CARDS.¹¹ Qëllimi më i gjerë i këtij programi është mbështetja e komunave për ngritjen e vetëdijes për ekzistimin e nevojave specifike të pakicave.

Në projektin e EAR-it, “Mbështetje të grupeve pakicë/aktiviteteve, në seksionin: ”Qëllimet e programit dhe çështjet prioritare” (“Objectives of the programme and priority issues”), theksohen tre qëllime (objectives) dhe çështje prioritare (priority issues), që duhet të arrihen nëpërmjet këtij granti:

- a) to improve the situation of minority communities in the place they live
- b) to increase the active participation of minority communities in the policy-setting and decision-making process in the municipalities
- ii) to improve the relationship and co-operation between the minority communities and the municipalities they live in.

Projekti “Ndarja e pushtetit - koncept i ri i vendimarrjes në komunat multikulturore në vendin tonë”, u orientua nga realizimi i qëllimit të dytë (b) dhe të tretë (c) dhe çështjeve prioritare (objectives and priority issues) nga projekti i EAR-it.

Kështu, qëllimi themelor i projektit:”Ndarja e pushtetit - koncept i ri i vendimarrjes në komunat multikulturore në vendin tonë”, është se si të rritet participimi i plotë dhe efikas i komuniteteve pakicë në krijimin e politikave dhe marrjen e vendimeve në komunat në vendin tonë (policy-setting and decision-making process in the municipalities in FYROM”).(*Overall objective*)

Qëllimet specifike (Specific objectives) të Projektit që ekipi i ekspertëve i vendosi në projekt: Ndarja e pushtetit - koncept i ri i vendimarrjes në komunat multikulturore në IRJM”, janë:

1. Të vlerësohet nëse modeli i “ndarjes së pushtetit” në komuna, kontribuon për rritjen e participimit aktiv të pakicave; në cilën kahe kontribuon dhe cilat janë anët e tija të dobëta
2. Të dilet në publik me Raportin e bazuar në fakte, i cili në mënyrë objektive do ta paraqes gjendjen me participimin e komuniteteve pakicë në formulimin e politikave dhe marrjen e vendimeve në komunat multikulturore në vendin tonë (in the policy-setting and decision-making process in the multicultural municipalities in FYROM

¹¹ Bëhet fjalë për grant në kuadër të programit CARDS e dedikuar për organizatat joqeveritare dhe joprofitabile, që duhet parë në kontekst të masave, politikave dhe instrumenteve për redukim të konflikteve dhe vendosjes së mirëbesimit më të madh ndërmjet bashkësive ndëretnike në nivel lokal, në IRJM. Në “Guidelines for grant applicants” të EAR-it, në seksionin “Background” (pika 1.1.), theksohet se “**especially now with the decentralisation process, the municipalities need more support as they will receive more responsibilities to take care for the needs of their citizens. Support to the municipalities to raise their awareness about their minority communities is essential. Projects that will aim to improve the situation of minorities in the communities they live in are thus targeted with this call for proposals**”

3. Të rekomandohen konkluzione dhe masa të cilat do ta përparojnë (rrisin) participimin efektiv të komuniteteve pakicë në formulimin e politikave dhe marrjen e vendimeve në komunat multikulturore në vendin tonë (in the policy-setting and decision-making process in the multicultural municipalities in FYROM)
4. Raporti me rezultatet nga hulumtimi dhe rekomandimet të shërbejnë si bazë për lobim në Kuvendin e IRJM-së dhe BNjLV për ndryshimin e dispozitave (sidomos Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutet dhe Rregulloret për punë të këshillave komunale) dhe politikat praktike në lidhje me komunitetet pakicë, në komunat multietnike.

3. OBJEKTI I HULUMTIMIT: “NDARJA E PUSHTETIT”

Objekt i këtij hulumtimi, që e ngërthen në vete monitorimin si një nga procedurat themelore metodologjike, është modeli i “ndarjes së pushtetit” në katër komunat e zgjedhura në vendin tonë, me përbërje të përzier etnike të popullatës.

Çka është “ndarja e pushtetit”, cilat janë përparësitë e tij dhe anët e dobëta dhe a mundëson të a.q. “participim të plotë dhe efektiv” të pakicave në komuna?

Shumica e vendeve në botë janë multietnike. Madje edhe shumica e vendeve të Evropës perëndimore, të cilat jemi mësuar t’i shohim si “nacione-shtete” (shtetet nacionale), nuk janë tërësisht homogjene etnikisht. Përveç Zvicrës, Belgjikës dhe Finlandës, të tjerat duken etnikisht homogjene për shkak dominimit të kombit shumicë. Megjithatë, sot, në përputhshmëri me tendencën e theksuar për forcimin e identiteteve etnike, madje edhe në Britaninë e Madhe, shembull shkollor për shtet nacional, nënvizohet rëndësia e pakicës skoceze, uellsiane dhe irlandeze. Ballkani, gjithnjë është parë si në “fuçi baroti” në të cilën, në afërsi të drejtpërdrejtë, (close proximity) jetojnë bashkësi të ndryshme etnike. Situata u komplikua për shkak të faktit se kufijtë etnikë nuk përputhen me kufijtë shtetërorë, por i presin nëpër grupet etnike, duke krijuar kështu armiqësi potenciale ndërmjet shteteve fqinje të cilat në masë të madhe janë keqpërdorur si në historinë e afërt ashtu edhe në atë më të largët nga ana e politikanëve lokalë.

Koloriti etnik në një shtet s’do të thotë se konflikti etnik është i pashmangshëm. Megjithatë, identitetet e ndryshme etnike nuk janë krijuar në mënyrë artificiale dhe nuk guxojnë të injorohen. Gjuha, alfabeti, religjioni, kultura, simbolet janë shumë të rëndësishme për njerëzit, sepse flasin për identitetin e tyre, për atë se kush dhe çka janë, si dhe për të drejtën e tyre për një jetë të denjë dhe përparim. Por, për fat të keq, ajo që si konstantë paraqitet gjatë konflikteve të fundit etnike dhe luftërat qytetare në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar në trojet e shteteve të ndërlikuara socialiste të Evropës Lindore dhe të Ballkanit, për shembull, është mobilizimi i një populli kundër tjetrit nga ana e liderëve lokalë ambiciozë, të cilët e shfrytëzojnë frikën, paditurinë dhe paragjykimet të cilat i kanë njerëzit për njëri tjetrin, me qëllim që ta marrin ose ta mbajnë pushtetin, të krijojnë dominancë të një kombi mbi tjetrin ose me përdorim të fuqisë ushtarake të vendosin kufij të rinj “më të drejtë”.

Në rast se identitetet e ndryshme në kuadër të një shteti multietnik, potencialisht mund të bëhen “shfarosëse”, siç paralajmëron Amin Maluf¹², atëherë a është e mundur të detektohet ndonjë zgjidhje, sidomos për shkak të asaj që është e evidente se demokracitë, sidomos ato të reja, nuk mund të mbijetojnë duke u ballafaquar me ndarje etnike serioze?

¹² Amin Maluf: “Identitetet shfarosëse”, Matica Makedonska, 2001

Pas konflikteve etnike të panumërta, tragjike ose më pak tragjike, përfshirë këtu edhe konfliktin e armatosur në vendin tonë në vitin 2001, mund të përkulemi përballë botëkuptimeve se *përrjashtimi dhe diskriminimi i pakicave është një nga burimet themelore të konflikteve etnike, sidomos nëse përcillet me varfëri, pa shpresë, zhgënjim ose frikë*. Në “shoqëritë plurale”, siç i quan A. Liphart shoqëritë që janë strikt të ndara përgjatë vijave religjioze, ideologjike, linguistike, kulturore, etnike apo racore, kryesisht sub-shoqëri të veçuara, me parti të veta politike, grupe interesash dhe media, nuk e ka fleksibilitetin e nevojshëm për demokracisë maxhoritare. Në rrethana të tilla, sundimi i shumicës nuk është vetëm jodemokratik, por është i rrezikshëm, sepse pakicave në kontinuitet u mundësohet qasje drejt pushtetit. Ata ndjehen të përrjashtuar dhe të diskriminuar dhe do ta humbin lojalitetin ndaj regjimit. “In plural societies, therefore, says Lijphart, majority rule spells majority dictatorship and civil strife rather than democracy. What this societies need is a democratic regime that emphasizes consensus instead of oposition, that includes rather than excludes and that tries to maximize the size of the ruling majority instead of being satisfied with a bare majority: consensus democracy”.¹³ Përndryshe prej vitit 1984 kur u paraqit studimi i tij komparativ: “Demokracitë: Modelet e sundimit maxhoritar dhe konsensual në 21 shtete”, ndërmjet anëtarëve të bashkësisë akademike zhvilloi debat rreth anëve të mira dhe të këqija të kësaj teorie. Komuniteti akademik kryesisht nuk ishte i njoftuar për këto debate ose në rast se e dinte, i injoronte ato. Tek sot, pasi që u ballafaquam me problemin, filluam t’i parashtrijmë të njëjtat pyetje: A mundet që modeli i zhvilluar mbi bazë të praktikës të tre shteteve shumë të zhvilluara të Evropës Perëndimore, Zvicër, Belgjikë dhe Holandë mund të shërbejë si zgjidhje për konfliktet etnike në Afrikë, Azi ose në Ballkan? Akoma më tutje, parashtrihet pyetja a janë sa duhet të motivuar liderët e grupeve për të reduktuar konfliktin, siç supozohet në këtë koncept? Çka nëse ta publikisht ose fshehurazi punojnë në thellimin e dallimeve dhe ia mësyjnë zgjidhjeve territoriale, të cilat mund të shkaktojnë jostabilitet të ri? Sipas një autori tjetër të njohur, D.Horovic, ekzistojnë nisma (incentives) tjera më të rëndësishme për akomodim, ose të ashtuquajtura “dritare të mundësive”.¹⁴ Kjo mund të jetë eksperiencia e hidhur e ndonjë konflikti paraprak i cili u ka shkaktuar dëm të madh të gjitha grupeve; ajo mund të jetë model zgjedhor i cili do të pengonte majorizimin ose t’i detyrojë liderët e grupeve të sillen racionalist që t’i fitojnë zgjedhjet; kjo mund të jetë autonomi territoriale; kjo mund të jetë një lloj “shpërblimi” për çdo koalicion ndëretnik ose kjo mund të jetë, për shembull, ndonjë interes i fortë i përbashkët si anëtarësimi në Bashkimin Evropian? Në jetën politike, konfliktet etnike të cilat u zhvilluan pas kolapsit të Bashkimit Sovjetik dhe ish Jugosllavisë, si pasojë e kërkesave të njëanshme të paskrupullta për zgjidhje territoriale për konfliktet etnike, e detyruan “bashkësinë ndërkombëtare” të kërkojë dhe ndokund të imponojë zgjidhje alternative. Duke iu përmbytur sa është e mundur më shumë parimit të mosndryshimit të kufijve me forcë, zgjidhja e konflikteve u kërkua në forcimin e të drejtave të njeriut; zgjedhjeve korrekte dhe të lira; lufta kundër krimit dhe korrupsionit; funksionimi i shtetit juridik dhe **ndërtimi/forcimi i sistemit participativ të pushtetit në të gjitha nivelet** ¹⁵, që në këtë raport e shfrytëzojmë si sinonim për konceptin “ndarja e pushtetit”.

¹³ Arend Lijphart: “Democracies”, Yale University Press, 1984

¹⁴ Donald L.Horowitz: “Ethnic Conflict Management”, in: “Conflict and Peacemaking in Multiethnic Societies”, ed. By J.V.Montville, Lexington Books

¹⁵ “An Inventory of Post-Conflict Peace-Building Activities”, United Nations, New York, 1996

Edhe pse konfliktet etnike, përfshirë këtu edhe konflikti në vendin tonë i vitit 2001 fillojnë me kërkesa maksimaliste për sovranitet territorial dhe vetëvendosje¹⁶, ata shpeshherë përfundojnë me kompromis, i cili ngërthen edhe ndërtim të sistemit participativ të pushtetit në të gjitha nivelet ose siç themi neve, model i “ndarjes së pushtetit” (power-sharing), sidomos në rast se në gjetje të përgjigjes së shpejtë dhe efikase të konfliktit u impenjuar edhe “pala e tretë”. kjo është me rëndësi të potencohet, sidomos në rastin e vendit tonë. Në fakt, edhe pse “ndarja e pushtetit” doli nga pajtueshmëria e aktorëve politik të vendit (LSDM, VMRO-DPMNE, PDSH dhe PPD)¹⁷ për të zgjidhur konfliktin e armatosur në të vitit 2001, roli i “lojtarëve” të huaj ishte dhe akoma do të jetë i madh. Bashkësia ndërkombehtarë, e cila pas një befasi dhe mëdyshjeje të shkurtër në fillim, reagoi shpejtë dhe në mënyrë efikase dhe ndihmoi që të përfundojë konflikti në vitin 2001, e promovoi modelin e “ndarjes së pushtetit” dhe ndërmori një sërë masash ushtarake, ekonomike, politike dhe diplomatike që ta sigurojë funksionimin e tij.

Në teorinë dhe praktikën politike konsiderohet se ekzistojnë dy zgjidhje legjitime për konfliktet etnike: secesioni ose ndarja e shtetit sipas vijave etnike dhe modeli i “ndarjes së pushtetit” ose ndërtim/forcim i sistemit participativ të pushtetit në të gjitha nivelet. Rreth secesionit ose ndarjes, ekzistojnë kundërthënie të ashpra. Mirëpo edhe kundërshtarët më të mëdhenj të ndarjeve, konsiderojnë se kjo zgjidhje nuk duhet a priori të hedhet poshtë ose të kihet paragjykimë mbi të, posaçërisht nëse asgjë tjetër nuk ndihmon. Megjithatë, mbisundon opinionin se ndarja është zgjidhje me rrezik të lartë e cila mund të shkaktojë jostabilitet të ri dhe konflikte të reja. Sot kur shtetet evropiane bëjnë përpjekje të mëdha për integrim, është e qartë se prevenimi i konflikteve ndëretnike kërkohet para së gjithash në njëfarë “ndarje të pushtetit” midis komuniteteve etnike në kuadër të një shteti të përbashkët. Megjithatë, nuk duhet pasur iluzion se ky koncept është “panacea” për të gjithë konfliktet ndëretnike dhe se zbatimi i tij do të krijojë gjendje të “paqes së përhershme”. Rrënjët e nacionalizmit janë të thella dhe askush nuk është imun ndaj tij. Në vitet e nëntëdhjeta, nacionalizmi maqedonas kryesisht manifestohej si albanofobi kurse sot, virusi i njëjtë i kaploi shqiptarët, sidomos para zgjidhjes së statusit të Kosovës. Liderët politikë të disa partive shqiptare, para zgjedhjeve parlamentare deklarorin se integrimi i komunitetit shqiptar në shoqërinë maqedonase është punë e kotë dhe se do të punojnë për zbatimin e zgjeruar dhe më liberal të Marrëveshjes kornizë, para së gjithash me institucione paralele shtetërore¹⁸.

¹⁶ Në librin e Fazli Veliut “UÇK, nga beteja në betejë, 2001” përkujton se “mesazhet” e tij për çlirim të shqiptarëve edhe krahas luftës nuk janë realizuar, për shkak të “faktorit ndërkombëtar”. “Adaptueshmëria për të qenë i dëgjueshëm para faktorit ndërkombëtar, është imperative në kohën nepoër të cilën kalojmë, sepse ndryshe nuk mund të arrihet synimi ynë kombëtar. Përpjekjet vazhdojnë, strategjia mbarëkombëtare duhet të arrihet në të ardhmen. Në të radhmen, gjeneratat duhet t’i kenë dyert e hapura drejt luftës finale”, ka shkruar Veliu më 25 shtator të vitit 2001.

¹⁷ Bëhet fjalë për katër parti politike, liderët e të cilave e firmosën Marrëveshjen kornizë të Ohrit më 13 gusht 2001

¹⁸ Dnevnik-u i 12 qershorit 2006, shkruan: “Partia e Arben Xhaferit konsideron se kontestet ndëretnike ende nuk janë zgjidhur, kurse votuesit i porosit të mos i besojnë politikës së integritit, sepse në një shtet me përbërje të theksuar heterogjene etnike, siç është IRJM, ka interesa të ndarë. “Integrimi nënkupton asimilim dhe njohje të aspektit unitar i cili suspendon dallimet etnike, kulturore dhe gjuhësore. Prandaj PDSH e afirmon politikën e kultivimit të lirë të diferencave. **Kjo do të realizohet vetëm me formimin e institucioneve paralele”, shkruan në programin zgjedhor.** Nga ana tjetër, si përgjigje e asaj që partia e A.Ahmetit, BDI nuk është e ftuar të merr pjesë në pushtet, edhe pse mori përkrahjen e votuesve shqiptarë, vjen kanosja se IRJM duhet të federalizohet.

3.1. Cilat janë karakteristikat e konceptit/modelit të “ndarjes së pushtetit”?

Modeli i “ndarjes së pushtetit” definohet si praktika dhe institucion etë cilat rezultojnë në koalicion të gjerë të pushtetit, e cila thënë në mënyrë të përgjithësuar është e hapur për të gjitha shoqëri dhe i pajton vetëvendosjen dhe demokracinë në grupet më relevante etnike në shtetet multietnike, parime të cilat shpeshherë dinë të jenë në konflikt.¹⁹

Shembulli shkollor i këtij modeli përmban katër karakteristika prej të cilave dy të parat kanë rëndësinë më të madhe.²⁰

1. Partecipimi i të gjitha grupeve më të rëndësishme në pushtet (para së gjithash në pushtetin ekzekutiv). Konsiderohet se në sistemin parlamentar, qeveria është e përbërë prej përfaqësuesve nga të gjitha grupet më relevante, si “qeveria e koalicionit të madh”, i plotëson kriteret për këtë model. Në sistemin presidencial, gjithashtu është e mundur shpërndarja e funksioneve ekzekutive ndërmjet përfaqësuesve të grupeve më të rëndësishme, si dhe formimi i disa komisioneve ose organeve me funksion përkatës.

2. Ekzistimi i shkallës së lartë të autonomisë grupore. Në fakt, në rast se grupi është i koncentruar territorialisht, atëherë rekomandohet t’i jepet shkallë e lartë e autonomisë në formë të pushtetit të fortë lokal. Rreth aranzhmaneve federative, opinionet e shkencës janë diametralisht të kundërta: prej miratimit të fuqishëm deri në kontestim të fuqishëm. Në rast se grupet janë të disperzuara dhe të përziera atëherë rekomandohet që në nivel nacional çështje të caktuara të vendos il grup më vete, ndërsa interesat e përbashkëta zgjidhen bashkërisht në parlamenti nacional.

3. Instrumentet dhe politika të cilat krijojnë proporcionalitet. Kjo llogaritet si standard themelor për distribuim korrekt dhe sillet si standard themelor i reprezentimit politik, emërimet në shërbimet publike dhe ndërmarrjet, ushtrinë dhe policinë, si dhe në alokimin e fondeve publike

4. Praktikimi i vetos së pakicës paraqet armë të fuqishme për mbrojtjen e interesave vitale të pakicave, madje edhe atëherë kur pakica e ndan pushtetin me shumicën. E drejta e vetos, qartë, përmban rrezik që ta çrrënjosë tërë sistemin e “ndarjes së pushtetit” nëse një ose më shumë minoritete e keqpërdorin këtë të drejtë. Kjo më së miri “puno” kur nuk përdoret shumë shpesh dhe vetëm atëherë kur ka të bëhet interesat vitale të minoritetit. Obstruksioni nga ana e shumicës, si dhe keqpërdorimi i së drejtës së vetos nga ana e pakicës, çon deri në kolaps të demokracisë participative/të kontraktuar.

Nënkuptohet, ka më shumë faktorë të cilët pozitivisht ndikojnë mbi zbatimin e modelit, por siç theksojnë ithtarët e këtij modeli, faktorët e sipërpërmendur favorizues nuk janë kusht. Ata ndihmojnë, por modeli nganjëherë funksionon edhe në mungesë të disa prej këtyre faktorëve favorizues, siç janë: madhësi e ngjashme e grupeve etnike, fuqi e barazuar ekonomike, rrezik i përbashkët ose shpërbllim e kështu me radhë. Modeli i “ndarjes së pushtetit” u adaptohet rrethanave në të cilat zbatohet. Megjithatë në këtë

¹⁹ Timothy D.Sisk:”Power-sharing and International Mediation in Ethnic Conflicts”, USIP, 1996

“Power-sharing , defined as practices and institutions that result in broad-based governing coalitions generally inclusive of all major ethnic groups in society, can reconcile principles of self-determination and democracy in muliethnic states, principles that are often perceived to be at odds”

²⁰ Modeli është i ndërtuar mbi bazë të hulumtimit të Arend Liphart

kontekst, duhet të merren parasysh paralajmërimet e T. Sisk²¹ se aranzhmanet e “ndarjes së pushtetit” me sukses e qetësojnë konfliktin nën kushtet në vijim: 1. të jenë pranuar nga një grup sa e do nevoja i madh i liderëve politikë të cilët kanë kaluar nëpër konfliktin dhe ata të jenë zgjedhur si përfaqësues të popullit të vet; 2. “ndarja e pushtetit” të mos jetë rezultat kryekëput i trysnisë së fuqishme të “aktorëve” të jashtëm ose të short-term, zero-sum expectations of the parties; 3. Partitë gradualisht të qasen drejt formave më të integruara dhe më liberale të demokracisë.

3.2. *Specifitetet e vendit tonë.*

Karakteristikat themelore të këtij modeli të përgjithshëm, janë adaptuar dhe janë ndërtuar në strukturën e shtetit maqedonas, me procedurë amenduese me të cilën vendimet e Marrëveshjes kornizë të Ohrit u bënë pjesë e sistemit kushtetues të vendit dhe ne do t'i shqyrtojmë shkurtimisht në këtë kontekst:

1. **Koalicioni i madh në pushtet?** Ky element i konceptit të “ndarjes së pushtetit” është prezent prej vitit 1991 si *koalicionim ndëretnik*, që është e rëndësishme për krijimin e një klime më të matur politike. Thujtje është e pamundur të paramendohet një qeveri e cila nuk do të ishte në koalicion me ndonjë nga partitë parlamentare shqiptare, që të sigurohet shumicë në Kuvendin e IRJM-së. Si pasojë nga kriza rreth formimit të qeverisë pas zgjedhjeve të fundit parlamentare (korrik 2006) në vendin tonë, me gjasë do të jetë në të ardhmen formimi i koalicioneve parazgjedhore ndëretnike dhe ndërpartiake “sipas bindjes”, që mund të përfaqësojë nxitje për sjellje më të matur të udhëheqësive të partive politike.
2. Ndërkaq, problemi i përfaqësuesve **“pakicat shumë të vogla”**. Nëse këto pakica janë 1-2% të popullatës, ata nuk mund të presin se do të bëhen pjesë e sistemit të “ndarjes së pushtetit”. Ekzistojnë dy mënyra për t'u ballafaquar me nevojat e këtyre pakicave. Nëse pakica është gjeografikisht e koncentruar, atëherë krijimi i regjionit autonom ose pushteti i fortë lokal duket si zgjidhje logjike. Në rast se nuk është kështu, me gjasë do të shfaqen kërkesa për ndonjë lloj të autonomisë kulturore autonome. Disa nga komunat në vendin tonë, me gjasë do ta tregojnë përparësinë e modelit të “ndarjes së pushtetit”, me atë që pakicat më të vogla etnike, si ajo turke apo rome për shembull, do të bëhen pjesë e pushtetit komunal. Në nivel nacional, gjithashtu është e mundur që të forcohet pozita e pakicave të vogla etnike, ashtu që do të garantohen një numër i caktuar i vendeve të deputetëve për pakicat e vogla etnike. Kushti që një bashkësi të paraqet 20% të popullatës që të gëzojë të drejtat kolektive, paraqet pengesë për participim të komuniteteve më të vogla dhe në botën reale krijon nga vendi ynë shtet binacional, me ç'rast këto “komunitete të vogla” ndjehen të përjashtuara dhe të diskriminuara, ashtu që është një pikëpyetje e madhe a nuk duhet të rishqyrtohet kjo zgjidhje kushtetuese.
3. **Proporcionaliteti** është, gjithashtu, i përfaqësuar në “modelin maqedonas”. Modeli burimor është pastër proporcional, që u mundëson bashkësive të vogla etnike të jenë madje edhe të mbireprezentuar në organet përfaqësuese. Proporcionaliteti manifestohet edhe në kërkesën për “shpërndarje të drejtë” të resurseve shoqërore. Pas viti 2001 është përcaktuar parim kushtetues për përfaqësim adekuat të

²¹ Timothy D.Sisk: “Power-sharing and International Mediation in Ethnic Conflicts”, USIP, Washington

bashkësive pakicë në administratën publike, ushtrinë, policinë, si dhe në administratën publike.

4. **E drejta e vetos** gjithashtu është pjesë e këtij modeli të “ndarjes së pushtetit” dhe te kjo e drejtë është e njohur si “shumica e Badenterit” (sipas emrit të juristit të njohur francez, Badenter). E drejta e vetos është e njohur në praktikën e funksionimit të Belgjikës dhe Zvicrës për çështje të cilat i shqetësojnë interesat vitale të komuniteteve të posaçme etnike dhe gjuhësore të cilat jetojnë në kuadër të këtyre shteteve. Në kushtetutën e vendit tonë, kjo e drejtë e vetos quhet **shumica e posaçme** dhe zbatohet për çështje saktësisht të definuara.²² Prej 120 deputetëve në Kuvendin e IRJM-së, 35 janë deklaruar se i takojnë të ashtuquajturës “shumicë e posaçme”, respektivisht se nuk janë maqedonas për nga përkatësia etnike. Ndërkaq, numri më i madh i tyre, 27 janë shqiptar, kështu që në praktikë, këtë të drejtë e shfrytëzon vetëm komuniteti etnik shqiptar. Gjatë intervistës me disa deputetë të cilët i takojnë nacionalitetit turk dhe rom, na u pat thënë se aspak nuk ekziston praktikë e ndërtimit paraprak të platformës së përbashkët politike, sepse “Deputetët shqiptarë nuk kanë asçfarë nevojë për këtë. Ta kan ëshumicën”.
3. **E drejta e vetos së përfaqësuesve të bashkësive pakicë në këshillin e komunës.** Rregullat të cilat i takojnë kulturës, përdorimit të gjuhëve dhe alfabeteve në të cilat flasin më pak se 20% e qytetarëve në komunë, caktimi dhe përdorimi i stemës dhe

²² Kjo implementohet në situatat në vijim:

- a) Për ligjet të cilat drejtpërdrejtë prekin kulturën, përdorimin e gjuhëve, arsimin, dokumentet personale dhe përdorimin e flamujve. Kuvendi vendos me shumicë votash të deputetëve të pranishëm, **me ç’rast doemos të ketë shumicë votash nga deputetët prezent të cilët i takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në IRJM(neni 69);**
- b) Gjatë zgjedhjes së avokatit popullor, me ç’rast krahas shumicës nga numri i **përgjithshëm** i deputetëve, doemos të ketë edhe shumicë të **numrit të përgjithshëm të deputetëve të cilët i përkasin bashkësive të cilat nuk janë shumicë në IRJM**
- c) Me rastin e zgjedhjes së tre gjykatësve në Gjyqin kushtetues, me ç’rast krahas shumicës së votave nga numri i **përgjithshëm** i deputetëve, doemos të ketë **shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët i takojnë bashkësive të cilat nuk paraqesin shumicë në IRJM;**
- d) Me rastin e zgjedhjes së tre gjykatësve në Këshillin republikan gjyqësor, me ç’rast krahas shumicës së votave nga numri i **përgjithshëm** i deputetëve, doemos të ketë **shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët i takojnë bashkësive të cilat nuk paraqesin shumicë në IRJM;**
- e) Gjatë miratimit të Ligjit për vetëqeverisje lokale, me ç’rast krahas shumica e 2/3 nga numri i **përgjithshëm** i deputetëve, doemos të ketë **shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët i takojnë bashkësive të cilat nuk paraqesin shumicë në IRJM;**
- f) Ligjet për finansim lokal, zgjedhje lokale, kufij komunal dhe për Qytetin e Shkupit miratohen me shumicë votash nga deputetët e **pranishëm**, me ç’rast p-atjetër të ketë **shumicë nga deputetët e pranishëm të cilët i takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në IRJM;**

Gjatë miratimit të vendimit për ndryshim të Preambulës, anëtarët e vetëqeverisjes lokale, neni 131, ciladoqoftë dispozitë e cila ka të bëjë me të drejtat e pjesëtarëve të bashkësisë, përfshirë këtu sidomos nenet 7,8,9,19,48,56,69,77,78, 86,104 dhe 109, si dhe vendimin për shtimin e cilës do qoftë dispozitë e cila ka të bëjë me lëndën e atyre dispozitave dhe neneve, do të duhej shumicë 2/3 e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, **në të cilën patjetër të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në IRJM**

flamurit të komunës miratohen me shumicë votash, me ç'rast patjetër të ketë shumicë votash edhe nga anëtarët e pranishëm të këshillit të cilët nuk u takojnë komuniteteve që nuk janë popullatë shumicë (neni 41 nga Ligji për vetëqeverisje lokale).

Kjo e drejtë, si dhe e drejta për përfaqësim të drejtë të komuniteteve; përdorimi i simboleve dhe Komisionit për marrëdhënie ndërnacionale në komunat, janë objekt i monitorimit tonë gatë vitit 2006 ndërsa konkluzionet dhe rekomandimet janë pjesë e këtij raporti.

4. HIPOTEZAT

Arsyetimi teorik i konceptit “ndarja e pushtetit” sidomos nevoja për zbatim të tij praktik kërkon që të vendosim disa hipoteza të përgjithshme dhe të posaçme të cilat shërbejnë si pikënisje për grumbullimin e materialit hulumtues të procesit të vendimmarrjes në komunat:

- Përjashtimi i përhershëm i pakicave nga qasja te pushteti, kultura e tyre, diskriminimi ekonomik dhe politik ose marginalizimi, ligjërisht konsiderohet si shkak për konfliktet etnike të cilat mund të kalojnë në dhunë, madje edhe në luftë qytetare. Modelet, politikat dhe instrumentet të cilat çojnë në involvimi i pakicave në pushtet dhe shfrytëzim të instrumenteve të pushtetit, e rrit mundësinë për evitim të llojeve më të këqija të konfliktit. Konfliktet e ligjshme politike, eventualisht mbeten në institucionet e shtetit dhe atje zgjidhen
- Decentralizimi i pushtetit është një nga mënyrat (politikat) për reduktim të konfliktit etnik. Supozohet se konflikti është më pak i rrezikshëm, sikur të jetë i reduktuar në nivel lokal. Konsiderohet se autonomia lokale, do t'i mundësojë qasje më të mirë dhe më efikase drejt instrumenteve të pushtetit lokal të grupit minoritar i cili është i koncentruar në një territor të caktuar, me çka reduktohen konfliktet. Gjatë kësaj është e rëndësishme që decentralizimi i pushtetit të mos nxit fragmentim të mëtejshëm të shoqërisë.
- Tajmingu gjatë aprovimit të masave dhe politikave për reduktim të konfliktit etnik është shumë i rëndësishëm. Në rast se shkohet në prag të konfliktit të mundshëm dhe pushteti lokal i jepet në duar pakicës, shanset për qetësimin e konfliktit janë shumë të mëdha, sesa nëse zgjidhjet për decentralizim janë të imponuara, pas përfundimit të konfliktit, si përjashtim që shumica është e detyruar ta bëjë.
- Faktorët favorizues për zbatim të modelit “ndarja e pushtetit”, mungojnë për shkak të varfërisë (dhe problemeve tjera ekonomike) të cilat e rritin dhe e ashpërsojnë diskriminimi eventual. Besimi i humbur ndërmjet bashkësive etnike pas konfliktit të vitit 2001, gjithashtu ndikon si faktor negativ mbi zbatimin e modelit. Reformimi i sistemit nën tryshinë e “bashkësisë ndërkombëtare” nuk është faktor favorizues, por nga ana tjetër ofron shanse bashkësive etnike të cilat kanë qenë të involvuara në konflikt të pajtohen dhe të gjejnë interesa të forta të përbashkëta, të cilat do t'i tejkalojnë rrethanat më pak favorizuese.
- Punësimi në sektorin publik është një nga ato pak të mira publike të cilat politikanët lokal ende i kanë në duart e veta, gjë që i ashpërson konfliktet politike dhe etnike. Ridistribuidimi i të mirave publike në komunat, në rrethana të tilla, do të jetë burim i konflikteve të ardhshme, sidomos në rast se zhvillohet politikë e tipit “zero-sum-game” respektivisht politikë e përmirësimit të pozitës së një

bashkësie, në llogari të tjetrës. The main risk to Ohrid implementation is its tendency, in an environment of declining public resources, to reduce to a series of zero-sum-games between the ethnic Macedonians and Albanian communities. Only a serious commitment from the European Union can break that dynamic by generating opportunities for both communities to participate equally in a balanced process of development

- “Deficiti demokratik” respektivisht çështja për atë se si janë të organizuara institucionet publike dhe si distribuohen resurset publike në fokus të analizës politikologjike. **Ridistribuími i resurseve të pamjaftueshme publike do të krijojë ngadhënjimtarë dhe humbës në atë proces dhe mund t’i përkeqësojë marrëdhëniet ndëretnike, në rast se vazhdojnë proceset ekonomike negative.**
- Modeli i “ndarjes së pushtetit” (vendimarrja me konsensus, proporcionaliteti dhe e drejta e vetos) mund ta rritin kohezionin social, por gjithashtu të nxitin paralizë në procesin e vendimarrjes, në rast se keqpërdoret e drejta e “vetos së pakicës” nga ana e pakicave ose në rast se bëhet obstruksion nga ana e shumicës.
- Tensionet etnike patjetër të shihen si simptome të problemeve më të thella, siç janë diskriminimi dhe cenimi i të drejtave bazike të pakicave. Të hulumtohet, diagnostifikohet dhe përshkruhet gjendja me të drejtat e pakicave për participim të plotë dhe efikas, mund të ndihmojë që të korrigjohet praktika e me këtë edhe të mënjanohej shkaqet e tensioneve etnike dhe dhunës.

5. METODOLOGJIA

Ekipi i ekspertëve i Qendrës për paqe dhe demokraci: ”Ian Kolins”, përgatiti metodologji, indikatorë dhe instrumente, të cilat ishin të orientuara drejt përbushjes së qëllimit të përgjithshëm të projektit (overall objective) dhe qëllimeve specifike (specific objectives) të Projektit.

Për këtë qëllim, ekipi i hulumtimit u përcaktua për procedurat metodologjike në vijim:

1) **Zgjedhja e mostrës së hulumtimit.** U përcaktua që hulumtimin dhe procesin e monitorimit ta realizojmë në katër komuna në vendin tonë, të cilat kanë përbërje të përzier etnike: Gostivar, Kërçovë, Dibër, dhe Strugë. Në secilën prej këtyre komunave, dy komunitetet më të mëdha etnike, maqedonasit dhe shqiptarët paraqesin edhe shumicën edhe pakicën. (Në Kërçovë, shqiptarët janë pakicë, ndërsa në Strugë, Gostivar dhe Dibër, ata paraqesin pakicë të madhe, me mbi 20%, ndërsa romët janë shembull për pakicë të disperzuar, e cila në mostrën tonë më së shumti haset në Kërçovë, Gostivar dhe Dibër. Posaçërisht, ishte shumë me rëndësi të zgjidhen komunat ku pakicat janë mbi 20% për shkak të zbatimit të të drejtave të pakicave të përcaktuara me Ligjin për vetëqeverisje lokale.

2)

Komuna	Kërçovë	Strugë	Gostivar	Dibër
Struktura e popullatës				
Maqedonas	53,55 %	32,09 %	19,58 %	14,30 %
Shqiptarë	30,53 %	56,85 %	66,69 %	44,77 %
Turq	8,06 %	5,72 %	9,86 %	34,75 %
Serbë	0,29 %	0,17 %	0,20 %	0,08 %
Romë	5,41 %	0,18 %	2,76 %	4,09 %
Vlleh	0,25 %	1,04 %	0,02 %	0,01 %
Boshnjakë	0,02 %	0,16 %	0,05 %	0,01 %
Të tjerë	1,88 %	3,79 %	0,85 %	1,99 %

3) Formimi dhe trajnimi i stafit të hulumtuesve/monitorëve

Këtë detyrë, sipas kriterëve, e merr OJQ ADI nga Gostivari. Kriteret për zgjedhje të monitorëve ishin që ata t'u përkasin të gjitha bashkësive më të mëdha etnike, meçka do të arrihej balancë etnike, si dhe të jenë të përfaqësuar meshkuj dhe femra, për shkak të arritjes së balanit gjinor. Përderisa kriteri për balancë etnik u respektua, balanca gjinore mungoi.²³

Monitorët u trajnuan se si ta përcjellin dhe ta analizojnë procesin e vendimmarrjes në komunat, **me ç' rast njësi e vëzhgimit ishte seanca e Këshillit të komunës**. Ata gjithashtu, grumbulluan indikatorë objektiv për komunën, dokumente si Statuti i komunës dhe Rregullore për punë të Këshillit, procesverbale nga seancat dhe dokumentacion tjetër i nevojshëm. Ata, gjithashtu intervistuan disa këshilltarë të cilët i takojnë partive të ndryshme politike dhe funksionarë komunalë.

²³ Lista e monitoruesve:

Gostivar:
Lulëzim Haziri
Njomza Selimi
Natasha Tanceska
Lair Ismail

Kërçovë:
Shaban Dalipi
Goran Belovinov
Aleksandra Krsteska Cedomir

Dibër
Atli Dema
Agim Mustafai
Katica Apostolovska

Strugë
Shpend Vinca
Toni Kostovski

4) Përpunimi i metodologjisë, indikatorë dhe instrumente, me udhëzime për plotësim

Ekipi i ekspertëve e zhvilloi metodologjinë e hulumtimit dhe procesin e monitorimit, bëri një pilot-hulumtim në organet përfaqësuese të pushtetit të Republikës dhe i përpunoi instrumentet në vijim:

- protokoll për ndjekjen e seancave të këshillit të komunës
- instrumente për grumbullimin e treguesve objektiv për komunën
- intervistë me një anëtar të këshillit
- intervistë me një anëtar të udhëheqësisë të një partie politike e cila ka këshilltar
- intervistë me funksionar përgjegjës në komunë për kulturë
- intervistë me funksionarin e komunës përgjegjës për zhvillim ekonomik
- instrument për përdorim të flamujve

5) Analiza e materialit nga hulumtimi i procesit të monitorimit

Pas procesit të përfunduar të hulumtimit dhe monitorimit të seancave të Këshillit të komunës, (prej muajit nëntor të vitit 2005 deri në fund të vitit 2006) ekipi i ekspertëve iu qas analizës të rreth 68 instrumenteve, dokumentacionit dhe treguesve statistikor, si përgatitje për hartimin e raportit të hulumtimit dhe rekomandimet për lobim.

6) Analiza e legjislativës vendore dhe ndërkombëtare e cila i referohet të drejtave të pakicave

Në analizën e ekipit të ekspertëve i përshiu dokumentet dhe ligjet në vijim

- Konventën kornizë për mbrojtje të pakicave nacionale (Framework Convention for the Protection of National Minorities)
- Marrëveshjes evropiane për gjuhët regionale dhe të minoriteteve (European Charter for Regional and Minority Languages)
- Karta evropiane për vetëqeverisjen lokale
 - Marrëveshja kornizë e Ohrit
- Kushtetuta e IRJM-së
- Ligji për vetëqeverisje lokale
- Ligji për financim të njërive për vetëqeverisje lokale
- Ligji për kufijtë komunalë dhe norma të tjera ligjvënëse
- Statuti i komunave dhe Rregulloret për punë të organeve të pushtetit komunal

7. Fokus grupet

Ekipi i ekspertëve bisedoi në temën për mbrojtje të pakicave, participimi i tyre i plotë dhe efikas në vendimarrje, si dhe për procesin e decentralizimit me katër fokus grupe, nga komunat Gostivar, Dibër, Kërçovë dhe Strugë. Secili fokus grup përbëhej prej anëtarësh të këshillit, monitorësh, përfaqësuesish të organizatave joqeveritare dhe gazetarësh.

7. Opinioni publik

Ekspertët e ekipit hulumtues dhe të agjencisë për hulumtim të opinionit publik, “Brima Galup”, përgatitën anketë për mostër reprezentuese prej 600 qytetarësh nga Gostivari, Kërçova, Dibra dhe Struga, për çështje që ndërlidhen me objektin e hulumtimit. Pyetjet kryesisht i referoheshin vlerësimit të qytetarëve nga këto komuna për punën e pushtetit të ri lokal, kryetarin e komunës dhe marrëdhëniet ndëretnike në komunat

8. Analiza e materialit dhe hartimi i Raportit për rezultatet nga hulumtimi dhe procesi i monitorimit, me rekomandime për lobim

Në bazë të të gjitha procedurave të përmendura metodologjike, si dhe literatura politikologjike në këtë temë të Qendrës për paqe dhe demokraci: "Ian Kolins", përgatitën raport hulumtimi me konkluzione dhe rekomandime, të cilat do të shërbejnë si bazë për lobim. Qëllimi i raportit është që të detektohen problemet dhe të vihet në dije në cilën kahe duhet të ndryshojë rregullativa ekzistuese ligjore, si dhe praktika politike që të realizohet një participim aktiv, i plotë dhe efikas i pakicave në pushtetin në komunat multietnike të vendit tonë.

II. REZULTATET NGA HULUMTIMI

1. Decentralizimi i pushtetit. Shumica si pakicë. Pakicat shumë të vogla

Dizajni territorial zakonisht tregohet si instrument i frytshëm për reduktim të konflikteve. Ndërkaq dizajni i këtillë, i cili mund të paraqitet në formë të federatës, autonomi ose krijim të një vetëqeverisjeje të fortë lokale (devolucion i pushtetit), pashmangshëm e ngrit çështjen e deri ku mund të shkohet me devolucion të pushtetit ndrysa të shmangët situata në të cilën ajo do të përfaqësojë nxitje për fragmentim të mëtejshëm të shtetit. Autonomia regjionale ose aranzhmanet federale komentohen si koncesion i padyshimtë i sentimenteve separatiste. Frika e përhapur se format e ndryshme të autonomisë regjionale e ushqen secesionizmin dhe është vështirë të hedhet poshtë si i pabazë. Në këto hulumtime mund të jepet përgjigje në dy mënyra. Njëra përgjigje është pushteti qendror ta ruajë kontrollin e skajshëm mbi influencën e pushtetit lokal.²⁴ Mënyra e dytë është të eliminohet opozita e autonomisë regjionale ose decentralizimi do të thotë që ajo t'u jepet të gjitha regjioneve e jo vetëm regjioneve ku konfliktet etnike potencialisht mund të shndërrohen në kërkesa për secesion. Përvoja paralajmëron në rëndësinë e tajmingut. Në rast se autonomia ofrohet para se të fillojë konflikti, kjo mund të konsiderohet si shtrirje e dorës nga fuqitë e matura të cilat angazhohen për ekzistencë të shtetit në kufijtë ekzistues. Dhënia e autonomisë, pas konfliktit, mund të konsiderohet si dobësi e pushtetit qendror.

Marrëveshja kornizë e Ohrit fillon me mesazhin e rëndësishëm se “nuk ka zgjidhje territoriale për konfliktet etnike” dhe logjikisht me këtë, vijon se IRJM është shtet unitar”. Si përjashtim nga karakteri unitar i shtetit, është arritur pajtueshmëri për nivelin e lartë të decentralizimit të pushtetit. Ndërkaq, një nga pikat e Marrëveshjes së Ohrit, megjithatë “nëpër kapixhik” e futi parimin territorial si zgjidhje e konfliktit etnik në vitin 2001. Në fakt, e drejta e vetos së pakicë e cila zakonisht shfrytëzohet për mbrojtje të identitetit të ndonjë pakice, gjuhës së tij, kulturës dhe arsimit, këtu është zgjeruar edhe në definimin e kufijve të ri komunalë.²⁵ Nënkuptohe, konflikti i armatosur i cili mbaroi me ndërmjetësim të bashkësisë ndërkombëtare, detyrimisht në vete përmban koncesione të caktuara, por zgjidhja kushtetuese e cila kërkon pajtueshmëri minimale, respektivisht miratim të kufijve të rinj komunalë me shumicë të thjeshtë në Kuvendin e IRJM-së, në vend të shumicës së kualifikuar (dy të tretat), shkaktoi pakënaqësi të gjerë²⁶ te qytetarët dhe te opozita politike.

²⁴ D.Horowitz në librin: “Ethnic Groups in Conflict” thekson se në Sudan, Sri Lankë dhe Spanjë, autoritetet qeveritare kanë qenë në gjendje ta mbajnë këtë kontroll pa mos e humbur bashkëpunimin e gupeve lokale të cilat kanë dobi nga ky proces. (1985)

²⁵ Në nenin 114 të kushtetutës së IRJM-së, të gjitha ligjet për vetëqeverisje lokale si dhe për kufijnjt komunalë miratohen me shumicë votash nga të deputetët e pranishëm, me ç'rast patjetër të ketë shumicë votash të deputetëve të pranishëm të cilët u takojnë bashkësisë të cilat nuk janë shumicë në Republikë.

²⁶ A.Bexheti në: “Decentralizimi dhe politizimi” (Forumi multietnik, dhjetor 2004) shkruan për politizimin e procesit të decentralizimit, “kur dihen mungesa e transparencës dhe injorimi i tyre ndaj opozitës gjatë hartimit të hartave lokale me interesa të ngushta partiake, përndryshe si mundet ndryshe të komentohet bashkangjitja e komunës së Xhepçishtit me Tetovën, ajo e Kamenjanit me atë të Bogovinës dhe shkëputja e komunës Hanet e Mavrovës nga Gostivari”. “Në këtë proces, shkruan më tutje Bexheti, nuk mund të amnistohet bashkësia ndërkombëtare- posaçërsisht ata të cilët e

Vetë procesi i decentralizimit, paraqet politikë të prevenimit të konflikteve etnike, sidomos atje ku pakica është e koncentruar territorialisht. Supozohet se mundësia që pakica e shtetit të bëhet shumicë në nivel lokal, do ta zvogëlojë rrezikun nga konflikti në shtet ose do ta reduktojë në përmasa lokale, gjë që është më pak e rrezikshme për stabilitetin e shtetit dhe do të kontribuojë për zhvillim më të shpejtë të komunave. Në teorinë dhe praktikën politike u bë një e vërtetë konvencionale se ndarja horizontale e pushtetit në ligjvënësë, ekzekutiv dhe gjyqësore, si dhe ndarja vertikale në pushtet qendror dhe lokal, përfaqëson mjet për kufizimin e pushtetit me mjete kushtetutuese. Kjo, tekefundit, është esenca e konstitucionalizmit të çdo shteti demokratik modern, përfshirë këtu edhe vendit tonë. Institucioni i “kontrollit gjyqësor”, si pjesë e konstitucionalizmit, bie në radhën e kërkesave për ruajtjen e kontrollit të skajshëm të pushtetit qendror mbi pushtetin lokal dhe mbijetesën e shtetit demokratik. Nëse këto parime zbatohen mbi vendin tonë, mund të thuhet se sistemi i vetëm gjyqësor e sidomos Gjyqi Kushtetues, bëjnë kontroll mbi kushtetutshmërinë e vendimeve që miratohen nga ana e pushteteve lokale. Gjyqi kushtetues, për shembull, ndërmyet tjerash për kryqëzimin (përplasjen, ndeshjen) e ingerencave ndërmyet organeve të Republikës dhe njërive të vetëqeverisjes lokale. Në ligjin për vetëqeverisje lokale, është përcaktuar se mbikëqyrjen e punës së organeve komunale në kryerjen e kompetencave të saja, mbikëqyrjes ndaj ligjshmërisë dhe kontrollit mbi punën materiale dhe financiare, kryen ministria kompetente për kryerjen e punës së vetëqeverisjes lokale. Në mbikëqyrje janë gjithashtu të kyçur organet e administratës shtetërore dhe Enti shtetëror për revizion. Këtë e theksojmë për shkak të njohurive deri te të cilat erdhëm gjatë hulumtimit, se organet shtetërore janë të ngadalshme, joefikase ose të anëshme. Kjo për shembull, e bën pakicën maqedonase të ndjehet e lënur pas dore (vetë në vete). Nga ana tjetër, të pakënaqura janë edhe partitë politike përfaqësuese të shumicës shqiptare. Për shembull, një prej kryetarëve të komunës lëshon sinjal me deklaratën se për shkak të asaj se gjyqësia, ka qenë e korruptuar, nuk do t’i respektojnë vendimet e Gjyqit suprem, të cilat i referohen punës së tij dhe se nuk ka nevojë për një sistem të vetëm gjyqësor. Me fjalë të tjera, dobësia e institucioneve, i rrezikon frytet pozitive të procesit të decentralizimit.

Për se decentralizim? Një, sepse është absurde të administrohet nga qendra me të gjitha funksionet dhe shërbimet, tjetër, hapet mundësi për participim më të madh dhe më efikas të qytetarëve të cilët jetojnë në komunat, që do të thotë se edhe bashkësitë etnike minoritare do të realizojnë participim më të madh dhe më efikas në krijimin e politikës së komunës. Ajo që e parashtrua si pyetje në fillim të procesit tonë të monitorimit është se sa realisht pushteti është i decentralizuar? A disponon me fuqi të mjaftueshme ekonomike dhe politike komuna që t’i realizojë ingerencat e shtuara? Vetëm në rast se përgjigja është pozitive, atëherë mund të flitet për “participim të plotë dhe efektiv” të pakicave në komunat në procesin e vendimarrjes. Në Konventën kornizë për mbrojtje të pakicave nacionale reagohe kundër suspendimit të pakicave nga procesi i vendimarrjes nacionale dhe lokale, kurse kjo konventë është pjesë e sistemit tonë juridik dhe politik. „In the Explanatory Report accompanying the Framework Convention, States are encouraged to promote the “effective participation of persons belonging to national minorities in the decision-making process and elected bodies both at national and local level”²⁷. Mendohet, para së gjithash, në përfaqësimin adekuat të pakicave në nivel nacional dhe lokal në

garantojnë Marrëveshjen e Ohrit. Disa herë edhe ata vetë morën të drejtën që të kërkojnë depolitizim të këtij procesi tipik politik, në vedn të departizimit të tij”

²⁷ “Filling the Frame”, Council of Europe Publishing, 2004

organet e përfaqësimit, por edhe në një sërë politikash dhe instrumentesh për participim të plotë dhe efikas, të cilat do të dalin nga praktika imagjinative.

Vetë procesi i decentralizimit nuk ishte objekt i hulumtimit tonë dhe monitorimi disamujor me gjasë është i mjaftueshëm vetëm të hapen çështjet problematike të cilat e përcjellin këtë proces afatgjatë, të komplikuar dhe të shtrenjtë. Do të përmendim disa nga problemet themelore të cilat dolën nga ky hulumtim dhe monitorim i procesit të vendimarrjes në komunat nga mostra:

1. Ngushtë dhe pashmangshëm me decentralizimin është e lidhur çështja e kufijve të rinj. Edhe pse ligji tashmë është miratuar dhe në referendum qytetarët e vendit tonë e konfirmuan marrëveshjen e arritur në suaza të koalicionit të atëhershëm qeveritar²⁸, megjithatë mbetet pakënaqësia e maqedonasve të Strugës dhe Kërçovës. Nga ana tjetër, në këtë hulumtim e vërejtëm kënaqësinë e rritur, të bazuar në shpresën për ardhmërinë më të mirë të qytetarëve shqiptarë nga komunat Strugë, Gostivar dhe Dibër, edhe pse është e qartë se statusi i tyre shoqëror nuk ka ndryshuar shumë gjatë këtyre dy viteve. Për shembull, në këtë dhe në komunat tjera të mostrës sonë, bashkëbiseduesit shqiptarë e përkrahin ligjin për ndarje territoriale dhe vetëqeverisje lokale (madje disa prej tyre konsiderojnë se duhet të vijë deri në zvogëlime të reja të komunave, *(në vendin tonë të ketë 30-40 komuna ose vetëqeverisje dynivelëshe*²⁹). Përkundër kësaj, bashkëbiseduesit maqedonas dhe turq kanë frikë, shprehin pasiguri dhe pakënaqësi. Ja disa nga deklaratat e tyre më karakteristike:

“Në aspekt të ndarjes territoriale, ligji për decentralizim nuk ka përfunduar, nuk është mbajtur llogari për parametrat ekonomikë për krijimin e një komunë në këto kufij; Çështjet të cilat janë të rregulluara me veto në Ligjin për vetëqeverisje lokale nuk sigurojnë pjesëmarrje të këshilltarëve minoritarë në vetëqeverisjen lokale” (Strugë).

“Kërçova duhet të mbetet në këto kufij që të funksionojë më mirë; për shkak të bashkimit të pjesëve urbane dhe rurale do të zvogëlohen e efektet e decentralizimit; propozimi për kufijtë e rinj të komunës janë absurde, sepse me qytetin duhet të bashkohen madje 5 vende rurale e disa prej tyre janë të larguara 100 km prej qytetit”

“Me decentralizimin e ri komuna e Strugës është e vendosur në korniza më ndryshe dhe janë përzier lagje rurale dhe urbane. Ajo me madhësinë e vet mundëson administrim efikas”.

Bashkëbiseduesit, maqedonas etnik, të cilët janë në pushtetin komunal ose organizatat politike komunale, të cilat intervistuaam, presin që ky organizim i ri komunal negativisht të manifestohet mbi zhvillimin e mëtutjeshëm të komunës. *“Arsimi do të jetë viktima e parë, sepse do të zvogëlohet nacionaliteti maqedonas dhe do të shqiptarizohen maqedonasit myslimanë” (Strugë)*

“Marrëveshja e Ohrit vetëm nga njëra palë zbatohet. Përrjashtimet i bëjnë vetëm maqedonasit kurse qytetarët e thjesht nuk e kuptojnë sa duhet, me çka konsiderojmë se vjen deri në abuzim” (Strugë)

“Në parim është ide e mirë decentralizimi; por, në mënyrë katastrofale është idealizuar koncepti për ndarje territoriale. Ana pozitive: transfer i kompetencave nga pushteti qendror në pushtetin lokal” (Strugë)

Edhe pjesëtarët e komunitetit turk (Kërçovë dhe Strugë) shprehin pakënaqësinë e tyre për këtë ligj sepse, sipas tyre, atyre u është bërë padrejtësi: *“Prej 4 komunave me shumicë të popullatës turke tani mbetën vetëm dy; Popullata turke nga komuna do të jetë nënshtruar*

²⁸ Mendohet në qeverinë e koalicionit LSDM dhe BDI, 2002-2006

²⁹ Në kurziv janë vënë deklaratat e qytetarëve të intervistuar, anëtarëve të Këshillit të komunës, funksionarë të administratës komunale dhe kryetarëve të komunave

asimilimit të mëtejshëm nga ana e shumicë shqiptare...” . në bisedë me funksionarë të partive etnike të turqve, kjo pakënaqësi me suprimimin e disa komunave tradicionale turke si për shembull Xhepçishti, është konfirmuar. “Nuk janë fajtorë shqiptarët, por Maqedonasit, të cilët bënë Pazar me shqiptarët në llogarinë tonë. Bashkësia ndërkombëtare na harroi gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit dhe u bë kumbarë e “shtetit binacional”, edhe pse të gjithë e kuptojmë se ishim në tehun e luftës civile e cila duhej të ndalohej”

Nënkuptohet pakënaqësia të maqedonasit e komunës së Strugës vjen për shkak të faktit se janë humbur edhe disa nga privilegjet e tyre të mëparshme, por gjithashtu edhe për shkak të faktit që ndryshimet dolën si rezultat i koncesioneve politike pas konfliktit të vitit 2001. Ata llogariten si viktima. Si të plotësohet parimi demokratik, i shënuar në Kartën evropiane për vetëqeverisje lokale se qytetarët në referendum prononcohen për ndryshim të kufijve komunalë, me vendimin politik të elitave politike të bëhet rishpërndarje e pushtetit në favor të komunitetit të dytë për nga madhësia në këtë shtet? Zgjidhje u gjet në suprimimin e mbivotimit të shumicës (në referendum) për çështje të marrëdhënieve ndëretnike, siç është çështja e kufijve komunalë, që të mbahet edhe balancimi delikat etnik. A është bërë kjo në mënyrën më të mirë, nuk ishte objekt i këtij hulumtimi por ajo që duam të nënvizojmë është se akoma ekziston përçarje ndërmjet dy bashkësive më të mëdha etnike: maqedonasit dhe shqiptarët. Fakti që njëra palë është e pakënaqur, ndërsa të tjerët janë të kënaqur nga ajo që është arritur me Marrëveshjen kornizë të Ohrit, mundet që potencialisht të bëhet burim për konflikte të reja. Për këto arsye, mendojmë se duhet të forcohen në praktikë të drejtat e pakicave për participim efektiv në pushtetin komunal që do të përfaqësojë kundërpeshë adekuate të tendencave për zgjidhje territoriale të konflikteve etnike. Fatkeqësisht, katër vite nga miratimi i Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe një vit nga funksionimi i udhëheqësive të reja komunale, institucionet dhe praktikat për mbrojtje të të drejtave të pakicave në komunat janë në vet fillimin, që u tregua në hulumtimin.

2. Problemi i dytë në lidhje me decentralizimin të cilin e vërjetëm gjatë hulumtimit është **transferi i kompetencave dhe decentralizimi fiskal.**

Vetë procesi i decentralizimit në intervistën dhe inspektimin e opinionit publik është vlerësuar si pozitiv:

“Ndryshime më të mëdha do të ketë në arsim për shkak të mundësisë të një mbikëqyrjeje më të madhe mbi shkollat nga ana e qytetarëve”(Strugë) ose “Me decentralizimin qytetarët mund të shërbehen më shpejtë dhe në mënyrë më kualitative dhe kjo i zvogëlon tensionet ndëretnike”(Gostivar).

Megjithatë ka shumë vërejtje kritike për mënyrën në të cilën zhvillohet ky proces. Në intervistën me funksionarët e Ministrisë së pushtetit lokal, si dhe me kryetarët e komunave dhe këshilltarët komunalë kuptojmë se transferi nuk zbatohet ose zbatohet ngadalë në shëndetësi, mbrojtjen e ambientit jetësor dhe planifikimin hapësinor si dhe në arsim.³⁰ A janë arsyet objektive ose disa qendra të influencës në shtet vështirë heqin dorë prej ingerencave të veta, posaçërisht në shëndetësi dhe arsim, veprimtari të cilat në të gjitha nivelet kanë harxhime publike të cilat vlerësohen në afro 500 milionë dollarë në vit?

Në intervistat me funksionarë të komunave dhe këshilltarëve rreth bartjes së kompetencave dhe mjeteve, nuk ka dallim ndërmjet maqedonasve, shqiptarëve, turqve dhe

³⁰ Intervista me funksionarë të Ministrisë së pushtetit lokal

të tjerëve. Të gjithë e ndajnë mendimin se ka edhe shumë të punohet në rrumbullakimin e procesit të decentralizimit:

“Shteti nuk lëshon mjete të mjaftueshme, as ingerenca, as dotacione: në arsim dhe shëndetësi nuk do të ketë zhvillim me këtë temp të bartjes së ingerencave; komuna ka obligim vetëm mirëmbajtjen, ngrohjen por jo edhe menaxhimin; bashkëpunimi me shtetin është i mirë vetëm nëse pushteti lokal është i njëjtë me përkatësinë politike të qeverisë së koalicionit; decentralizimi financiar është fare joadekuate, është e nevojshme që ndryshimet në ligjin për TVSH-në dhe tatimin personal të orientohen drejt komunave.”(Strugë)

“Ligji për decentralizim është mjaft me vend. Pushteti është më afër qytetarëve, por duhet akoma të decentralizohen edhe disa kompetenca të pushtetit qendror që të mundet komuna të menaxhojë me pasurinë e vet”.(Dibër).

“Lartësia e të hyrave nuk mundëson kryerjen e kompetencave të komunës kurse bartja e kompetencave dhe mjeteve zhvillohet ngadalë”(Kërçovë)

Burimet e të hyrave nuk mundësojnë kryerjen e ingerencave të komunës, sepse sigurohen vetëm prej të hyrave të qytetarëve ndërsa ajo tjetra planifikohet me shitjen e pasurisë së komunës”(Strugë)

“Komuna do të dëshironte të ketë më shumë kompetenca mbi truallin për ndërtim, veçanërisht plazheve”(Strugë)

Në aspekt të transferim të kompetencave, si dhe në aspekt të dotacioneve, tani për tani bashkëpunimi ndërmjet pushtetit komunal dhe shtetit është i dobët”(Strugë)

Shkurtimisht, bashkëbiseduesit e problematizojnë bartjen e kompetencave, posaçërisht decentralizimin fiskal. Këtu, së pari doemos të përsëritet konstatimi i theksuar në Raportin nacional për zhvillimin e njeriut të UNDP-së, se *“është vështirë të arrihet pavarësia financiare në një gjendje kur bruto prodhimi vendas për kokë banori në vend është relativisht i ulët”*. Këtë, tekefundit, e konfirmuan të gjithë kryetarët dhe këshilltarët komunalë ndërsa nga analiza e secilës komunë veçmas, potenciali i dobët ekonomik i komunave vërehet nga treguesit e dhënë. (Në komunën e Strugës për shembull, në vitin e kaluar janë realizuar projekte vlera individuale e të cilit është 3.000 euro modeste ose 10 - 15.000 euro). Megjithatë lihet hapësirë për nxitje të vendimeve politike të cilat mund të përmirësojnë ose ta keqësojnë decentralizimin fiskal, e cila është kriteri themelor për atë nëse ekziston vetëqeverisja lokale. Burimet për financim të kompetencave të komunave me 3% TVSh, që i shpërdan qeveria e IRJM-së sipas kriterëve të caktuara, 3% tatim lokal personal, tatim në pronë prej 0,01%; tatim në qarkullim të pasurisë së patundshme si dhe taksat komunale, që tani tregohen si të pamjaftueshme.³¹ Kjo me gjasë do t'i len komunat të varura nga pushteti qendror, sepse do të kenë kompetenca të cilat do të duhet të financohen përmes dotacioneve dhe subvencioneve, që mund të sjell deri në favorizimin e komunave ku kryetarët e komunave u përkasin partive në pushtet. Vetë procedura e paraparë me Ligjin për financim të njëjste të vetëqeverisjes lokale është e gjatë, e ndërlikuar madje edhe jo mjaft e qartë dhe i përshtatet forcimit të burokracisë së

³¹ Krahas intervistave me krutarët e komunave dhe këshilltarët, këtu i referohemi edhe Raportit nacional për zhvillimin e njeriut i vitit 2004 të UNDP-së, ku konstatohet se “autoritetet lokale maqedonse kanë të hyra të caktuara tatimore (tatimi në pronë, tatimi në trashëgimi dhe dhurata dhe tatim në qarkullim me patundshmëri dhe të drejta) gjenerojnë mjete ta pakonsiderueshme për autoritetet lokale, sepse burimet më cilësore të mjeteve (TVSh-ja, akcizat, tatimi në qarkullim, tatimi në të ardhura persoanle) janë të qasshme vetëm për pushtetin qendror”

centralizuar.³² Këtë në mënyrë eksplicite na i deklaroi një nga këshilltarët e komunës së Strugës: *Vetëm të shkurtohen procedurat burokratike!*

Hulumtimi, tërthorazi këtë e konfirmon: ata kryetarë komunash të cilët vijnë nga radhët e partive në pushtet, më lehtë i zgjidhin problemet për të cilat janë të nevojshme dotacione dhe subvencione edhe atë në komunikimin e drejtpërdrejtë të kryetarit të komunës me liderin e partisë së tij në rast se janë pjesë e koalicionit në pushtet. *“Nëse kam problem, nuk humbi kohë përmes disa procedurave formale, por shkoj direkt te lideri ynë partiak dhe e zgjidh problemin”*, deklaroi me krenari njëri nga kryetarët e komunave. Ose *“Në Strugë kjo punë është mirë e rregulluar më së shumti për shkak të faktit se autoritetet lokale dhe ata në pushtetin qendror rrjedhin nga partia e njëjtë politike”*, thotë një bashkëbisedues tjetër i yni.

Ky është vetëm një nga indikatorët të cilët flasin se nëpërmjet proceduarve të ndërlikuara, të gjata dhe të paqarta, qendra të caktuara të influencës në shtetin tonë, akoma mbajnë fuqi të madhe politike dhe ekonomike në krahasim me pushtetin lokal e me këtë tërthorazi kontribuojnë për forcimin e burokracisë së partizuar. Forcimi i *shtetit të partizuar, nga na e vet e komprometon vetë idenë për decentralizimin*. Për shembull, kryetarët e komunave të cilët i takojnë opozitës, dhe të cilët shpeshherë kanë pengesa në punën e tyre dolën me animime në publik,³³ se qeveria jep rezistencë ndaj decentralizimit, sidomos në disa sfera, si për shembull arsimin etj.

3) Problemi i tretë për të cilin na i tërhiqin vërejtjen në komunat janë **korrupsioni dhe borxhet e krijuara në mënyrë joligjore të pushtetit të shkuar për të cilët askush nuk është përgjigjur**: *“Më parë, këtu në komunë, njerëzit e ministrisë rajonale të transportit dhe lidhjeve kanë marrë para të majme prej qytetarëve, gjatë dhënies së dokumenteve të ndryshme për ndërtim të dyqaneve dhe një pjesë të tyre e kanë futur në xhep. Tani nuk kontaktojnë me administratën komunale, e as që japin para për të kryer punë.”* (Gostivar) Një nga bashkëbiseduesit thekson: *“Me ligjin për vetëqeverisje lokale unë nuk kam asnjë problem. Punët shkojnë siç duhet. Por çka të bëj kur gjyqi është i korruptuar dhe merr vendime politike? Ja për shembull, mbrëmë prisha 14 garazhe dhe tani, ku për hatër shoqërie, ku për hatër farefisnie, gjyqi nuk i mbron qytetarët por interesat familjare të dikujt. Keqpërdoren miqtë në gjyq dhe merret vendim që përkohësisht të mos priset ..., pastaj shkojnë deri te gjyqi suprem ... Një gjykatës më thotë, unë nuk jam si ti, unë frikohem... Kur nuk respektohet ligji, punët janë ashtu siç janë. Unë nuk frikohem, unë*

³² Për shembull mund ta marrim nenin 12 nga Ligji për finansim të njësisve të vetëqeverisjes lokale, ku së pari, fondet dhe ministrinë kompetente përgatitin metodologji për përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e bllok dotacioneve, e cila bazohet në një formulë me shfrytëzimin e treguesve përkatës të nevojave për çdo program; apstaj, Qeveria e IRJM-së sjell Dispozitë për metodologji për përcaktimin e kriterëve për shpërndarje të bllok dotacioneve me propozim të ministrisë përkatëse pas pajtueshëmisë paraprake të Ministrisë për financa dhe Komisionit për përcjellje të zhvillimit të sistemit të finansimit të komunave.

³³ Sipas gazetës Dnevnik, 2 mars 2006, kryetarët e komunave nga opozita në një mbledhje të përbashkët kanë thesuar se transferohen obligime nga ana e qeverisë por jo edhe mjete dhe se gjendja është brengosëse në sferën e arsimit, transportit dhe finansave. Ata kanë theksuar se qeveria nuk i ka kryer premtimet për riprogramim të borxheve përveç atyre ndaj ndërmarrjeve publike, ndërsa të gjitha detyrimet tjera i ka lënë që vetë komunat t'i zgjidhin. Kryetari i komunës Gazi Babë e ka akuzuar pushtetin se për vete i ka mbajtur investimet kapitale, kurse komunave nuk ua ka lëshuar as mjetet e premtuara (vetëm 40 ose 50% të parave). Mjetet për arsim nuk u lëshohen komunave, edhe pse u është premtuar, kurse një nga problemet e rëndësishme është transferi i truallit që ec ngadalë dhe me rezistencë, me çka investitorët e jashtëm, nëse ekzistojnë, nuk mund të nënshkruajnë

prishi... Dikush doemos t'i bëjë reformat ndërsa unë e kam përkrahjen e 95% të qytetarëve dhe qyteti duket më i bukur. Për këtë shkak këtu aspak nuk ka probleme ndërnacionale” (Gostivar)

“Ana pozitive e decentralizimit është se mund të vijë në shprehje kreativiteti dhe aftësia e kryetarit të komunës dhe këshilltarëve komunalë. Negative është ajo se shumë shpejtë thyhen rregullat dhe parimet në interes të grupacioneve individuale.”(Strugë)

Problemi me borxhet që mbeten nga pushteti paraprak komunal paraqitet në të gjitha katër komunat e hulumtuar: Ja një deklaratë tipike nga hulumtimi: *“Kështu nuk ndodh askund, as në Afganistan, as në Pakistan, as në Afrikë. Ku kanë shkuar miliona euro për dymbëdhjetë vitet paraprake? Dhe askush nuk e ka marrë përgjegjësinë? Kaloj revizioni dhe akoma nuk është ngritur procedura kundër kryetarëve paraprak”;*

4. Në pyetjen se çka presin nga koncepti i ri i decentralizimit të pushtetit, bashkëbiseduesit tanë tërheqin vërejtjen se nuk duhet qenë optimist shumë i madh se disa rezultate do të mund të priteshin vetëm në sferën e urbanizimit dhe veprimtarive komunale. Arsimi dhe shëndetësia mbeten edhe më tutje “jashtë diapazonit” të komunës. Sa i përket sferës ekonomike, komunat as ingerenca financiare, as resurse njerëzore për të bërë diçka më konkrete. Prandaj, sipas disa bashkëbiseduesve, është iluzion që në një të ardhme të afërt të priten rezultate në ekonomi e sipas të tjerëve (të cilët megjithatë janë në numër më të vogël) edhe në ekonomi priten zhvillime pozitive. Problem i madh sipas opinionit të bashkëbiseduesve tanë, është prona shtetërore e truallit: *“Kush do të vijë këtu të investojë në rrethana të këtilla? (Gostivar). Bartja e truallit shtetëror në pronësi të komunës shihet si bazë për zhvillimin komunal (Dibër, Strugë, Kërçovë, Gostivar). Në pyetjen për atë se cila është strategjia për zhvillimin lokal, morëm përgjigjen: “Ju thashë, për fantazi mos më pyetni. Unë flas për truallin. Si do të bësh plan, si do t'i thuash dikujt të investojë?”*

5. Probleme tjera që lidhen me zhvillimin e komunave janë burimet e dobëta të të hyrave të cilat e pengojnë realizimin e kompetencave të komunave, sidomos të komunave më të varfra, tatimet të cilat nuk grumbullohen, *sidomos në disa vende dhe nga një qark i caktuar i qytetarëve*, siç na u pat thënë, mosfunksionimi i inspektoratit etj. Në Dibër, për shembull, decentralizimi ka filluar në kushte shumë të vështira. Komuna funksionon pa një ndërtesë të përbashkët administrative dhe për zhvillim normal të aktiviteteve sigurohen hapësira shtesë për të cilat paguhet qira.³⁴ Megjithatë, problemet më të mëdha janë në lëmin e infrastrukturës dhe arsimit.³⁵

1.1. Arsimi si “studim rasti”

Ta marrim arsimin si një “studim i vogël rasti”, që t'i kthjellojmë problemet për të cilat paralajmëronin bashkëbiseduesit tanë, sidomos në aspekt të participimit të komuniteteve pakicë në pushtet. A mundën ata njëmend të ndikojnë mbi vendimet të cilat drejtpërsëdrejti e prekin identitetin e tyre? Arsimi është lëmi e

³⁴ Atje, koncepti i ri i vetëqeverisjes lokale vlerësohet si i mirë por theksohet joefikasiteti i tij sepse shumë ngadalë zbatohet procesi i decentralizimit kurse shteti akoma e ka fjalën vendimtare ndërsa decentralizimi fiskal, siç theksojnë bashkëbiseduesit shkon në dëm e jo në dobi të vetëqeverisjes lokale. Kjo pamundësoi edhe aprovimin e sistemit një sportel dhe në këtë moment të punësuarit janë vazhdimisht në lëvizje nga njëra ndërtesë në tjetrën. Nga ana tjetër, është pozitive që qytetarët mundën drejtpërsëdrejti të komunikojnë me kryetarin e komunës dhe problemet mund të zgjidhen më shpejtë dhe në mënyrë më efektive.

³⁵ Gjendja e kësaj komune, si dhe e atyre të tjerave nga kjo mostër, e shprehur në seri të indikatorëve, do ta gjeni si aneks i këtij Raporti.

cila është më e përfshirë me procesin e decentralizimit i cili në bazë të ligjit mundëson:

- shkallë më të lartë të mëvetësisë së komunave gjatë menaxhimit me mjetet financiare;
- përfshirje më të gjerë të pushteteve lokale në krijimin dhe kontrollin e politikës së arsimit;
- diferencim më i qartë i të drejtave dhe kompetencave të subjekteve të ndryshëm të involvuar në procesin arsimor në nivel nacional, lokal dhe shkollor;
- kontroll i forcuar mbi efikasitetin e punës së shkollave.

Decentralizimi në sferën e arsimit është i përcjellur me decentralizim fiskal i cili realizohet në faza dhe nënkupton instalim të mekanizmit për financim të komunave, i cili do të duhej të jetë transparent dhe i bazuar në kritere dhe njësi matëse objektive.

Faza e parë, e cila filloi prej korrikut të vitit 2005 përfshin dotacione qëllimore të cilat përfshijnë mjete për mirëmbajtje rrjedhimore të shkollave fillore dhe të mesme dhe transport të nxënësve të arsimit fillor. Faza e dytë do të fillojë në vitin 2007 dhe do të përbëhet prej shpërndarjes së bllok³⁶ dotacioneve qëllimore, me këtë edhe shpërndarja e pagave të kuadrit arsimor dhe profesional transferohet në nivel komunal. Mjetet e përcaktuara si dotacione qëllimore shfrytëzohen për punë të shkollave fillore edhe atë për: mallra dhe shërbime tjera (komunale, ngrohje, energji elektrike, komunikime dhe transport, materiale zyre, mjete për mirëmbajtje të higjienës, gazeta dhe revista, mirëmbajtje rrjedhimore, të dala të tjera operative, ushqim dhe sistemim i nxënësve në internatet e nxënësve dhe nëpër shtëpi)

Ministria për arsim dhe shkencë bën shpërndarjen e mjeteve nga dotacioni qëllimor i komunave, në bazë të planeve financiare të përgatitura paraprakisht nga çdo shkollë veçmas, të cilat dorëzohen te komuna e pastaj ajo i ridërgon te Ministria. Vetë lëmi i arsimit është mjaft kompleks, para së gjithash nëse kihet parasysh se prej vitit 2007 komunat më të mëdha nga buxhetet e veta do të duhet të ndajnë rreth 40% kurse ato më të vogla rreth 60%. Ekzistojnë më shumë baza që të thuhet parimi i barabarësisë gjatë ndarjes së dotacioneve bllok dhe qëllimore ndërsa ato mund të jenë, vlerësim i gabueshëm i shtetit për kapacitetin e komunës, përkatësi e ndryshme partiake ndërmjet niveli qeveritar dhe lokal, jotolerancë personale por edhe strukturë etnike e një komune të caktuar. Meqë komunat prej vitit 2007, do të mund të disponojnë në mënyrë më të mëvetësisë me mjetet të cilat do të jepen për bazë dhe bllok dotacione, parashtruhet pyetja a nuk jemi në prag të konflikteve ndëretnike në këtë sferë? Në rast se këshilli komunal me shumicë votash merr vendime për shpërndarjen e mjeteve për shkollat, a nuk do të ndodh ta favorizojmë arsimin e shumicës në komuna?

Sistemi i arsimit duhet të shqyrtohet në tre nivele: shtetëror, komunal dhe shkollor. Në nivel shtetëror subjekte kryesore janë Ministria për arsim dhe shkencë, Inspektorati shtetëror arsimor dhe Byroja për zhvillim të arsimit. Shteti, si edhe para fillimit të decentralizimit ashtu edhe tani, përmes këtyre subjekteve kryesore, kujdeset për unifikim të kualitetit të procesit arsimor në tërë territorin, nëpërmjet të ingerencës në domenin e standardeve dhe normave pedagogjike, teksteve shkollore, dhënies së provimit të maturës, mënyrës së standardeve për trajnim profesional, kontrollit mbi efikasitetin e procesit arsimor, respektimi i ligjshmërisë dhe të ngjashme.

Në nivel komunal mund të identifikojmë kryetarin e komunës dhe këshillin e komunës. Kryetari i komunës e emëron drejtorin e shkollës me propozim të këshillit të shkollës kurse këshilli i komunës themelon ose suprimon shkollën, vendos për lokacionin e shkollave, siguron qasje të plotë të të gjithë fëmijëve deri në shkollën fillore dhe të mesme dhe emëron përfaqësues nga ana e komunës në këshillat shkollorë.

Janë të mundshme disa probleme të cilat mund të shfaqen në aspekt të marrëdhënieve ndëretnike. E para, kryetari i komunës mund të kthejë propozimin për drejtor të parashtruar nga këshilli i shkollës vetëm për arsye se kandidati i takon bashkësisë pakicë. E dyta, komuna mund të vendos që të suprimojë ndonjë shkollë në të cilën mësojnë fëmijë të cilët u takojnë pakicave etnike pa pasur arsye tjera më serioze për shuarjen e saj; E treta, mund të formohet shkollë pa mos mbajtur llogari për largësinë e pjesëtarëve të

³⁶ Sipas Ligjit për financim të njërive të vetëqeverisjes lokale, bllok dotacioni definohet se dotacion i dedikuar për finansim të ingerencave në një lëmi të veçantë të përcaktuar me ligj.

pakicave etnike nga ajo, në rast se kjo bashkësi etnike është e koncentruar në një territor të caktuar. E katërta, komuna mund të emërojë anëtarë në këshillat e shkollës³⁷ të cilët i takojnë vetëm bashkësisë etnike shumicë në komunë. Në mënyrë hipotetike, mund të ndodh që këshilli i shkollës në një shkollë të vogël fillore³⁸ në të cilën mësojnë fëmijë të cilët i përkasin bashkësisë etnike pakicë, shumica në këshillin e shkollës të jetë e përbërë nga pjesëtarë të një bashkësie tjetër etnike. Në këtë mënyrë, në kuptimin e vërtetë të fjalës, mund të vihet në pyetje participimi i plotë dhe adekuat. ***Duke pasur parasysh, se në Ligjin për vetëqeverisje lokale, arsimit nuk është paraparë si lëmi mbi të cilën zbatohet vetoja e pakicës, dëshirojmë të sugjerojmë për problemet të cilat potencialisht mund të shfaqen, kjo e drejtë të zgjerohet edhe në sferën e arsimit të bashkësive pakicë në komunë, kur kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë i shqetëson pakicat***

1.2. Perceptioni i qytetarëve ndaj opinionit publik për punën e pushtetit komunal³⁹

Në lepezën e metodave hulumtuese, do të ndalemi në një bllok hulumtimesh të opinionit publik në komunat Gostivar, Strugë, Dibër dhe Kërçovë. Pyetjen të cilën ua parashtruan qytetarëve të këtyre komunave kanë të bëjnë me vlerësimin e tyre për punën e pushtetit komunal, e instaluar pas zgjedhjeve të fundit lokale në vitin 2005.

Në nivel të fluksit të përgjithshëm, qytetarët nga komunat që përfaqësojnë mostër në hulumtimin (Gostivar, Kërçovë, Dibër dhe Strugë) **kryesisht janë të kënaqur nga puna e pushteteve lokale.** Në fakt, 47,1% e qytetarëve i vlerësojnë pozitivisht (“shumë mirë” dhe “kryesisht mirë”) rezultatet nga puna e pushtetit të ri komunal, 27, 9 “as mirë as keq”, ndërsa 15,9% këto rezultate i vlerësojnë negativisht (“kryesisht keq” dhe “shumë keq”). Frekuenca e përgjithshme (vërejtje: frekuenca e përgjithshme shihet në grafën “Valid Percent”)

³⁷ Ingerencat më të rëndësishme të këshillit të shkollës janë:

- E miratojnë Statutin;
- Propozojnë programin vjetor të punës dhe parashtrojnë raporte për të arriturat e shkollës deri te Këshilli komunal;
- Propozojnë plan vjetor financiar të Themeluesit;
- I propozojnë gjendje vjetore të llogarive Themeluesit;
- Shpallin shpallje publike për zgjedhje të drejtorit të shkollës;
- Realizojnë intervista me kandidatët për drejtor shkolle;
- I propozojnë kryetarit të komunës кандидат për drejtor të shkollës nga kandidatët të cilët janë paraqitur në shpalljen publike;
- Marrin vendime për ankimimet dhe denoncimet e të punësuarve në shkollë;
- Marrin vendime për ankimimet e nxënësve, prindërve gjegjësisht kujdestarëve të nxënësve;

Këshilli i shkollës në shkollat fillore gjithashtu i jep mendime drejtorit të shkollës në lidhje me emërimin e arsimtarëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe pedagogëve.

³⁸ Këshilli shkollor në shkollat e vogla fillore (sit ë vogla konsiderohen ato të cilat numërojnë deri më 24 paralele) përbëhet prej 7 anëtarësh, dhe ata janë me sa vijon: dy përfaqësues të arsimtarëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe pedagogëve, dy përfaqësues të prindërve/kujdestarëve, një përfaqësues i ministrisë dhe dy përfaqësues të themeluesit.

³⁹ Hulumtimin e realizoi agjencia profesionale “Brima-Gallup”. Mostra e hulumtimit dhe rezultatet janë shpallur si aneks i këtij Raporti

Si i vlerësoni rezultatet e deritanishme në punën e **pushtetit të ri komunal**?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulativ e Percent
Valid	1 Shumë të mira	64	10.6	10.6	10.6
	2 Kryesisht të mira	220	36.5	36.5	47.2
	3 As të mira ,as të këqija	168	27.9	27.9	75.1
	4 Kryesisht të këqija	37	6.1	6.1	81.2
	5 Shumë të këqija	59	9.8	9.8	91.0
	9 Nuk e di/Pa përgjigje	54	9.0	9.0	100.0
	Total	602	100.0	100.0	

Ndërkaq, kur të shihen përgjigjet sipas strukturës etnike të qytetarëve të anketuar, pamja bëhet më e ndërlikuar kurse njohuritë thellohen. Maqedonasit nga komunat Gostivar, Dibër dhe Strugë janë shumë më të pakënaqur nga puna e pushtetit komunal, sesa të anketuarit shqiptar. Do ta paraqesim me tabelë, situatën në komunën e Strugës, si më karakteristike. Atje, 34,7% e maqedonasve negativisht i vlerësojnë rezultatet e punës së deritanishme të pushtetit komunal (“kryesisht të këqija” dhe “shumë të këqija”) kundrejt 6% të shqiptarëve. Pozitivisht i vlerësojnë rezultatet nga puna e pushtetit të ri komunal 43,8 % e shqiptarëve (“shumë të mira” dhe “kryesisht të mira”), ndërsa ashtu vlerësojnë vetëm 11,6% e maqedonasve. Numri më i madh i qytetarëve më prejardhje etnike maqedonase janë deklaruar se rezultatet nuk janë “as të mira, as të këqija”, 47,8% dhe 26,7% e shqiptarëve, gjë që nuk mund të konsiderohet si vlerësim pozitiv.

Si i vlerësoni rezultatet e deritanishme të punës së pushtetit të ri komunal në Strugë

		D4B			Total
		1 Maqedonas	2 Shqiptar	3 Nacionalitet tjetër	
Q1 Si i vlerësoni rezultatet e deritanishme të punës së pushtetit të ri komunal?	1 Shumë të mira		13.9%	20.0%	8.9%
	2 Kryesisht të mira	11.6%	47.5%	10.0%	31.7%
	3 As të mira, as të këqija	47.8%	26.7%	50.0%	36.1%
	4 Kryesisht të këqija	15.9%	4.0%	20.0%	9.4%
	5 Shumë të këqija	18.8%	2.0%		8.3%
	9 Nuk e di/Pa përgjigje	5.8%	5.9%		5.6%
Total		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Në pyetjen e radhës në lidhje me atë se cili është më përgjegjës për rezultatet e dobëta deri më tani, në punën e pushtetit komunal (këtu bëjnë pjesë ata të cilët janë përgjigjur "as të mira as të këqija"; "kryesisht të këqija"; "shumë të këqija")⁴⁰, pjesa më e madhe e këtyre qytetarëve, **40,5% përgjigjet se për këtë është fajtor "pushteti qendror"**. Më pastaj, përgjegjësinë e ndajnë kryetari i komunës me 33,3% dhe këshilli komunës me 8.7%, qytetarët me 7,6; askush 9,8%.

Q2 Kush është më përgjegjës për rezultatet e deritashme (as të mira/as të këqija, kryesisht të këqija dhe shumë të këqija) nga puna e pushtetit të ri komunal? Frekuenca e përgjithshme

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulativ e Percent
Valid	1 Kryetari i komunës	88	14.6	33.3	33.3
	2 Këshilli i komunës	23	3.8	8.7	42.0
	3 Qytetarët	20	3.3	7.6	49.6
	4 Shteti, pushteti qendror	107	17.8	40.5	90.2
	5 Askush, e tillë është situata objektive	26	4.3	9.8	100.0
	Total	264	43.9	100.0	
Missing	System	338	56.1		
Total		602	100.0		

Ndërkaq edhe këtu, përgjigjet sipas përkatësisë etnike, e ndërlikojnë pasqyrën. Maqedonasit dhe pakicat tjera më të vogla si turqit, për rezultatet në komunë, më së shumti e fajësojnë "pushtetin qendror", me gjasë duke konsideruar se janë lënë pas dore, në një situatë prej së cilës nuk janë të kënaqur. Përkundër tyre, shqiptarët konsiderojnë se përgjegjësia për mospësuksin e pushtetit të ri komunal e mban kryetari i komunës. Atje ku janë pakicë, shqiptarët (komuna e Kërçovës) janë gjithashtu të pakënaqur nga "autoritetet qendrore", me gjasë ka të bëjë me atë se Kërçovë mbeti tani për tani në kufijtë e vjetër komunal.

(Më poshtë i japim si ilustrim vetëm tabelat e përgjigjeve nga komunat Strugë dhe Kërçovë)

Q2 Kush mban përgjegjësinë më të madhe për rezultatet e deritanishme (as të mira/as të këqija, kryesisht të këqija dhe shumë të këqija) të pushtetit të ri komunal? - Kërçovë

⁴⁰ Pyetja e radhës ishte se e kujt është merita për rezultatet e mira nga puna e komunave dhe ktu u përgjigjën vetëm ata qytetarë të cilët pozitivisht e vlerësuan punën e pushtetit të ri lokal. Prej tyyre, 54% konsiderojnë se më meritor është kryetari i komunës; 26,8%-këshilli i komunës; 7,4-qytetarët; 8,1-shtetin respektivisht pushteti qendror dhe 3.5-askush, e tillë është gjendja

		D4B			Total
		1 Maqedonas	2 Shqiptar	3 Nacionalitet tjera	
Q2 Kush mban përgjegjësinë më të madhe për rezultatet e deritanishme (as të mira/as të këqija, kryesisht të këqija dhe shumë të këqija) nga puna e pushtetit të ri komunal?	1 Kryetari i komunës	39.1%	16.7%	25.0%	33.9%
	2 Këshilli i komunës	10.9%	8.3%		9.7%
	3 Qytetarët	4.3%		25.0%	4.8%
	4 Shteti, pushteti qendror	32.6%	66.7%	25.0%	38.7%
	5 Askush, e tillë është situata objektive	13.0%	8.3%	25.0%	12.9%
Total/Kërçovë		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Q2 Kush mban përgjegjësinë më të madhe për rezultatet e deritanishme (as të mira/as të këqija, kryesisht të këqija dhe shumë të këqija) nga puna e pushtetit të ri komunal? -Strugë

		D4B			Total
		1 Maqedonas	2 Shqip-tarë	3 Nacionalitet tjetër	
Q2 Kush mban përgjegjësinë më të madhe për rezultatet e deritanishme (as të mira/as të këqija, kryesisht të këqija dhe shumë të këqija) nga puna e pushtetit të ri komunal?	1 Kryetari i komunës	26.3%	42.4%	14.3%	30.9%
	2 Këshilli i komunës	7.0%	15.2%		9.3%
	3 Qytetarët	15.8%	21.2%		16.5%
	4 Shteti, pushtetit qendror	43.9%	12.1%	85.7%	36.1%
	5 Askush, e tillë është situata objektive	7.0%	9.1%		7.2%
Total/Strugë		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Shkurtimisht, konkluzion i rëndësishëm nga hulumtimi i opinionit publik është se ekziston pakicë e pakënaqur dhe shumicë relativisht e kënaqur në këto komuna. Do të thoshim se këto institucione, mekanizma dhe në përgjithësi politika për mbrojtjen e të drejtave të pakicave, ose nuk janë të mjaftueshme, ose nuk janë kuptuar, ose nuk zbatohen në atë mënyrë që të vendoset mirëkuptim dhe bashkëpunim ndërmjet komuniteteve në komunat multietnike, posaçërisht ndërmjet maqedonasve nga njëra anë dhe shqiptarëve nga na tjetër, në nivel të ndërtimit të politikave të komunave dhe marrjes së vendimeve.

2. Partecipimi politik i pakicave. Pjesëmarrja dhe ndikimi. Simbolet dhe gjuha.

Zhvillimi i pushtetit të decentralizuar ishte një nga obligimet themelore që doli nga Marrëveshja kornizë e Ohrit. Bartja e një pjese të konsiderueshme të pushtetit nga niveli nacional në atë lokal, supozon se do t'i jepet mundësi pakicës, e cila në nivel lokal paraqitet si shumicë, të qeveriset *vetë me vetë*. Meqë në shtet atëherë ishte vendosur më standardi se vendimmarrja për interesat fundamentale të pakicave etnike do të mbështetet para së gjithash mbi konsensus dhe kompromis, në vend në mbivotimin, ky standard, në formë të kufizuar, u përhap edhe në vendimmarrjen në komunat, si kundërpeshë e **fragmentimit eventual të mëtutjeshëm të shoqërisë**.⁴¹

Me ligjin për vetëqeverisje lokale i miratuar në vitin 2002 janë rritur kompetencat e komunave që kanë të bëjnë me sferat e shërbimeve publike, planifikimin urban dhe rural, mbrojtjen e ambientit jetësor, zhvillimin ekonomik lokal, kulturën, financat lokale, arsimin, mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen shëndetësore. Gjithashtu, është aprovuar e drejta e limituar e vetos së bashkësive pakicë, mbi vendimet e këshillit komunal.

Veçoritë themelore themelore të konceptit “ndarja e pushtetit” në komunat

1. Të drejtat nga dy komponentat më kryesore të modelit, i cili ekziston në këtë shtet, **“ndarja e pushtetit ekzekutiv”**, në komunat mungon. Në fakt, zgjedhja e kryetarit të komunës në zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta e koncentron pushtetin ekzekutiv në dorën e një personi politik, i cili do të fitojë shumicën e votave të qytetarëve. Kundërpeshë e këtij parimi të pastër maxhoritar të konstituivit të pushtetit ekzekutiv, mund të gjendet në ekzistimin e Këshillit për marrëdhënie ndërnacionale ose organe tjera këshillëdhënëse, si dhe në ekzistimin e qendrave/organeve profesionale në kuadër të vetë administratës komunale, të cilët kujdesen për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave etnike. Në këtë kontekst nuk është e tepërt pyetja për modelin e “ndarjes së pushtetit” a është më i mirë sistemi presidencial apo ai parlamentar, respektivisht a është më mirë të ekzistojë kryetar i këshillit të komunës i cili përgjigjet përpara këshillit, ose kryetar komune i cili është i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët? Duke qenë se modeli i “ndarjes së pushtetit” kërkon balancim etnik, institucionin “kryetar komune” në hulumtimin tonë e analizuar edhe këtë aspekt.

2. Komponenti i dytë i rëndësishëm i modelit është **proporcionaliteti** i instaluar në modelin në disa mënyra: a) nëpërmjet modelit zgjedhor proporcional i cili mundëson mënyrë më të mirë se modeli zgjedhor i shumicës, pjesëmarrje të përfaqësuesve politikë të bashkësive etnike më të vogla në këshillin e komunës b) nëpërmjet parimit të **përfaqësimit të drejtë të qytetarëve të cilët i takojnë të gjitha bashkësive në komunat** (neni 59 i Ligjit për vetëqeverisje lokale)

3. E drejta e vetos. Dispozitat të cilat kanë të bëjnë me kulturën, përdorimi i gjuhëve dhe alfabetëve të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve në komunë, caktimi dhe përdorim i stemës së komunës miratohen me shumicë votash, me ç’ rast patjetër të ketë edhe shumicë votash të atyre anëtarëve të këshillit që janë prezent dhe të cilët i takojnë bashkësive të

⁴¹ Edhe hulumtues të tjerë, si për shembull Kenet MekRi (në tekstin: “Teoritë e ndarjes së pushtetit dhe konflikt menaxhmenti” kanë vërejtur se në rast se në një shtet në formë të limituar përdoret modeli konsocional për zgjidhje të një lloji të ndarjeve, atëherë ekziston tendenca që edhe ndarjet tjera të zgjidhen me model të ngjajshëm

cilët nuk janë popullatë shumicë (neni 41 i Ligjit për vetëqeverisje lokale). Ky model, sidomos proporcionaliteti, respektivisht përfaqësimi i drejtë në administratën publike dhe komunale si dhe e drejta e vetos, duhet të mundësojnë participim “të plotë dhe efikas” të pakicave në ndërtimin e politikave në komunë dhe marrjen e vendimeve.

4. Vetë koncepti “participimi i plotë dhe efektiv” ka historik më të vjetër në kontekst të mbrojtjes të drejtave të pakicave. Nga përfundimi i Luftës së ftohtë, shumica e konflikteve i involvojnë pakicat. Prej 150 konflikteve, të cilat kanë ndodhur prej vitit 1990, më pak se pesë kanë qenë ndërkombëtare. Mbi 30 kanë kaluar në lufta më të mëdha, me 40 milionë njerëz të vrarë dhe mbi 45 milion refugjatë anekënd nëpër botë.⁴² Këto dhe të dhëna të ngjashme frikësuese, e kthyen vëmendjen e organizatave ndërkombëtare si OKB, OSBE ose Këshilli i Evropës. Edhe pse arsytet e konflikteve etnike tradicionalisht janë kërkuar në varfërinë ose mungesën e demokracisë, njohuritë e reja tregojnë se bëhet fjalë për një fenomen të ndërlidhur i cili posaçërisht është i ndërlidhur me mosrespektimin e të drejtave të pakicave. Tre dokumente janë posaçërisht të rëndësishme në promovimin e të drejtave të pakicave, e ndërmjet tyre edhe e drejta për participim të plotë dhe efikas: ”Deklarata për të drejtat e personave të cilët i përkasin pakicave nacionale ose etnike, fetare dhe gjuhësore: e miratuar nga ana e Asamblesë së përgjithshëm të OKB-së (Rezoluta 47/135 e 18 dhjetorit të vitit 1992); “Konventa për mbrojtjen e pakicave nacionale” dhe “Karta evropiane për gjuhët e pakicave” të Këshillit të Evropës.

Në rezolutën e OKB-së pohohet se “personat të cilët i takojnë pakicave kanë të drejtë që të mos kenë pjesëmarrje efektive në vendimarrjen në nivel nacional, e kur kjo është e mundur edhe në nivel regjional, në miratimin e vendimeve të cilat janë në lidhje me pakicat të cilave ata u takojnë ose me regjionet në të cilët ata jetojnë, në mënyrë që nuk është kompatible me ligjëvënien nacionale” (neni 2)

Në nenin 15 të Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale, e cila është e ratifikuar edhe nga ana e IRJM-së⁴³, pohohet se “Palët (shtetet kontraktuese) obligohen se do të krijojnë kushte të nevojshme për pjesëmarrje efektive të pjesëtarëve të pakicave nacionale në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike si dhe në punët publike, veçanërisht në ato që ata i shqetësojnë”. FRAMEWORK CONVENTION FOR THE PROTECTION OF NATIONAL MINORITIES-entered into force on 1 February 1998-is the first-ever legally binding multilateral instrument devoted to the protection of national minorities in general. It covers a wide range of issues that are central to the protection of national minorities and makes clear that the latter is an integral part of the protection of human rights. Me nenin 25 është krijuar një obligim për shtetet nënshkruese të Konventës të japin raporte vjetore për obligimet e marra.

Në diskutimin që u hap me rastin e pesëvjetorit të monitorimit të Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale **“participimi i plotë dhe efektiv” është definuar si diçka**

⁴² From the lecture “Ethnic Conflicts and the Rights of minorities” by F.de Varennes, School of Laë, Skopje, 16 december 2005

⁴³ F-it has been ratified by 34 States. FYROM ratified the FCPNM on 10.4.1997 and entry into force is on 1.2.98. reservation and declaration to the FC:”The provision of the FC will be applied to the Albanians, Turkish, Vlach, Roma and Serbian national minorities living on the territory of the FYROM

-state reports-1.2.1999(FYROM)⁴³. “Within a period of one year following the entry into force of this framework Convention in respect of a Contracting Party, the latter shall transmit to the Secretary general of the Council of Europe full information on the legislative and other measures taken to give effect to the principles set out in this framework Convention

që e përfshin participimin politik, por shkon mbi të dhe e mbulon dimensionin social.

Sipas M.Weller, “it is not possible to conceive of fully democratic governance in the absence of full and effective participation of persons belonging to national minorities in cultural, social and economic life and in public affairs”⁴⁴ The participation of minorities in public life asks response to the following questions: which consultation measures and which structures should be used to associate persons belonging to national minorities with decisions affecting them? Which political representation for minorities? Where do they stand as regards economic and social integration?

Që të mund të vlerësohet “participimi i plotë dhe efikas”, nevojitet t’u përgjigjemi pyetjeve për atë se si është struktura shtetërore; si janë reprezentuar pakicat në ekzekutiv, sidomos në sferën e gjuhës, arsimit dhe mediave; a u janë siguruar pakicave “shanse të njëjta”; si është dizajni konstitucional i shtetit; si është reprezentimi zgjedhor, vendosja e institucioneve dhe praktikave për ndikim të pakicave nacionale; a ekziston autonomi ose vetëqeverisje lokale; a ekziston participim efikas i pakicave në nivel shtetëror dhe lokal; a është i lejuar regjistrimi i partive dhe kandidatëve etnikë, reprezentim proporcional dhe kuota; a ekziston mbrojtje e posaçme e pakicave të vogla dhe të disperzuara; a janë pakicat të reprezentuara në nivel lokal dhe regjional; a janë të dizajnuar distriktet zgjedhore, rregullat dhe praktikat ashtu që të mundësojnë participim të pakicave më të vogla; a ekzistojnë praktika pune pozitive parlamentare dhe organe konsultative të cilat i përfaqësojnë interesat e pakicave; ndërsa ekziston reprezentim efikas ose reprezentim ekzekutiv dhe në fund a është siguruar participim efikas i pakicave në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike.

Nënkuptohet se Projekti të cilin e realizuam, nuk mund t’u përgjigjet të gjitha pyetjeve të parashtruara dhe prandaj u kufizuam në disa prej tyre. Më saktësisht, objekt i hulumtimit të terrenit ishte ***participimi politik i pakicave në komunat multietnike (në mostrën tonë janë zgjedhur komunat Gostivar, Kërçovë, Dibër dhe Strugë) në ndërtimin politik dhe marrjen e vendimeve në Këshillin e komunës.***

Akoma më konkretisht, përfaqësimi i drejtë i administratës komunale, në ndërmarrjet dhe institucionet publike; e drejta e vetos së pakicës (e a.q. shumica e Badenterit ose “shumica e dyfishtë”) edhe Komisioni për marrëdhënie ndërnacionale ishin objekt i monitorimit disamujor në vitin 2006. Përmes praktikimit të tyre pritet që të realizohet participim i plotë dhe efektiv i bashkësive pakicë në ndërtimin e politikës së komunës dhe marrjen e vendimeve në kuadër të pushtetit komunal. Hipotezat prej të cilave u nisëm në këtë hulumtim, se “përfaqësimi i drejtë”, në rast se nuk është i përcjellë me zhvillim ekonomik të shtetit dhe komunave, do të jetë arsye për thellimin e mosbesimit ndërmjet bashkësive etnike, u tregua si e saktë. Treguesit e grumbulluar objektiv në komunat që i hulumtuam, tregojnë se ndryshimi i strukturës së pronësisë, shkaktoi papunësi dhe probleme sociale të të gjitha bashkësitë etnike por më së shumti të maqedonasit të cilët në të shumtën e rasteve ishin të punësuar në ish ndërmarrjet socialiste. Investimet e pritura të jashtme dhe zhvillimi i shpejtë ekonomik, i cili do ta absorbojë papunësinë dhe do t’i zvogëlojë problemet ndëretnike, munguan. Sëkëndejmë, lufta politike për pushtet, sepse shteti edhe më tutje mbetet punëdhënësi më i madh dhe burim i pushtetit dhe privilegjeve, u ashpërsua deri në nivel kur nuk zgjidhen mjetet për të ardhur deri në pushtet ose të ruhet pushteti. Vetë çështja e “përfaqësimit të drejtë të komuniteteve” u bë çështje e ndjeshme politike dhe e sigurisë. Nëse i qasemi në mënyrë se dikush fiton e tjetri humb (zero summ-game), mund të vihet në pyetje ekzistenca e koalicionit në pushtet (LSDM-BDI). Në rast se zgjidhej strategjia e realizimit gradual të këtij parimi, BDI-së i kanosej rrezik ta humb

⁴⁴ M.Weller ‘s article in: “Filling the Frame”, Council of Europe Publishing, 2004

mbështetjen e zgjedhësve të vet. Sipas asaj që e pamë në terren, me siguri është zgjedhur ndonjë solucion mesatar, i ndryshimit të strukturës së pronësisë së firmave të cilat kryejnë veprimtarive të karakterit. Sepse punohet për vendime me të cilat ndërmarrje të mëparshme komunale që kryejnë shërbime të karakterit publik, shndërrohen në private, mbi këto vendime nuk mund të vihet veto, e megjithatë në mënyrë të tërthortë i prekin të drejtat e pakicave. Në fakt, komentohet se “përfaqësimi i drejtë”, nuk ka të bëjë me firmat private të cilat kryejnë veprimtari të karakterit shoqëror, që është çështje për diskutim.

E drejta e vetos së pakicës është institucion i njohur në sistemin e ndarjes së pushtetit. Për çështje të cilat prekin identitetin e bashkësive etnike, siç janë arsimiti, kultura, gjuha, simbolet etj. Jepet mundësi që pakica të vejë veto, që të mos mbivotohen nga ana e shumicës. Është i njohur “federalizmi kulturor” në Belgjikë, i cili i paraprinte federalizmit territorial, ku në kuadër të organit përfaqësues, dy bashkësitë etnike, në veçanti vendosin për çështjet e kulturës dhe arsimit të bashkësive. Gjithashtu, është e njohur praktika e shteteve multietnike ose plurale si Zvicra, Belgjika dhe Kanada, ku vendimet të cilat prekin identitetin e bashkësive, patjetër të jenë të mbështetura me mjete financiare adekuate.

Hulumtimi që e realizuam në katër komunat tona, tregoi fenomen interesant i cili u referohet të gjitha bashkësive etnike në vend. Faktikisht, kur je pakicë, të drejtat kurrë nuk mjaftojnë dhe gjithnjë kërkohen “*më shumë*” e “*më shumë*” të drejta, por kur je shumicë atëherë konsideron se “*pakica ka tepër të drejta*”. Kjo ka të bëjë edhe me të drejtën e vetos ose të drejtës së Badenterit (shumica e dyfishtë). Në praktikë, gjatë vitit në të cilin bëme hulumtimin, 2006, kjo nuk është zbatuar në asnjë rast. *Marrëdhëniet ndëretnike janë të shkëlqyera! Nuk ka pasur nevojë të tillë!* Kjo është përgjigja më e shpeshtë e cila vjen nga ana e përfaqësuesve të shumicës në komunë. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e pakicave konsiderojnë se janë të majorizuara, se ka pasur situata delikate të cilat i shqetësojnë marrëdhëniet ndëretnike dhe se vendimet për to do të ishte mirë të merren me marrëveshje, pavarësisht se formalisht a i takojnë “kulturës dhe simboleve”. Në rast se kësaj i shtohet mungesa e traditës demokratike, pushteti i rritur në duart e kryetarit të komunës, vendimet e të cilit askush nuk mund t’i kundërshtojë, sidomos shumica e Këshillit nga e njëjta parti politike, Komisioni për marrëdhënie ndërnacionale që ekziston vetëm në letër, atëherë prej demokracisë nuk do të mbetet shumë, e sidomos akoma më pak nga “participimi i plotë dhe efektiv i bashkësive pakicë” në krijimin e politikës së komunës dhe marrjen e vendimeve.

2.1. KOMUNA E KËRÇOVËS

TREGUES OBJEKTIV

Numri i banorëve: 30.138

Numri i vendbanimeve: 1 qytet dhe 6 fshatra

Numri i bashkësive vendore: 17

Struktura etnike e popullatës:

Maqedonas: 53.55%

Shqiptarë: 30.53%

Turq: 8.06%

Romë: 5.41%

Vlleh: 0.25%

Serbë: 0.29%

Boshnjakë: 0.02%

Të tjerë: 1.89%

Gjithsej të punësuar në NjVL: 61

Struktura arsimore: 20 –arsim sipëror, 5- arsim i lartë, 30- arsim i mesëm, 6 – tjetër (fillore dhe kualifikim)

Struktura gjinore: 30 - gra, 31- burra

Struktura etnike: 54 - maqedonas, 5- shqiptarë, 2- turq

Struktura organizative e NjVL:

Sektorët:

1. Sektori për çështje juridike dhe të përgjithshme
2. Sektori për urbanizëm, veprimtari komunale dhe mbrojtje të ambientit jetësor

Departamente:

1. Departamente për veprimtari normative dhe çështje juridike
2. Departamenti për buxhet dhe financa
3. Departamenti për çështje të përgjithshme
4. Departamenti për veprimtari komunale
5. Departamenti për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit jetësor

Administrata publike:

1. Ndërmarrja publike komunale:

- “Komunalec” - Kërçovë

2. Arsimi:

- shkollat fillore

- shkollat e mesme

3. Mbrojtja shëndetësore:

- OShP “Qendra medicinave”-Kërçovë

Me pjesën stacionare dhe pjesën e ambulancës poliklinike

4. Mbrojtja sociale:

- Qendra ndërkomunale për mbrojtje sociale-Kërçovë

5. Kultura:

6. Muzeu “Maqedonia Perëndimore në LNÇ”

7. Qendra për veprimtari shkencore kulturore “Koço Racin”-Kërçovë

8. Universiteti i punëtorëve “Kërste Petkov Misirkov”

9. Mbrojtja nga zjarret: Njësia territoriale e zjarrfikësve e komunës së Kërçovës

10. Sektori qytetar

- OJQ

11. Mediat:

Televizione lokale: 3

2 në shqip

1 në maqedonisht

Radio stacione lokale: 4

2 në maqedonisht

1 në shqip

1 në të dy gjuhët

Organet udhëheqëse të komunës

Kryetari i komunës:

Vladimir Tolevski, maqedonas, i pavarur

Këshilli i komunës:

Përkatësia etnike dhe partiake e këshilltarëve:

	Maqedona s	Shqiptarë	Turq	Romë	Gjithsej
VMRO Popullore	3				3
VMRO DPMNE	5			1	6
LSDM	3				3
BDI		4			4
Partia Demokratike e Turqve			1		1
LDP	1				1
Të pavarur	1				1
Gjithsej	13	4	1	1	19

Struktura gjinore:

Burra - 11

Gra - 8

Që të përgjigjemi në pyetjen themelore - në ç' masë bashkësitë pakica në komunë kanë qasje deri te pushteti, u nisëm prej tre hipotezave themelore:

- funksionaliteti i modelit të ri të vetëqeverisjes lokale

- niveli i zhvillimit ekonomik të komunës

- kualiteti i marrëdhënieve ndëretnike në komunë. Siç përmendëm më parë në arsyetimin e projektit, konsideruam se këto tre segmente nga rrethina e drejtpërdrejtë kanë ndikim në realizimin e modelit të ndarjes së pushtetit.

Në ç' mënyrë?

Si e para, parashtrohet pyetja se si funksionon modeli i ri i vetëqeverisjes lokale në komunat, respektivisht a kontribuon ai në realizimin e të drejtave të qytetarëve. Vetëm në kushte të vetëqeverisjes lokale të suksesshme/funksionale mund të matet participimi i qytetarëve të komuniteteve pakicë në atë proces. Dhe anasjelltas, në rast se modeli i ri i pushtetit të decentralizuar nuk jetësohet, respektivisht vetë për vete nuk është funksional, mekanizmi i ndarjes së pushtetit nuk do të ketë domethënie, respektivisht pushteti lokal do të prodhojë pakënaqësi të qytetarët e të gjitha bashkësive etnike. Një pakënaqësi e këtillë mund të (keq)përdoret për qëllime politike dhe të fitojë emblemë etnike.

Duke pasur parasysh faktin se vetë procesi i funksionimit të pushtetit lokal nuk ishte pjesë e projektit tonë, me këtë rast u kënaqëm me perceptimin e qytetarëve në komunë, por edhe të këshilltarëve dhe një pjesë të administratës (ajo që do të mund ta quanim publik i kualifikuar). Në vazhdim do t'i prezantojmë qëndrimet dhe opinionet e fituara në intervistat, përgjigjet e qytetarëve të marra nëpërmjet anketimit, si dhe bisedat e zhvilluara në fokus grupet.

A. Koncepti i ri për vetëqeverisje lokale

1. Çka mendojnë qytetarët për të (qëndrime dhe opinione)

Të gjithë bashkëbiseduesit tanë kanë qëndrim pozitiv ndaj konceptit të ri për vetëqeverisje lokale, sepse ai duhet t'ua ofrojë qytetarëve pushtetin dhe me këtë në mënyrë më efikase të zgjidhen problemet e tyre. *(Koncepti është paramenduar mirë që qytetarët të kenë pasqyrë më të mirë për atë se çka ndodh në institucionet; vetëqeverisja lokale më mirë i nje problemet dhe mund të gjejë më shumë zgjidhje dhe zgjidhje më adekuate)* *(Më poshtë me kurziv janë shënuar përgjigjet e të intervistuarve)* Kjo është diçka që patjetër të ndodhte edhe më parë, konstatojnë bashkëbiseduesit tanë. Qëndrimi i tillë pozitiv është tejet i pritur sepse kërkesa për decentralizim të pushtetit në vendin tonë është parashtruar disa herë, do të thoshim në tërësi në kontinuitet, në tërë procesin e tranzicionit, që do të thotë ai nuk është i ndërlidhur me Marrëveshjen kornizë.

Kur bëhet fjalë për Ligjin për ndarje territoriale, opinionet janë të ndara. Përderisa bashkëbiseduesit shqiptarë e përkrahin ligjin (madje disa prej tyre thonë se duhet të bëhet zmadhimi i ri i komunave: *në vendin tonë të ketë rreth 30-40 komuna ose vetëqeverisje në dy nivele*), bashkëbiseduesit maqedonas kanë mendim krejtësisht të kundërt për këto çështje *(Kërçova duhet të mbetet në këto kufij që të funksionojë më mirë; për shkak të stërmadhësisë të komunave, me pjesë të bashkangjitura urbane dhe rurale do të zvogëlohen efektet nga decentralizimi; propozimi për kufijtë e rinj për komunën janë absurde, sepse qytetit i nevojitet që të bashkëngjiten madje 5 vendbanime rurale, ndërsa disa prej tyre janë të larguara më shumë se 100km prej qytetit)*. Edhe përfaqësuesi i bashkësisë turke shpreh pakënaqësinë nga ky ligj për shkak të padrejtësisë që i është bërë popullatës turke në vendin tonë *(prej 4 komunash me popullatë shumicë turke tani mbetën vetëm 2; me ndarjen e re territoriale në vitin 2008, popullata turke e komunës do t'i nënshtrohet asimilimit të mëtejshëm nga ana e shqiptarëve)*

2. Çka konkretisht pritet nga modeli i ri i vetëqeverisjes lokale?

Bashkëbiseduesit tanë paralajmërojnë se nuk dihet të jemi tepër optimist dhe se disa rezultate do të mund të priteshin vetëm në sferën e urbanizmit dhe veprimtarive komunale. Arsimit dhe shëndetësia mbesin edhe më tutje "jashtë fushëveprimit" të komunës, e porsa i përket sferës ekonomike komunat nuk kanë as resurse financiare, as resurse njerëzore, as ingerenca për të bërë diçka më konkrete. Prandaj, sipas disave, iluzion është që në një

kohë të afërt të priten rezultate në ekonomi, e sipas të tjerëve (një numër i vogël) edhe në ekonomi priten zhvillime pozitive. Për sa i përket marrëdhënieve ndëretnike në kushte të decentralizimit, të gjithë presin ose përmirësim të tyre ose mbetje në të njëjtin nivel (relativisht të kënaqshëm).

Vlerësimet për funksionimin e deritashëm të pushtetit të ri komunal janë të ndryshme. Një nga këshilltarët, për shembull, thotë se akoma është herët të evaluohet puna e tyre dhe se praktikisht akoma nuk e ndjen punën e saj.

3. Me cilat probleme ballafaqohet komuna në realizimin e konceptit të ri të decentralizimit të pushtetit?

Problemet janë të locuara në disa punkte:

- Bashkëpunimi me shtetin ose pushtetin qendror nuk kënaq (*shteti nuk delegon as kompetenca të mjaftueshme, as dotacione; në arsim dhe shëndetësi nuk do të ketë zhvillim me këtë temp të delegimit të ingerencave, ka vetëm obligime - mirëmbajtje, ngrohje, por jo edhe menaxhim; bashkëpunimi me shtetin është i mirë vetëm nëse pushteti lokal është i së njëjtës përkatësi politike si dhe pushteti qendror*).

- Komuna është e varfër, nuk ka mjete të mjaftueshme që t'i alimentojë as ato ingerenca të cilat i janë ndarë, (*komuna është zorrë qore në shtet...; me një ekonomi të këtillë katastrofale, burimet dhe të ardhurat e komunës nuk na mbulojnë as 30% të nevojave...;*

-Decentralizimi financiar është tejet joadekuat, janë të nevojshme ndryshime në ligjin adekuat (*TVSh dhe tatimi personal të orientohen drejt komunave...*)

B. Aspekti socio-ekonomik ne komunë (EKONOMIA)

Kërçova është një nga komunat më të zhvilluara në shtet, me një përqindje të mashe të të papunësuarve, dhe ky trend vazhdon edhe më tutje. Banorët e saj e përjetojnë komunën si *zorrë qore, në fund*, respektivisht si komunë me probleme mjaft të theksuara socio-ekonomike, të cilat janë më të mëdha në krahasim me qytetet tjera në vendin tonë. Storia e tranzicionit ekonomik është mjaft e ngjashme me atë të më shumë qyteteve në vendin tonë. Gjatë kohës së socializmit këtu akne punuar më shumë kapacitete prodhuese, prej të cilave bartëse kanë qenë ato nga lëmi i zejtarisë, hierarkisë, industria e përpunimit të drurit: Tane Calevski, Kopaçka, Tajmishte, EKX Oslome, Kombinati bujqësor etj. Privatizimi joadekuat, siç thonë bashkëbiseduesit tanë, kontribuoi që ato firma të bankrotojnë, kurse të punësuarit, para së gjithash maqedonasit etnik, të mbeten në rrugë. Sektorin e ri privat e përbëjnë firma më të vogla nga lëmi i hotelierisë dhe tregtisë, dhe pjesërisht edhe nga veprimtaritë shërbyese të cilat nuk janë në mundësi t'i absorbojnë ata të cilët u gjenden në rrugë për shkak të bankrotimit të firmave të mëdha. Kapitali kryesisht u takon shqiptarëve etnikë; të punësuarit në këto firma kryesisht janë shqiptarë dhe maqedonas. Kur bëhet fjalë për diasporën, kapital investojnë para së gjithash ata me prejardhje shqiptare, ndërsa maqedonasit në një numër shumë më të vogël. Për shkak të këtyre proceseve maqedonasit janë shumë më shumë të goditur me tranzicionin ekonomik në krahasim me shqiptarët – është konkluzioni i parë. Konkluzioni i dytë që mund të del nga intervistat është se në thelb të gjithë qytetarët e vendit tonë janë humbës me tranzicionin, me përjashtime të vogla (*përjashtime janë personalitetet kyçe në politikë të*

cilët janë fitimtarë; shkaku i privatizimit të keq dhe zhvleftësimit të fabrikave humbën të gjithë, fitimtarë janë ish drejtorët).

Si pengesë themelore të cilat e pamundësojnë funksionimin e suksesshëm të ekonomisë në komunë në periudhën e ardhshme përmenden: *joprofesionalizmi i administratës, joekonomizimi, plaçkitja e pronës shtetërore dhe komunale; mospasja e investimeve, mospasja e ingerencave, teknologjia e vjetërsuar, biznes klima e keqe, angazhimi i pamjaftueshëm i partive politike, mosbesimi te të huajt, ligji për tokë ndërtimore, politika kuadrore, interesat personale. ...*

Analiza e pengesave të sipërpërmendura tërheq vërejtjen për disa probleme në vijim me të cilat do të ndeshet zhvillimi ekonomik i komunës në periudhën në vijim:

- ingerencat e pamjaftueshme të pushtetit komunal në këtë sferë (toka ndërtimore i takon shtetit)
- funksionimi joadekuat i institucioneve, që krijon biznes klimë të keqe dhe mosbesim te të huajt për investime

V. Marrëdhëniet ndëretnike ne komunë

Kërçova është komunë tipike multikulturore, me traditë të gjatë të jetesës së përbashkët. Këtë e theksuan të gjithë bashkëbiseduesit tanë. Madje edhe në vitin 2001 marrëdhëniet ndëretnike mbetën stabile edhe pse mjaft të tensionuara. *(nuk ia dolën të na kontaminojnë, fatmirësisht; meritë të madhe kanë politikanët lokalë të cilët gjatë tërë kohës ishin ndërmjet popullit).* Në këtë periudhë kontaktet ndërmjet qytetarëve të bashkësive të ndryshme etnike u reduktuan në minimum, kurse njerëzit kryesisht lëviznin në pjesën e vet të qytetit *(nuk shkonim në pjesën e tyre të qytetit, e as ata në tonën).* Me nënshkrimin e Marrëveshjes kornizë, marrëdhëniet gradualisht relaksohen edhe pse akoma mund të hasen pasojat. Mirëbesimi kthehet gradualisht edhe pse akoma nuk është arritur një nivel i mirë i marrëdhënieve prej para vitit 2001, konsiderojnë një pjesë e bashkëbiseduesve, ndërsa sipas vlerësimit të të tjerëve, marrëdhëniet ndëretnike janë të kënaqshme. Edhe pse, ashtu siç pritej, vlerësimet për ngjarjet e vitit 2001 janë të ndryshme, varësisht nga ajo se ato i japin maqedonasi etnik ose shqiptarët etnik, mund të thuhet se të gjithë bashkëbiseduesit tanë e pranojnë zbatimin e Marrëveshjes kornizë si domosdoshmëri dhe si kusht për zhvillim dhe prosperitet të shtetit. Në lidhje me Marrëveshjen kornizë rezervë tregoi vetëm pjesëtari i komunitetit turk, sepse sipas tij, me këtë marrëveshje *Vendi ynë u shndërrua në shtet binacional dhe hoqi dorë nga karakteri i vet multi-etnik.* Si pakicë më e madhe shqiptarët janë më të privilegjuar në llogari të të gjitha bashkësive tjera etnike, përfshirë këtu edhe turqit.

Pjesa më e madhe e bashkëbiseduesve nga të dy bashkësitë etnike theksojnë se tani prioritet kanë problemet ekonomike, dhe se të gjithë qytetarëve tanbi u është e rëndësishme çështja se si ta përmirësojnë standardin jetësor. *(Edhe maqedonasi edhe shqiptarët dëshirojnë të shkojnë në Evropë; tani na lejohet t'i shfaqim shqiptarët dhe kjo tani më nuk është interesante, është tejkaluar; ekonomia është e rëndësishme).* Por, edhe pse gati të gjithë pajtohen se nacionalizmi është zvogëluar, në të njëjtën kohë theksojnë se komunikimet ndërmjet pjesëtarëve të të dy bashkësive më të mëdha më së shpeshti reduktohen vetëm “në atë që është e domosdoshme”, duke theksuar me këtë rast se kjo duhet të tejkalohet. *(Motra ime punon te një mjek shqiptar dhe vetëm ky është kontakti i saj me bashkësinë shqiptare; të rinjtë nuk përzihen – shkojnë në kafeteri të ndryshme; pamjaftueshëm njihemi ndërmjet veti; tani mësoj shqip dhe vërej se shqiptarëve u vjen shumë mirë kur u drejtohem në gjuhën e tyre).* Është interesante se të gjithë bashkëbiseduesit tanë e theksuan rolin e madh të cilin e kanë politikanët për përkeqësimin ose përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike. *(Politikanët t nuk janë gjithmonë të*

kujdesshëm më deklaratat e veta. Mjafton që një herë të thuhet diçka që nuk duhet dhe të “merr flakë zjarri”. Për gjithçka vendimtare është gjendja ekonomike, të gjithë janë të brengosur dhe të pakënaqur, për të cilin shkak janë të mundshëm konflikte – anëtar i BDI-së)

V. Ndarja e pushtetit ose si deri në participim të plotë dhe efikas të pakicave

- 1. Përfaqësimi proporcional**
- 2. Vetoja e pakicave (Vendimarrja me “shumicën e Badenterit”)**
- 3. Përdorim i gjuhëve, flamujve, simboleve**

1. Përfaqësimi proporcional

Praktikisht procesi përfaqësimit proporcional është në fillim, edhe pse ekziston te të gjithë vetëdija për pashmangshmëri të ndryshimeve në strukturën e të punësuarve në administratën lokale dhe në ndërmarrjet publike. Të dhënat objektive tregojnë me sa vijon: Prej 61 të punësuarve në Njësinë e vetëqeverisjes lokale 54 janë maqedonas, vetëm 6 janë shqiptarë, ndërsa ka edhe 2 turq. Do me thënë, është evidente se kemi të bëjmë me një strukturë joproporcionale etnike të të punësuarve, që nuk mund të tolerohet për një kohë më të gjatë.

Edhe pse prej ndërmarrjeve dhe institucioneve publike nuk morëm të dhëna ekzakte për strukturën etnike të të punësuarve, prej bisedave erdhëm deri në njohuri se maqedonasit janë të përfaqësuar në një numër shumë më të madh.

Pritjet dhe pakënaqësitë janë prezente te të gjithë, edhe pse për këtë nuk flitet krejtësisht hapur. Problemi qëndron siç vijon: në këto sektorë ekziston mbipunësim, kurse komuna është në një kondicion mjaft të keq financiar dhe s’do të mundej ta duronte barrën e punësimeve të reja. Nga ana tjetër, në rast se vjen deri në largime nga puna të administratorëve maqedonas për t’u punësuar shqiptarë, reagimi do të ishte mjaft i bujshëm, akoma më tepër për shkak se mundësi për punësime të reja në Kërçovë nuk ka, a maqedonasit janë akoma më të goditur nga pasojat e tranzicionit ekonomik. Do me thënë, shqiptarët akoma presin që ky proces të fillojë të zhvillohet me një temp të kënaqshëm (sepse kështu, sipas tyre i bëhet obstrukcion Marrëveshjes së Ohrit), kurse maqedonasit “janë në pritje nëse do të mbeten në rrugë” edhe atë vetëm për shkak të asaj se janë maqedonas. Dhe çka më pas? Perspektivë ekonomike nuk shohin, as për vete e as për fëmijët e vet. *(Madje edhe neve të mos na pushojnë nga puna kjo do të thotë se në vitet e ardhshme në administratën dhe ndërmarrjet publike nuk do të punësohet asnjë maqedonas! Kjo është e tmerrshme!).* Reagimet e këtilla tregojnë, veç tjerash, se popullata maqedonase tregon fleksibilitet më të vogël në lidhje me fillimit të biznesit vetjak. Mbrojtjen të cilat ia ofronin ndërmarrjet socialiste u treguan si tejet kontraproduktive për këto kohëra të tranzicionit. (Kjo nënkuptohet nuk është arsye për prezencë më të vogël të tyre në biznesin privat).

2. Procesi i vendimarrjes

Procesi i vendimarrjes është padyshim procesi vendimtar nëpërmjet të cilit realizohet modeli i ndarjes së pushtetit, respektivisht pjesëmarrja dhe ndikimi i drejtpërdrejtë i bashkësive pakicë në politikë. Jo rastësisht kreatorët e këtij modeli e kanë paraparë edhe të a.q. shumicë të dyfishtë, si mekanizëm për mbrojtje të të drejtave të pakicave në një shoqëri, më saktësisht kush do të pamundësojë mbivotim të grupeve

pakicë në procesin e marrjes së vendimeve. Edhe Ligji për vetëqeverisje lokale e rregullon përdorimin e tij në raste të përcaktuara saktësisht dhe në kushte të caktuara. A zbatohet dhe sa, vendimarrja e këtillë në komunat? Cilat janë efektet nga zbatimi i tij? A kontribuon ai për mbrojtjen nga majorizimi ose e bllokon procesin e vendimarrjes në Këshillin e komunës? A kontribuon për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike ose për përkeqësimin e tyre? Këto ishin pyetjet për të cilat dëshironim të merrnim përgjigje në hulumtimin tonë.

Gjatë vendosjes së hulumtimit u nisëm nga disa hipoteza:

1. Meqë procesi vendimarrjes në parim është i pandashëm, proces kompleks, për inkuadrim të plotë dhe efektiv (kualitativ) të pjesëmarrësve në të (inkuadrimit kualitativ e kuptojmë si mundësi për pjesëmarrje dhe ndikim në të gjitha fazat) nevojitet të jenë të plotësuara më shumë parakushte. Si e para, nevojitet të plotësohen kushtet themelore organizativo teknike për mbajtjen e seancave të Këshillit të komunës. Kjo nënkupton, ekzistim të hapësirave adekuate, prenotim me kohë të seancave dhe marrje të materialit për të njëjtat, ekzistim të kushteve për përkthim në gjuhën amtare.
2. Ekzistimi i atmosferës demokratike nëpër seanca, në kuptim të asaj se të gjithë të pranishmit kanë mundësi ta shprehin mendimin e vet, votim i rregullt, ekzistimi i kuorumit gjatë marrjes së vendimit etj.
3. Respektimi i kushteve ligjore për zbatim të votimit të dyfishtë.(shumicë)

Deri në këto njohuri erdhëm gjatë realizimit të hulumtimit në Kërçovë?

Për shkak të mosekzistimit të kushteve adekuate hapësinore, seancat e Këshillit mbaheshin kryesisht në njërin nga hotelet e qytetit, me ç'rast të gjitha kushtet tjera organizativo teknike për zhvillim normal të seancës ishin kryesisht të përmbushura: konvokimi me kohë i seancave, materialet, përkthimi në gjuhën shqipe. Për shkak të mungesës së mjeteve financiare, komuna nuk dispononte me teknikë për përkthim simultan, gjë që ndikonte në kohëzgjatjen e seancave dhe kualitetin e përkthimit, gjë që në raste të caktuara krijonte nervozë të këshilltarët. Në parim, seancat ishin publike, ndërsa për sa i përket atmosferës demokratike vëzhguesi (monitoruesi) shumicën e tyre i vlerësoi me notë ndërmjet 4 dhe 3.(shkalla shtrihet prej 1- atmosferë e keqe demokratike, deri më 5- atmosferë e shkëlqyeshme demokratike)

Këshilli i komunës së Kërçovës numëron 19 anëtarë, ku përveç këshilltarëve të VMRO-DPMNE të gjithë të tjerët i takojnë koalicionit i cili është në pushtet. Kuorumi nuk paraqet problem për punën e këshillit. Përkundrazi, të gjitha seancat mbahen me të paktën 17 anëtarë, që flet për motivimin e lartë të këshilltarëve të marrin pjesë në punën e Këshillit.

Për çka ka debatuar këshilli? Analizat e rrethit të ditës në seancat e Këshillit vënë në dukje se më së shumti kohë dhe energji në periudhën e shkuar është harxhuar në çështjet që pasojnë: 1. Financimi i komunës dhe veprimtaritë e tyre (buxhet, rebalanc, realizim i mjeteve buxhetore); 2. Çështje kadrovike (zgjedhje e kryetarit të këshillit dhe organeve punuese-komisioneve); 3. Çështje nga sfera e urbanizmit dhe veprimtarive komunale.

Këshilli, shtatë muaj nuk ishte në gjendje të zgjedh kryesues dhe ti kompletojë organet ndihmëse - komisionet. Nga procesverbalet është evidente se ekzistojnë interesa të ashpra të kundërshtuara ndërmjet grupeve të këshilltarëve për këto (por edhe për çështje tjera), për ç' arsye është dukshëm i vështirësuar procesi i vendimarrjes. Grupet e këshilltarëve akuzojnë njëri tjetrin për obstrukcione, për marketing politik, zhvillohen debate të gjata për rendet e ditës, bëhen vërejtje se pse nuk janë shpërndarë materialet, për se disa nga pikat e

rendit të ditës nuk janë shqyrtuar paraprakisht nga komisionet, kërkohet anulimi i seancave ose shlyerja e pikave nga rendi i ditës e kështu e radhë. Është evidente se pas këtyre problemeve qëndrojnë interesat e partive, të cilat e orkestrojnë punën e këshilltarëve. Nga materialet fitohet përshtypja se linja themelore e ndarjes është pushtet-opozitë. Me këtë rast këshilltarët janë të vetëdijshëm se një mënyrë e këtillë e punës e dëmton dinjitetin e këshillit, por edhe rejtingun e partive para qytetarëve, prandaj disa prej tyre madje propozojnë që këshilli të shpërbëhet dhe në vendin e tij të vijnë njerëz të cilët me të vërtetë do të donin të punojnë.

Disa nga këshilltarët thonë se edhe “karta etnike”, si posaçërisht e ndjeshme, shfrytëzohet për marketing politik. Në fakt, këshilltarët e BDI-së e lëshuan seancën V të Këshillit, sepse materialet e një pike të rendit të ditës nuk u janë dhënë me përkthim në gjuhën shqipe. Kryetari i komunës, i cili deklaroi se nuk ka qenë në rrjedhë me problemin, kërkoi ndjesë për lëshimin dhe paralajmëroi ndëshkime për administratën në rast se këto lëshime përsëriten. Përfaqësuesit e BDI-së e lëshuan mbledhjen edhe krahas lutjeve të të gjithë të tjerëve që të tregojnë mirëkuptim, krahas sqarimeve të administratës se ka pasur probleme teknike për përkthimin, ndërsa mbeti e paqartë se pse prej katër këshilltarëve në këtë seancë u paraqitën vetëm dy.

Shembull tipik për seancë jokonstruktive është ajo që u mbajt më 27.12.2005. Në debatin për Propozim program të Ndërmarrjes publike Komunalec janë harxhuar më shumë se dy orë, në të kanë marrë pjesë vetëm 3-4 këshilltarë, debati është zhvilluar me ofendime dhe diskualifikime të rënda, përmenden kanosje, thirrje anonime telefonike, lojëra politike...”*nuk frikohem prej asgjëje, në përbërjen e shkuar askush askujt nuk i kanosej..., ndërsa mesazhe të këtilla kishte edhe deri te kryetari i partisë sime dhe deri te kryetari i Këshillit.*” Kryetari i këshillit ishte i detyruar ta ndërpresë seancën, kurse në vazhdim këshilltarët nu ke votuan propozim programin e Ndërmarrjes publike. Fitohet përshtypja se edhe kryetari i komunës është peng i “lojës partiake” në rast se kjo është ashtu, është normale të pritët efikasitetin e tij i zvogëluar.

Sa i përket çështjes e cila neve posaçërisht na interesonte a zbatohet dhe si e a.q e drejta e Badenterit në rastet kur janë të prekura interesat e bashkësive etnike, konstatuam se një praktikë e këtillë nuk ka ekzistuar në komunë, sepse çështje të këtij tipi nuk kanë qenë në rendin e ditës të Këshillit të komunës. Konstatuam gjithashtu, se këshilltarët nuk janë deklaruar se cilës bashkësi etnike i takojnë, si hipotezë për zbatimin e rregullës për vendimarrje me shumicë të dyfishtë, as që Komisioni për marrëdhënie ndëretnike të jetë takuar ndonjëherë, sepse sipas bashkëbiseduesve tanë, për këtë nuk është shfaqur nevojë. Edhe pse, sipas materialeve të disponueshme, fitohet përshtypje se si seancat e këshillit kanë qenë të shfrytëzuara edhe si një lloj arene për qërim hesapësh ndërpartiake, nga ana tjetër fitohet përshtypja se pjesëtarët e të gjitha opsioneve politike dhe grupeve etnike kanë qasje të papenguar në debat, që është një hipotezë mjaft e rëndësishme për vendimarrje demokratike. Një përshtypje tjetër është se në seanca shumë i kushtohet kujdes mosprishjes së atmosferës së marrëdhënies të mira ndëretnike. Mund të përmendim shembullin me formimin e formimin e Komisionit për festa dhe manifestime dhe dhënien e shpërblimeve dhe mirënjohjeve, kryetari i së cilës jo rastësisht nuk është shqiptar, kurse në mbledhjen konstitutive të gjithë anëtarët, pa përjashtim, adresuan *apel për bashkëpunim të gjithanshëm të të gjitha bashkësive etnike.....* (20.12.2005). Si shembull i dytë është ai kur në vërejtjen e anëtarit të BDI-së se një pjesë e materialit nuk është përkthyer në shqip, përveç faljeve të kryetarit të komunës, shërbimet kompetente pranuan edhe paralajmërim të ashpër se në të ardhmen përgjegjësit do të sanksionohen në rast se përsëriten raste të këtilla.

Përgjigjet e fituara nga anketa tregojnë se për qytetarët e Kërçovës problem nuk janë marrëdhëniet ndërtnike, por probleme të tjera. Shumë para problemeve tjera është problemi i papunësisë. Me këtë rast, tre problemet e ranguar si të para shqiptarët i theksojnë: papunësinë (mungesën e investimeve), problemet ekologjike (komuna ka problem të madh me deponinë), dhe shëndetësia; ndërsa për maqedonasit ato janë: papunësia, infrastruktura, korrupsioni. Të pyetur të përgjigjen se çka konsiderojnë se u është cenuar në komunë edhe maqedonasit edhe shqiptarët përmendin para së gjithash të drejtën e punësimit, me atë që të parët përgjigje të tillë kanë dhënë rreth 35% e të anketuarve, kurse të dytët këtë ndjenjë e kanë 45% e të anketuarve (për cenonim e të drejtave të tjera janë deklaruar një numër tejet i vogël i të anketuarve). Në përgjithësi, në rast se bëhet një krahasim i frekuencave të përgjithshme të fituara nga anketa, në 4 komunat e mostrës sonë, qytetarët e Kërçovës tregojnë kriticitet në krahasim me të arriturat e pushtetit lokal. Kjo posaçërisht hetohet te modalitetet në vijim: në asnjë lëmi nuk ka përparim, nuk u përmirësuan shërbimet që i ofron pushteti lokal, nëse kam probleme nuk pres që komuna të m'i zgjidh, ose problemet zgjidhen vetëm me lidhje dhe me rryshfet. Edhe pse, në parim, shqiptarët janë më pak të kënaqur se maqedonasit me gjendjen në komunë, rangimi i këtillë në Kërçovë krahasuar me komunat tjera, ka të bëjë me kriticitetin e të dy bashkësive etnike në lidhje me pushtetin komunal. Në fund të përmendim se të anketuarit nga Kërçova, në përqindje më të madhe në krahasim me komunat tjera, deklaroi se nuk e shohin perspektivën e vet në komunën e tyre, bazuar në njohuritë e fituara në hulumtim me siguri i referohet gjendjes së keqe ekonomike në komunë.

Nëse krahasohet me komunat tjera, janë të nevojshme edhe tabelat.

A e shihni ju ardhmërinë tuaj në këtë komunë

	maqedonas	shqiptarë	Nacionalitet tjetër
1. Po	62,7%	48,4%	75,0%
2. Jo	35,8%	35,5%	25,0%
3. Për ne tashmë nuk ka rëndësi	1,5%	16,1%	
Gjithsej	100,0%	100,0%	100,0%

3. Përdorimi i gjuhës, flamujve, simboleve

Seancat e këshillit zhvillohen në gjuhën maqedonase dhe shqipe dhe të gjitha dokumentet përkthehen në dygjuhësi. (për shkak të mungesës së mjeteve financiare nuk ka pajisje për përkthim simultan). Përkthyesi i përhershëm ndihmon edhe në rastet kur bëhen parashtrësia deri te komuna për përfaqësuesit e bashkësisë shqiptare. Tekstet lekturohen në gjuhën maqedonase. Të gjitha mbishkrimet në komunë (reklamat, pllakatet, mbishkrimet në transportin publik) janë edhe në gjuhën maqedonase, por ka raste edhe të mbishkrimeve të cilat janë kryekëput në gjuhën shqipe. Ka vërejtje nga pjesëtarët e komunitetit turk se pse nuk është në përdorim edhe gjuha turke, por deri më tani nuk është bërë kërkesë në këtë drejtim për shkak të asaj se nuk ekzistojnë kushte objektive (mjete financiare).

Deri më tani nuk janë ngritur iniciativa për ndërrimin e emrave të rrugëve, shkollave, çerdheve, fshatrave etj. (as janë ndërtuar përmendore). Ekziston vlerësim politik se deri në këtë moment kjo nuk do të ishte produktive nga pikëpamja e marrëdhënieve ndërtnike, edhe pse kjo padyshim në të ardhmen do të ndodh. Nëpër shkollat, në të cilat mësimi

zhvillohet në njërin nga gjuhët e bashkësive pakica, mësohet edhe maqedonishtja me 2 orë në javë.

Përfaqësuesi i bashkësisë turke konsideron se ekzistojnë çështje të cilat do t'i kishte parashtruar për t'u zgjidhur para Këshillit, e të cilat ndërlidhen me ruajtjen e identitetit të bashkësisë së tij: hapja e paraleleve për arsimin fillor në gjuhën turke në një shkollë, rregullimi i varrezave myslimane në një fshat turk, përdorim i flamurit turk në vende publike, por konsideron se nuk ka sens për këtë (priten *obstruksione dhe mosmiratime*). Një pjesë e këshilltarëve të tjerë deklaruan se kërkesat e këtilla janë legjitime, por për këtë nuk ka mjete në komunë. (Demokracia është gjë e shtrenjtë, apo jo?)

PËRFUNDIM:

Analiza tregon se në funksionimi i deritanishëm të pushtetit lokal në komunë nuk ka shumë elemente të cilat do të mundësonin përcjelljen e funksionimit të mekanizmit të ndarjes së pushtetit. Proporcionaliteti është në vetë zanafillën e vet, kurse të gjitha komunitetet janë në gjendje të pritjes (ankthit) dhe sillen ndërmjet veti me mosbesim (është prezente energjia negative). Droje, nga njëra anë se a do të fillojë me të vërtetë ai proces, e nga ana tjetër, çka do të ndodh pasi të fillojë (maqedonasit këtë e ndejnë, me ose pa të drejtë si mbyllje të perspektivave)

Edhe me zbatimin e të a.q. e drejta e Badenterit nuk ka asnjë përvojë deri më tani, gjë që gjithsesi është rezultat i vlerësimit se pyetjet e këtij tipi duhet të presin, për shkak të krijimit të një klime më të mirë politike. Në këtë kuptim edhe çështjet e ndërlidhura me simbolet e bashkësive etnike (flamuj, emra të objekteve publike, rrugëve, toponimet etj. Nuk u gjenden në rend dite në Këshillat e komunës).

Këtë mekanizëm të ndarjes së pushtetit e perceptonim në rrethinën e tij më të gjerë: ekonomi, funksionim të modelit të ri të pushtetit të decentralizuar, nivelit të deritanishëm të marrëdhënieve ndëretnike në komunë, si supozime për funksionalitet më të madh të tij.

Kur bëhet fjalë për Kërçovën, ekonomia është definitivisht hipotezë negative, sepse punohet për komunë të varfër, me resurse shumë të kufizuara.

Modeli i ri i pushtetit të decentralizuar është në vet fillimin dhe është vështirë të evoluojë, por prandaj mund të tërhiqet vëmendja për më shumë elemente të cilat do ta vështirësojnë funksionimin e tij. Në këtë kontekst nuk duhet që për këtë të ndërlidhen shumë pritje, të paktën për një kohë të caktuar (në publik u plasuan edhe deklarata të tilla), sepse në të kundërtën zhgënjimet do të jenë më të mëdha. Nga ana tjetër konfrontimet prezente partiake në Këshillin vetëm në mënyrë plotësuese e ngarkojnë ambientin dhe i zvogëlojnë efektet nga veprimi i pushtetit lokal.

Niveli i deritanishëm i marrëdhënieve ndëretnike do të mund të vlerësohej si relativisht i kënaqshëm (sidomos në krahasim me disa mjedise tjera në IRJM), që do të mund të vlerësohej si pozitiv.

Në përgjithësi, rezultatet hulumtuese japin mundësi që të tërhiqet vëmendja me sa vijon: model i ri i ndarjes së pushtetit (do të) zhvillohet në kushte relativisht të vështirësuar, për të cilat duhet të ekzistojë vetëdija te ata (do me thënë pjesëtarët e të gjitha bashkësive etnike) që të mund të caktohen kufijtë. Kjo akoma më shumë për shkak të efikasitetit më të ulët të sistemit (edhe në nivel qendror edhe në nivel lokal) i cili nuk është në gjendje të prodhojë zgjidhje të kënaqshme për të gjithë qytetarët në komunë (dhe shtet) shumë lehtë mund të (keq)përdoren për qorrim hesapësh ndëretnike, në rast se kjo është në interes të politikanëve. **Se kjo nuk është raritet, e bëjnë të qartë edhe deklaratat e të gjithë bashkëbiseduesve tanë të cilët thonë se politikanët lehtë mund ta ndezin zjarrin, respektivisht se roli i tyre është shumë i vogël. Tekefundit këtë e shohim edhe gjatë kampanjës për zgjedhjet parlamentare të vitit 2006, ku deklarata e llojit *Asgjë nuk***

Ndarja e pushtetit

Model i ri për vendimmarje në komunat multikulturore

është bërë me realizimin e Marrëveshjes kornizë, që vijnë prej politikanëve shqiptarë ose Struga tashmë nuk është ajo që ishte, maqedonasit nuk guxojnë të shëtisin nëpër rrugën kryesore, që mund të dëgjohet akoma nga goja e ndonjë politikani maqedonas, sigurisht nuk kontribuojnë për ndërtimin e mirëbesimit të ndërsjellë ndërmjet komuniteteve.

2.2. KOMUNA E GOSTIVARIT

Numri i banorëve: 81.042
 Numri i vendbanimeve: 31
 Sipërfaqja:
 Struktura etnike e popullatës:
 Shqiptarë: 66,6% Romë: 3,8%
 Maqedonas: 19,5% Të tjerë:
 Turq: 9,8%

Gjithsej të punësuar në NjVL: 53
 Struktura arsimore:
 Struktura etnike: 38 shqiptarë, 14 maqedonas, 1 turk, 1 rom

Organet e administrimit në komunë:

Kryetari i komunës: Nevzat Bejta, shqiptar, BDI

Struktura etnike dhe partiake e këshilltarëve:

	Maqedonas	Shqiptarë	Turq	Romë	Gjithsej
BDI		14			
PDSH-PPD		8			
PDT			4		
LSDM	3				
VMRO-DPMNE	1				
VMRO-PP	1				
Gjithsej:	5	22	4		31

Struktura gjinore:
 Meshkuj: 24
 Femra: 7

A) Koncepti i ri i vetëqeverisjes lokale

1. Çka mendojnë qytetarët për të?

Në parim bashkëbiseduesit tanë kishin qëndrim pozitiv drejt konceptit të ri të vetëqeverisjes lokale, duke vlerësuar se *si pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në proceset të cilat zhvillohen në komunë; vetëqeverisja lokale do të jetë shumë më e përgjegjshme ndaj qytetarëve të saj; ajo është shumë më afër qytetarëve dhe problemet zgjidhen në mënyrë*

më efektive; decentralizimi ishte i domosdoshëm, sepse vendi ynë ishte shteti më i centralizuar në botë.

Ligji për kufijtë e ri të komunave shkaktoi mjaft reagime kontradiktore, me ç' rast kësaj radhe si kritikë të saj nuk u paraqitën vetëm maqedonasit (siç pritej), por edhe përfaqësuesit e shqiptarëve të cilët nuk janë nga partia në pushtet. Ata bëjnë vërejtje se ndarjes ekzistuese nuk i ka paraprirë një analizë, mbi baza të së cilës do të ndërtoheshin kriteret dhe do të realizohej ndarja, por kanë dominuar *dofarë kritere politike; Janë formuar disa komuna artificiale për shkaqe të caktuara politike, kurse janë shuar disa komuna të cilat kanë pasur kapacitet të madh; Ka për tepër politikë në definimin e komunave, pa mos u marrë parasysh faktori ekonomik.*

Kjo sipas bashkëbiseduesve tanë do të ketë implikacione negative mbi zhvillimin ekonomik në disa nga komunat.

2. Çka pritet konkretisht nga zbatimi i modelit të ri të vetëqeverisjes lokale?

Pritjet janë, do të thoshim, relativisht të larmishme. Përderisa disa presin vetëm *ndryshime pozitive në të gjitha sferat e jetës*, madje përmendin se ndryshimet *tashmë janë të dukshme* (të tilla janë para së gjithash opinionet e pjesëtarëve të partisë më të madhe në Këshill); bashkëbiseduesit tjerë janë më të përmbajtur, duke u fokusuar në shëndetësinë dhe arsimin, si sfera ku në të ardhmen do të ketë ndryshime më të mëdha (pozitive). Më të maturit, tani për tani i theksojnë përmirësimet në sferën e infrastrukturës dhe higjienës në komunë. Disa nga këshilltarët maqedonas, theksojnë se ndryshimet më së shumti do të reflektohen mbi strukturën etnike të të punësuarve: *Ndryshimet ecin në kahe negative. Shembull për këtë është shëndetësia. Në shëndetësinë primare u vunë të punojnë maqedonas, që kur të vihen nën ombrellën e lokale, të mbeten pa punë, e kjo është kundër ligjit, por këtu ligji nuk respektohet; pritej që të përmirësohet standardi jetësor dhe marrëdhëniet ndëretnike, tani për tani nuk ka asgjë prej kësaj...*

Por si e vlerësuan qytetarët e anketuar punën e pushteteve lokale?

Në rast se bëhet një analizë komparative e frekuencave të përgjithshme, del se qytetarët nga Gostivari janë më të kënaqur nga autoritetet e tyre lokale. Madje mbi 60% e të anketuarve arritjet e deritanishme të pushtetit lokal i vlerësojnë si pozitive, gjë që është shumë më e volitshme sesa në komunat tjera (vlerësime negative kanë dhënë vetëm 9%); Kontributi i kryetarit të komunës është gjithashtu i vlerësuar shumë lartë, ndërsa kontributi i kontributi i shtetit është vlerësuar si më i ulët në krahasim me komunat tjera. Në këtë komunë më e lartë është përqindja e të anketuarve të cilët janë deklaruar se tani shërbimet të cilat merren nga pushteti lokal janë përmirësuar krahasuar me më parë.

Parashtrahet pyetja a u referohen këto vlerësime pozitive vetëm kënaqësisë së shqiptarëve ose edhe të maqedonasve? Kjo është, nënkuptohet, shumë e rëndësishme nga pikëpamja e hulumtimit tonë. Përshtypja e përgjithshme e analizës së të dhënave të kryqëzuara është se krahas faktit që shqiptarët shprehin shkallë më të lartë të kënaqësisë, në ndërtimin e vlerësimit të përgjithshëm për suksesin e autoriteteve lokale kanë marrë pjesë edhe maqedonasit e anketuar. Kështu për shembull, rezultatet e deritanishme nga puna e autoriteteve lokale i vlerësojnë pozitivisht rreth 48% të maqedonasve, madje 85% e tyre meritën ia përshkruajnë kryetarit të komunës (Shqiptarët meritën për notë pozitive - 79%, e ndajnë ndërmjet kryetarit të komunës (50%) dhe këshillit (37%); rreth 70% e maqedonasve të anketuar konsiderojnë se shërbimet që i jep pushteti komunal tani janë përmirësuar (kjo përqindje të shqiptarët është 77%); 79% e maqedonasve të anketuar deklarojnë se kryetari i komunës i ka përmbushur pritjet e tyre (75% e shqiptarëve);

shërbimet që ofrojnë autoritetet lokale janë përmirësuar sipas mendimit të 70% të maqedonasve dhe 70% të shqiptarëve etj.

Cilat janë problemet e maqedonasve? Anketa ve në dukje se papunësia është problemi numër një për të anketuarit maqedonas (shumë para të gjitha problemeve tjera), ndërsa në vendin e dytë (me të njëjtën rëndësi) janë numëruar: problemet infrastrukturore, shëndetësia, korrupsioni (Te shqiptarët, përveç punësimit që mban të sigurt vendin e parë, pasojnë problemet infrastrukturore, dhe në vendin e tretë janë ekologjia dhe arsimiti. Është për të nënvizuar se rreth 15-20% e maqedonasve të anketuar kanë përshtypjen se nuk janë njëjloj të trajtuar si bashkëqytetarët e tij shqiptarë. Rreth 18% konsiderojnë se pozita e bashkësisë së tyre etnike është e rrezikuar në komunë (te shqiptarët kjo përqindje është nën 1%), ndërsa arsyet për një qëndrim të këtillë janë se maqedonasit shpërngulen, nuk i respektojnë të drejtat e tyre, respektivisht shqiptarët punësohen, kurse maqedonasit përjashtohen nga puna. Ndoshta për këtë shkak rreth 35% e maqedonasve deklarojnë se e drejta e punësimit u është rrezikuar (këtë ndjenjë e kanë rreth 5% e shqiptarëve, kurse në vendin e dytë sipas rrezikimit është e drejta e pronësisë për maqedonasit (rreth 12%), ndërsa te shqiptarët kjo përqindje është 5 %. Rreth 22% mendojnë se bashkësia e tyre etnike është e diskriminuar në komunë (5% e shqiptarëve mendojnë se janë të diskriminuar), rreth 22% e maqedonasve deklarojnë se kanë pasur probleme në komunë për shkak të barrierës gjuhësore (kjo përqindje është te shqiptarët rreth 7%) etj. Dhe në fund është pyetja për atë se qytetarët e anketuar a e shohin ardhmërinë e tyre në komunë.

	Maqedonas	Shqiptarë	Nacionalitet tjetër	Gjithsej
1. Po	69.1%	88,4%	100,0%	82,6%
2. Jo	25,0%	4,8%	11,0%	
3. Për mua nuk është me rëndësi	5,9%	6,8%		6,4%
Gjithsej	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%

3. Me cilat probleme ndeshet komuna në realizimin e konceptit të ri të decentralizimit të pushtetit?

Personat e intervistuar i theksuan këto probleme: burimet e financimit dhe lartësia e të hyrave, transferi i ngadalshëm i kompetencave në nivel lokal, (sipas disave – transfero i kompetencave ndoshta është tepër i madh, por dotacionet nga shteti janë të pamjaftueshme). Nga ana tjetër bashkëpunimi me shtetin është shumë i mirë (sipas një bashkëbiseduesi edhe të tepruara), por edhe të hyrat me të cilat disponon komuna janë shumë më të larta sesa në disa komuna tjera. Në komunë deklarojnë se me ardhjen e pushtetit të ri dukshëm është rritur pagesa e obligimeve nga ana e qytetarëve, kurse gjendja financiare e komunës do të ishte shumë më e mirë në rast se nuk do të ishin

borxhet e mëdha të trashëguara, të cilat duhet t'i kthejë tani ky pushtet (sipas kryetarit të komunës). Qëndrimi i kryetarit të komunës ndaj problemeve me të cilat ballafaqohen komunat është se duhet më shumë të punohet e më pak të ankohemi (*të mos bëhemi qyqarë*) dhe se kështu nuk do të mungojnë rezultatet.

B. EKONOMIA

Edhe në planin ekonomik u ballafaquam me storien e zakonshme të tranzicionit. Gjatë kohës së socializmit në Gostivar kanë punuar disa kapacitete industriale si për shembull Silika, Mermeri, Goteksi, Qelqtorja..., të cilat kanë absorbuar një numër të madh të punonjësve, sipas përkatësisë etnike më në numër kanë qenë maqedonas. Me privativim këto firma janë mbyllur, punonjësit i janë bashkangjitur armatës së të papunësuarve, (llogaritet se rreth 8.000 njerëz janë pushuar nga puna), ndërsa firmat e reja, të cilat në Gostivar megjithatë nuk janë pak, nuk mundën as përafërsisht të absorbojnë një vëllim aq të madh të fuqisë së punës si të mëparshmet (ata punësojnë më së shumti 100 persona). Kapitali është kryesisht në duart e shqiptarëve. Roli i diasporës është i rëndësishëm, por njerëzit akoma nuk kanë besim në institucionet e sistemit që të investojnë. Sipas mendimit të shumicës së bashkëbiseduesve, është bërë privatizim jo i drejtë dhe i dyshimtë (*askush sot nuk e di prejardhjen e kapitalit që investohet*), *humbën të gjithë përveç një numri të vogël të njerëzve të cilët u pasuruan. (Humbja megjithatë është më e madhe te ata të cilët e humbën punën).*

Në bisedat u përmendën këto probleme: pengesa për përmirësimin e ekonomisë janë gjendjet e përgjithshme në shtet, korrupsioni, (*kurbetçinjtë do të kishin investuar por kërkojnë siguri të plotë dhe të mos keqpërdoren nga burokracia*) ligji për tokë ndërtimore i cili nuk i mundëson komunës të tërheq investime të huaja.

Sot në Gostivar ka 3.645 subjekte afariste, nënkuptohet me fuqi të ndryshme ekonomike. Punësimi në degët kryesore ekonomike është me sa vijon: tregti dhe riparim -14,6%, industri përpunuese - 13,0%, arsim - 11,5%, shëndetësi dhe punë sociale - 9,5%, administratë publike dhe mbrojtje - 8,6%.

Edhe pse gjatë analizës së të dhënave për (pa)punësimin gjithnjë duhet pasur parasysh fakti për ekonominë mjaft të përhapur të përhirtë, që e relativizon rëndësinë e të dhënave zyrtare (kur bëhet fjalë për Gostivarin duhet të merren parasysh edhe mundësit që i ofron bujqësia), mbetet fakti se në strukturën e të punësuarve e rëndësishme është përqindja e atyre të cilët financohen nga fondet shtetërore. Kjo u jep dimension të posaçëm marrëdhënieve ndëretnike, respektivisht krijon kushte “ai që e ka pushtetin t'i favorizojë të vetët”, gjë që në kushte të ashpërsuara ekonomiko-sociale posaçërisht fiton në peshë.

V. MARRËDHËNIET NDËRETNIKE NË KOMUNË

Bashkëbiseduesit e theksojnë traditën e mirë dhe të gjatë të marrëdhënieve ndëretnike në komunë, e cila fatmirësisht nuk ka qenë dukshëm e prishur as në vitin 2001. megjithatë të gjithë e pranojnë se konflikti në vitin 2001 ka ndikuar në ftohjen e marrëdhënieve dhe mirëbesimit të të ndërsjellë. Në lidhje me Marrëveshjen kornizë shumica e opinioneve janë pozitive, por maqedonasit theksojnë se zbatimi i saj krijon probleme të mëdha për maqedonasit. Ndoshta ilustrim më i mirë për perceptcionet e ndryshme të thelbit të Marrëveshjes së Ohrit janë deklaratat e dy gostivarasve: *Disa konsiderojnë se duhet të japin, kurse disa se duhet të marrin. Faktikisht askush as nuk jep e as nuk merr, vetëm duhet të zbatohet drejtësia. Në këtë kontekst duhet të ndryshohet edhe mentaliteti i*

qytetarëve.(shqiptar) Ose marrëveshja kornizë është sjellë shpejt e shpejt, në kushte të kanosjes nga lufta dhe nuk e shpreh raportin e vërtetë ndërmjet bashkësive etnike. Tentohet që sa më shpejtë të zbatohet, kurse kjo reflektohet negativisht mbi maqedonasit e pjesës perëndimore të shtetit (maqedonas).

Maqedonasit dhe turqit ndjehen të lënë pas dore, si qytetarë të rendit të dytë.

Politikanët kanë ndikim të madh mbi marrëdhëniet ndëretnike, pajtohen bashkëbiseduesit tanë, pavarësisht nga përkatësia etnike. Për fat të keq politikanët e deritanishëm luanin në kartën nacionale, e jo ti kthehen ekonomisë dhe mirëqenies. Popullsitët bien në këtë grackë dhe e gjithë kjo ndikon në marrëdhëniet ndëretnike (shqiptar)

G. NDARJA E PUSHTETIT

1. Përfaqësimi i drejtë

Në administratë dominojnë shqiptarët, ndërsa për ndërmarrjet dhe institucionet publike nuk mundëm të sigurojmë të dhëna të sakta. Prej më shumë burimesh kuptojmë se në to, në masë të madhe reflektohet struktura etnike e komunës, por ka edhe opinione të kundërta. Sipas fjalëve të kryetarit të komunës, meqë deri më tani nuk është realizuar parimi i përfaqësimit të drejtë (të privilegjuar kanë qenë maqedonasit), kohëve të fundit bëhen përpjekje posaçërisht në sferën e shëndetësisë.

Si i perceptojnë këto procese qytetarët?

Prej 14 të punësuarve të rinj në shëndetësi 13 janë shqiptarë, ndërsa vetëm një është maqedonas.

Maqedonasit janë në gjithçka të kufizuar, pa mundësi që të ndërmarrin çfarë do qoftë aksioni. Turqit lehtë manipulohen. Shqiptarët e treguan mbifuzimin e vet.

Gjithçka varet nga vullneti i elektoratit shqiptar.

Maqedonasit nuk duan të kuptojnë se ky është shtet multinacional dhe se shteti njënacional tani më është tejkaluar.

Në lidhje me zbatimin e parimit të përfaqësimit proporcional të pakënaqur ka në të gjitha bashkësitë etnike, për shkak të zbatimit të shpejtë, sipas njëres palë, ose të ngadaltë, sipas mendimit të palës tjetër të këtij parimi.

2. Procesi i vendimmarrjes

Në komunën e Gostivarit ekzistojnë të gjitha parakushtet organizative teknike për punë kualitative të këshillit të komunës: kushte adekuate hapësimore, seancat prenotohen paraprakisht me material të shpërndarë, diskutimet zhvillohen në gjuhën shqipe, maqedonase dhe turke. Aparaturë për përkthim simultan akoma nuk ka, por planifikohet të sigurohet ajo.

Këshilli numëron 31 anëtarë, kurse kuorumi asnjëherë nuk ka qenë problem.

Nga një pjesë e mirë e seancave kanë munguar këshilltarët e PDSH-së, që është rezultat i marrëdhënieve të dy partive më të mëdha edhe në nivel qendror. Përveç këshilltarëve të PDSH-së, opozitën e përbëjnë 1 këshilltar i VMRO DPMNE, 1 këshilltar i VMRO PP. Tre këshilltarët tjerë me prejardhje etnike maqedonase janë nga radhët e LSDM, të cilët janë në koalicion edhe në nivel lokal edhe në nivel qendror me BDI.

Për dallim nga komunat tjera të mostrës sonë zgjasin relativisht shkurt, diskutimet janë të rralla dhe më shumë të natyrës procedurale. Madje edhe për ato pika të rendit të ditës për të cilat mund të priten debate, këtu mungojnë. Do me thënë nga pikëpamja e kohës dhe energjisë së harxhuar, këshilli është shumë efikas në vendimmarrjen. A i referohet kjo përgatitjes së mirë të seancave, punës fundamentale të komisioneve ose diçka tjetër, është

vështirë të jepet përgjigje. Materiali empirik që është në dispozicion nuk ishte sa duhet valid për marrjen e konkluzioneve të forta. Megjithatë disa indikacione vënë në pah me sa vijon. Opozita me vetëm 2 këshilltarë (që të dy m,e prejardhje maqedonase) është një balancë mjaft e dobët kundrejt koalicionit në pushtet. Nëse kësaj i shtohet fakti se kryetari i komunës i takon një rës nga partitë e cila ka numër më të madh të pjesëtarëve në këshill, raporti i fuqive nënkuptohet është në favor të pushtetit. (*Këshilltarët e opozitës e perceptojnë pushtetin e kryetarit të komunës si shumë të madh dhe se nuk ekziston mundësi ligjore për kontrollim të tij*). Disiplina e pozitës së nënrednitor të degëve lokale partiake përballë qendrës (karakteristike për partitë në IRJM) akoma më shumë e forcojnë botëkuptimin e këtyre.

Në këtë kontekst ilustrative janë dy seanca: ajo që u mbajt më 25.01.2006 për të cilën vëzhguesi ka konstatuar se *për dallim të seancave tjera, seanca kishte më shumë propozime nga ana e këshilltarëve*. Pjesa më e madhe e propozimeve rreth 14, që mund të konstatohej edhe nga procesverbalet) nga ana e këshilltarëve të LSDM-së, e të cilat kanë të bëjnë me Statutin e Komunës, nuk u pranuan nga shumica e këshilltarëve (shqiptarë). Në fakt u pranuan vetëm 3. Dhe rasti i dytë: në seancën e mbajtur më 27.02.2006 këshilltari maqedonas nga opozita parashtron pyetje kush dhe pse propozon shkarkimin e një maqedonaseje nga këshilli drejtues i një institucioni publik, që më pas të zëvendësohet me një shqiptar, sqarim praktikisht nuk është dhënë, kurse propozimi është miratuar me 19 vota *pro* dhe 5 *kundër* (votimi është në bazë etnike). Në fakt sipas procesverbalit, përgjigja e pyetjes së parashtruar ka qenë: “Anëtarët e këshillave emërohen dhe shkarkohen në interes të një funksionimi më efikas të atyre institucioneve. Ne nuk mundemi ta pengojmë punën e suksesshme të ndonjë institucioni për shkak të ndonjë anëtari ose anëtareje të këshillit drejtues.” Nënkuptohej në bazë të këtyre rasteve as mundemi e as kemi për qëllim të nxjerrim disa përfundime, por i theksuam vetëm ato indikacione për votim etnik, aq më tepër se edhe në raste tjera kur propozimet janë dhënë nga këshilltarët maqedonas vërehet votimi etnik (më së shumti për çështje nga lëmi i urbanizmit dhe çështjeve komunale).

Në periudhën e shkuar nuk është shfrytëzuar e a.q. shumica e Badenterit për votim, kurse dy pyetje të cilat ajo i ka përfaqësuar kanë qenë për futjen e gjuhës turke si gjuhë të tretë zyrtare në të cilën do të zhvillohet puna në Këshill dhe përcaktim i datës e cila do të konsiderohet si ditëlindje e komunës. Që të dy propozimet janë pranuar njëzëri. Kryetari i komunës në mënyrë absolute e ka përkrahur propozimin për gjuhën turke, duke theksuar se e përkrah edhe propozimin për gjuhën rome, por duhet të gjendet përkthyes, që është problem. Megjithatë, duhet të kihet parasysh se para zgjedhjeve për kryetar komune, është arritur marrëveshje ndërmjet e Partisë Demokratike të Turqve dhe BDI-së, që bashkësia turke ta mbështet propozimin e BDI-së, ndërsa si kompensim të merr përdorimin zyrtar të gjuhës turke në komunë.

Këshilltarët nuk janë deklaruar formalisht se cilës bashkësi etnike i takojnë, komisioni për marrëdhëniet ndëretnike nuk është tubuar deri më tani, sepse sipas bashkëbiseduesve tanë nuk ka pasur nevojë.

Prej bisedave tona fituam përshtypjen se këshilltarëve nuk u është shumë e qartë nevoja për “të drejtën e Badenterit” dhe se përdorimin eventual të këti mekanizmi e kupton, para së gjithash, si indikator të problemeve në vo marrëdhëniet ndëretnike, prandaj konsiderojnë se *tani për tani, tek ata nuk ka nevojë për të*. Ose në rast se e përkrahin zbatimin e tij akoma nuk e dinë se a do të zbatohet dhe si do të zbatohet në praktikë në komunë.

3. Përdorimi i gjuhës, flamujve, simboleve

Seancat e këshillit zhvillohen në maqedonisht dhe shqip (më vonë është miratuar vendim edhe për gjuhën turke), kurse furnizimi me pajisje për përkthim simuluan do ta rrit kualitetin e punës. Pjesëtarëve të bashkësive të caktuara etnike u është mundësuar t'u drejtohen në gjuhën e tyre shërbimeve komunale, kurse të gjitha materialet shpallen në dygjuhësi. (Materialet nuk lekturohen, sipas një pjese të bashkëbiseduesve). Sa i përket përdorimit të gjuhës maqedonase në vendet publike në komunë (firma, mbishkrime, transport publik etj.) kjo e drejtë kryesisht respektohet.

Edhe pse nuk fituam njohuri ekzakte për ndryshimin e emrave të rrugëve, shkollave, institucioneve etj. Përfaqësuesi i partisë shqiptare opozitare deklaroi se në të ardhmen ka për qëllim të parashtojë shumë kërkesa të këtij lloji.

KONKLUZION

Në komunën e Gostivarit funksionimi i mekanizmit të ndarjes së pushtetit është në vetë fillimin të tij, për ç' arsye ka shumë pak raste përmes të cilave do të mund të vlerësoheshin efektet që ky model i prodhon. E drejta e Badenterit akoma nuk është zbatuar gjatë vendimarrjes në këshillin e komunës, në lidhje me zbatimin e përfaqësimit proporcional, përvoja ka por procesi akoma zgjat, kurse çështjet e ndërlydhura me ndryshimin e emrave të rrugëve, institucioneve publike etj. ani do të pasojnë. Do të thoshim modeli ani do të vihet në provë.

Kur bëhet fjalë për hipotezat themelore të cilat e përbëjnë rrethinën, do të thoshim se situata ofron optimizëm. Gjendja ekonomike në Gostivar është më e volitshme sesa për shembull në Kërçovë; pushteti i ri lokal tashmë mund të lavdërohet se ka rezultate të caktuara, të cilat nuk kanë mbetur të pavërejtura nga pjesa më e madhe e qytetarëve. Akoma më e rëndësishme, nga pikëpamja e hulumtimit tonë, është se ato rezultate i kanë ndjerë si shqiptarët ashtu edhe maqedonasit, që është e evidente nga rezultatet e fituara në anketë. Dhe përfundimisht marrëdhëniet ndëretnike mund të vlerësohen si të kënaqshme, edhe pse nga intervista me një përfaqësues shoqatave joqeveritare rrome kuptuam se edhe krahas përpjekjeve që i bën ky komunitet edhe më tutje ata janë të diskriminuar, që nënkuptohet nuk është rast vetëm në Gostivar.

A ka kanosje ose ku mund të identifikohen pikat neuralgjike? Votimi në bazë të linjës etnike nuk është e panjohur për këshillin e Gostivarit, dhe në kushte të një opozite të dobët, përkundër pozitës së pacenueshme të kryetarit, ka kushte që kërkesat e komunitetit maqedonas, turk dhe rom të marginalizohen. Akoma më shumë sepse zbatimi më intensiv i parimit për përfaqësim proporcional, në ndryshimin që do të pasojë të emrave të rrugëve, institucioneve, shkollave etj. Me siguri do të jetë burim potencial i konflikteve. Vështirë do të mund të supozohej se zhvillimi ekonomik i komunës do të shkojë me këtë temp që t'i amortizojë problemet sociale e me këtë edhe ato ndëretnike.

2.3. KOMUNA E STRUGËS

A. Koncepti i ri i vetëqeverisjes lokale

1. Çka mendojnë qytetarët për të?

Edhe krahas qëndrimit pozitiv parimor ndaj konceptit të ri për vetëqeverisje lokale, vëmendja e bashkëbiseduesit tonë maqedonas ishte e orientuar drejt një aspekti të procesit të decentralizimit në vednin tonë – organizimi i ri territorial. Krejtësisht e pritur, duke pasur parasysh faktin se Ligji për organizim territorial të vetëqeverisjes lokale, kufijtë e komunës së Strugës janë zgjeruar dukshëm dhe në përbërjen e saj hynë shumë rajone rurale më popullatë shqiptare. Kjo shkaktoi ndryshim drastik të përbërjes etnike të komunës: nga popullata shumicë maqedonasi u bënë pakicë në komunë. Maqedonasit këtë e përjetuan si padrejtësi të madhe që rezultoi me protesta të mëdha, të cilat kishin karakter të dhunshëm (mllefi para së gjithash ishte i drejtuar ndaj Qeverisë maqedonase dhe kryeministrit të saj, të cilët konsideronin si faktorë kryesorë për situatën e krijuar). Me presion të dhunshëm politik u rregullua, por këto ngjarje lanë gjurmë të thellë të popullata. Kjo është e dukshme edhe në hulumtimin tonë.

Konceptin e ri për vetëqeverisje lokale maqedonasit e kësaj komune e perceptojnë para së gjithash përmes ndarjes së re territoriale, me të cilën ata *prej shumice kaluan në pakicë në komunën dhe shtetin e ve*. Krejt e pritur, qëndrimi i tyre ndaj këtij aspekti – kufijve të ri komunalë, është negativ. Në parim, zgjidhje e mirë ideore (mendohet në decentralizimin) *me koncept të realizuar në mënyrë katastrofale të ndarjes territoriale; Marrëdhëniet ndëretnike do të pësojnë për shkak të dominimit të njërit mbi etnikumet tjera; kornizat më ndryshe komunale me të cilat është përzier popullata rurale dhe qytetare, kontribuon që Struga të jetë e vështirë për t'u menaxhuar; nuk është mbajtur llogari për parametrat ekonomike të komunave të reja*.

Perceptioni i bashkëbiseduesve shqiptarë është krejtësisht e kundërt. Ata fokusohen në procesin e decentralizimit: *Pushteti është më afër qytetarëve; duhet të decentralizohen akoma më shumë ingerenca; Ligji është shumë me vend*.

Si e vlerësojnë qytetarët e anketuar pushtetin e ri lokal?

Analiza e të dhënave nga anketa ve në pah dy konstatime globale. E para është se kënaqësia nga puna e pushtetit të ri lokal është më e vogël se sa në Gostivar dhe Dibër. Dhe e dyta se perceptcionet e dy grupeve etnike në numër më të madh, shqiptarët dhe maqedonasit për pjesën më të madhe të çështjeve shumë ndryshojnë, më së shpeshti krejtësisht të kundërta. Në vazhdim do të prezantojmë një pjesë të të dhënave të cilat i ilustronjë këto konstatime. Vlerësime pozitive për punën e pushtetit lokal kanë dhënë rreth 62% e shqiptarëve dhe 11% e maqedonasve dhe anasjelltas: vlerësime negative kanë dhënë 34% e maqedonasve dhe 6% e shqiptarëve. Përgjegjësinë për punën e keqe maqedonasit e shohin te shteti (rreth 40%) dhe te qytetarët (16%), prej çka mund të supozohet se maqedonasit në përgjigjet e kësaj pyetjeje e kanë projektuar pakënaqësinë nga ndarja territoriale. Zhgënjimi nga puna e kryetarit të komunës te maqedonasit i referohet perceptcionit se ai kujdeset vetëm për etnikumin e vet (66%), ndërsa te shqiptarët në faktin se ai merret vetëm me çështje personale/partiake (61%), dhe pak bëri nga ajo që premtonte (58%). Në lidhje me perceptcionin e problemeve themelore në komunë ka ngjashmëri ndërmjet dy bashkësive, por edhe dallime. Edhe për maqedonasit edhe për shqiptarët mungesa e investimeve dhe punësimeve të reja është problemi më i madh

(dallimi është në atë se maqedonasit shfaqin brengosje shumë më të madhe (87%) sesa shqiptarët (67%). Për shqiptarët gati se rëndësi të njëjtë kanë edhe problemet infrastrukturore (64%), ndërsa për maqedonasit problemet infrastrukturore edhe pse të ranguara si të dytat megjithatë nuk janë të asaj rëndësie (43%). Dhe më në fund te problemi i ranguar në vend të tretë vërehen dallime thelbësore: për maqedonasit ai është korrupsioni (29%), kurse për shqiptarët gjendja sociale (25%). Ndërsa për numrin më të madh të shqiptarëve komuna është vendi ku mund të kërkojnë zgjidhje për problemet e tyre (42%), Maqedonasit konsiderojnë se problemet zgjidhen vetëm me lidhje, miqësi etj. (25%). Qasshmërinë më të vogël të komunës maqedonasit e përjetojnë edhe përmes pengesave në komunikimin për shkak të asaj se punonjësit nuk e kuptojnë gjuhën maqedonase (30%), ndërsa komunikimin gjuhësor si pengesë e adresojnë rreth 10% të shqiptarëve.

Cila e drejtë ju është shkelur?

	E drejta e punësimit	Siguria personale	E drejta e pronës	E drejta e informimit
Maqedonas	33,3%	14,5%	13,0%	11,6%
Shqiptarë	15,8%	12,9%	8,9%	9,9%

Konstatimi që mund të tërhiqet nga kjo pyetje është se të drejtat e sipërpërmendura me të njëjtën rradhitje janë problematike te qytetarët të të dyja bashkësive etnike, me atë që pjesëmarrja e rrezikshmërisë është më e shpërndarë te maqedonasit edhe atë sidomos në lidhje me punësimin.

Dhe më në fund perceptcioni i personave të anketuar në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike vetëm i konfirmoi njohuritë e fituara nëpërmjet intervistave me përfaqësuesit e partive politike dhe këshilltarëve.

Si është pozita e bashkësisë suaj etnike pas zgjedhjeve të vitit 2005 ?

	Maqedonas	Shqiptarë
1. Shumë e përmirësuar	1,4%	7,9%
2. E përmirësuar	15,9%	62,4%
3. Nuk ka ndryshuar	58,0%	29,7%
4. E keqësuar	15,9%	
5. Shumë e keqësuar	4,3%	
6. Nuk e di	4,3%	
Gjithsej	100,0	100,0%

Derisa përgjigjet e fituara tregojnë se pjesa më e madhe e shqiptarëve vërejnë ndryshime pozitive (rreth 70%), te të anketuarit maqedonas situata është ndryshe. Edhe krahas difuzitetit të përgjigjeve të dhëna, ndryshime pozitive perceptojnë rreth 17% e tyre. Vlerësimet e këqija për pozitën e grupit të vet etnik, maqedonasit i justifikojnë me argumentet në vijim: Kryetari i komunës punon vetëm për bashkësinë e vet etnike, nuk respektohen të drejtat e maqedonasve, punësohen vetëm shqiptarë, maqedonasit shpërngulen etj. Në njërin nga pyetjet e radhës 32% e maqedonasve do të deklarojnë se ata janë të diskriminuar në komunë (i tillë është mendimi i 16% të shqiptarëve). Krejt i pritur është edhe vlerësimi për efektet e Marrëveshjes së Ohrit janë të ndryshme te të dy bashkësitë etnike.

Si vlerësoni ndryshimet pas zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit

	Maqedonas	Shqiptarë
1. Pozitive	24,6%	79,2%
2. Negative	46,4%	4,0%
3. S'ka ndryshime	17,4%	3,0%
4. Nuk e di	11,6%	13,9%
5. Gjithsej:	100,0%	100,0%

2. Çka konkretisht pritet nga modeli i ri i vetëqeverisjes lokale?

Pritjet janë të ndryshme, por kur bëhet fjalë për bashkëbiseduesit maqedonas pesimizmi është evident, sidomos në marrëdhëniet ndëretnike... *Nuk e di çka mund të pritet në komunën tonë; priten ndryshime në shëndetësi dhe arsim, por për momentin ka vetëm zgjidhje të reja kuadrore (mendohet në punësimin e shqiptarëve). Pritet përmirësim i jetesës dhe perspektiva të paqarta në marrëdhëniet ndëretnike; ose qëndrimin i skajshëm negativ: Ndryshime negative – do të minimizohet nacionaliteti maqedonas, do të shqiptarizohen maqedonasit mysliman; pritet alkimi më adekuat i resurseve, përpjekje më e madhe për zhvillim të ekonomisë; marrëdhëniet ndëretnike do të pësojnë për shkak të dominimit të njërit mbi etnoset tjera; ndryshime më të mëdha do të ketë në arsim për shkak të mundësisë së mbikëqyrjes më të madhe nga ana e qytetarëve.*

Përkundër kësaj bashkëbiseduesit shqiptarë perceptojnë një pamje krejtësisht tjetër për ndryshimet e pritura: *priteshin ndryshime në turizëm, sepse këtu e shohim perspektivën, por edhe në arsim dhe shëndetësi; ndryshimet janë pranuar mirë nga qytetarët, ata ndjejnë se më mirë janë të shërbyer, më shpejt dhe më kualitativ dhe e gjithë kjo në frymën e marrëdhënieve ndëretnike.*

3. Me cilat probleme ndeshet komuna në realizimin e konceptit të ri të decentralizimit të pushtetit?

Bashkëpunimi me shtetin, konsiderojnë shumica e bashkëbiseduesve, nuk është problem (për këtë relacion të mirë i referohet fakti se udhëheqësia komunale, në momentin e hulumtimit ishte nga partia e njëjtë politike si edhe pushteti qendror: *Autoritetet lokale rrjedhin prej të njëjtës parti politike me ato shtetërore*, ndërsa edhe mungesa e mjeteve financiare në Strugë nuk është aq i theksuar si në disa komuna tjera (Struga bie në komunat mesatarisht të zhvilluara).

Si pengesa më të mëdha për funksionim të mëtejshëm të suksesshëm përmenden *kufijtë e ri komunal* (nga ana e maqedonasve), dhe burokracia nga ana e të gjithë të anketuarve: *stërzgjatet lëshimi i dokumenteve..., mungesa e masave të caktuara nga ana e shtetit i cili do të krijonte ambient të volitshëm për ekonominë.*

Optimistë më të mëdhenj janë një pjesë e shqiptarëve: *Asnjë pengesë nuk do të ketë nëse të gjitha kompetencat dhe pronat i përkasin komunës.*

B. Aspektet socio-ekonomike

Struga bie në komunat mesatarisht të zhvilluara në IRJM, në të cilat degë dominonte ekonomike kanë qenë industria tekstile dhe turizmi. Kapacitetet më të mëdha ekonomike, të cilat kanë punësuar edhe numrin më të madh të qytetarëve kanë qenë: Struzhanka, Boris Kidriç, Edinstvo, më shumë hotele etj. Në to, si të punësuar, kanë dominuar maqedonasit

etnik, të cilët me dështimin e këtyre firmave (ose me privatizimin e tyre), kanë mbetur pa punë. Në periudhën e tranzicionit janë formuar më shumë firma të reja të vëllimit më të vogël. Është interesante se maqedonasit thonë se ato janë kryesisht ndërmarrje të shqiptarëve, të cilët punësojnë vetëm në bazë etnike, ndërsa shqiptarët konsiderojnë se edhe kapitalin në formim e posedojnë maqedonasit. Sidoqoftë, shuarja e ndërmarrjeve të mëdha socialiste, njëlloj si edhe në viset tjera të vendit tonë, kontribuoi në rritjen e numrit të të papunësuarve, në mesin e të cilëve dominojnë maqedonasit. Sipas mendimit të një pjese të bashkëbiseduesve tanë *humbës në këtë tranzicion ekonomik janë maqedonasit* (d.m.th. theksohet komponenti etnik), ndërsa për bashkëbiseduesit tjerë – edhe maqedonasit edhe shqiptarët – *humbës janë të gjithë qytetarët, përveç një numri të vogël të të privilegjuarve* (Perceptcion të cilin e hasim edhe në komunat tjera). (*humbës është qytetari i thjeshtë, me kualifikime modeste dhe të rinjtë*)

Në përpjekje që t'i identifikojë arsyet për zhvillimin e ngadalshëm ekonomik të komunës bashkëbiseduesit tanë i cekën këto probleme: *Ekonomia ballafaqohet me mungesë të parave të freskëta, administratë të anshme shtetërore dhe komunale dhe potencial të keq menaxhues.*

Sot në Strugë ka 2.706 subjekte afariste, kurse punësimi në degët kryesore ekonomike është e renditur në mënyrën me sa vijon: Industria përpunuese - 20,7%; Shëndetësia dhe puna sociale - 14,4%; arsimiti - 9,0%, administrata publike dhe mbrojtja - 8,9%, tregtia dhe riparimi - 8,3%.

V. Marrëdhëniet ndëretnike në komunë

Ngarkesa negative dhe pakënaqësia nga ndryshimi i kufijve komunal te popullata maqedonase është e evidente dhe në përgjigjet e pyetjeve të ndërlidhura me marrëdhëniet ndëretnike. Edhe pse Struga është komunë tipike multi-etnike në të cilën ekziston traditë e gjatë e jetesës së përbashkët (konflikti 2001-shit nuk u përshkua edhe në këtë rajon), ndjenja e qëndrueshmërisë dhe rrezikshmërisë te popullata maqedonase është e dukshme.

Pjesa më e madhe e bashkëbiseduesve tanë (edhe shqiptarë edhe maqedonas) pranojnë se marrëdhëniet ndëretnike kanë qenë gjithmonë të mira. Maqedonasit konsiderojnë se shqiptarët në komunën e tyre gjithmonë i kanë gëzuar të gjitha të drejtat dhe nuk kanë pasur kurrfarë arsye të jenë të pakënaqur. *Pse të luftojnë në vitin 2001 kur kanë pasur dhe kanë jetuar jetë të shkëlqyer, më të mirë se maqedonasit; në Strugë edhe më herët vendet udhëheqëse në pushtetin lokal kanë qenë të ndara jo sipas përfaqësimit të drejtë por 50-50% ndërmjet bashkësive etnike, jeta ishte e shkëlqyer.* Në komunën e mëparshme të Strugës ku dallimi ndërmjet madhësisë së bashkësive etnike ishte e vogël, ekzistonte balancë më e madhe ndëretnike. Kjo kontribuoi që një numër shumë më i madh i vendimeve të miratohen me marrëveshje, sesa tani kur miratohen pa asnjëfarë marrëveshjeje por me mbivotim, respektivisht miratohen me 14 vota të shqiptarëve nga të dy partitë. Në pyetjen a nuk ekziston rivalitet ndërmjet BDI dhe PDSH-së, bashkëbiseduesit thanë se, konflikti ndërmjet tyre, të paktën në Strugë është vetëm halucinacion, sepse edhe në këshillin e komunës gjithmonë vendimet merren vetëm me shumicë të siguruar nga dy partitë.

Disa nga bashkëbiseduesit theksojnë se marrëdhëniet ndëretnike edhe pse nuk janë konfliktuoze (nuk ka debat ndërmjet qytetarëve të thjeshtë), ndërmjet dy bashkësive më të mëdha etnike nuk ka komunikim të mjaftueshëm, që reflektohet edhe në punën e Këshillit të komunës: *Funksionojmë si dy botëra madje edhe në këshill nuk ka kurrfarë koordinimi.*

E nëse ka pasur disa probleme: *Problemet i kanë bërë persona të kriminalizuar, të mbështetur nga politikanë, por nuk kanë arritur që të kenë mbështetje më të fortë nga*

shumica e qytetarëve të cilët janë esnafë dhe duan jetë normale dhe punë, është qëndrim i maqedonasve.

Marrëdhëniet ndëretnike ndryshonin për të keq pas konfliktit të armatosur të 2001-shit. Maqedonasit konstatojnë se lojaliteti i shqiptarëve ndaj shtetit është i dobët, krahas të gjithave, *lojalitet katastrofal, nuk i respektojnë as ligjet...Disa qytetarëve edhe shtetin t'ua japish, sërish do të jenë të pakënaqur.*

Ndërkaq, për dallim prej tyre, shqiptarët insistonin që në bisedat të na prezantojnë një pamje tjetër për marrëdhëniet ndëretnike në komunën e tyre: *Marrëdhëniet ndëretnike i karakterizon miqësia e ndërsjellë, ndihma dhe respektimi;komuna jonë është argumenti më i fortë për bashkëjetesë në tërë territorin e IRJM-së. Shembullin e këtillë edhe tani duhet ta ndjekin politikanët e të gjitha niveleve në IRJM.*

Në bazë të qëndrimeve dhe opinionëve të lartpërmendura edhe perceptioni i Marrëveshjes së Ohrit është krejtësisht e ndryshme. Në bisedat dëgjuam prej përgjigjesh skajshëm negative, deri në qëndrime të matura (te maqedonasit), respektivisht vlerësime skajshmërisht pozitive te shqiptarët:

Akt i miratuar me dhunë nën skenar paraprak, lobi grupe të përziera të jashtme; Marrëveshja e Ohrit implementohet njëanshëm. Shmangiet i bëjnë vetëm maqedonasit dhe ai akt aspak nuk është i qasshëm për qytetarin e thjeshtë (nuk është publik) me atë që vjen deri në keqpërdorimin e tij.(maqedonas)

Fer përgjigje, me dobësi të mëdha në implementimin e tij, posaçërisht për ndarjen territoriale...(maqedonas)

Marrëveshja e Ohrit duhet të implementohet gradualisht.(maqedonas)

Marrëveshja kornizë ishte bazë për finalizimin e konfliktit dhe një dokument i cili e siguron ardhmërinë e shtetit. Duhet të implementohet edhe në nivel të komunës, përndryshe nuk ka kuptim. (shqiptar)

Të gjithë bashkëbiseduesit tanë e theksojnë rëndësinë e madhe të politikanëve në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike, me ç' rast ata posaçërisht e ndien nevojën t'i theksojnë përvojat e këqija, ashtu sikurse, tekefundit, edhe te komunat tjera të mostrës sonë.

Politikanët veprojnë në kahe negative; Politikanët nga ndonjëherë për shkak të interesave të veta personale i stërzmadhojnë problemet; i nxisin qytetarët në kuptim negativ të fjalës; Potezat kryesore për harmoni ndëretnike i tërheqin politikanët.

V. NDARJA E PUSHTETIT

1. Përfaqësimi proporcional

Edhe pse mungojnë të dhëna të plota për atë se si është struktura etnike në ndërmarrjet publike dhe institucionet, fituam njohuri të caktuara se zhvillohen procese të ndërlikuara, edhe struktura e administratës lokale ka shumë më shumë maqedonas, që i referohet faktit se Struga ishte komunë me popullatë dominante maqedonase. Prej të cilëve përsëri të anketuarit shqiptarë janë relativisht të kënaqur, ndërsa te maqedonasit ekziston pakënaqësi dhe pasiguri në aspekt të mundësive për të ruajtur vendet e veta ekzistuese të punës ose të punësohen ata të cilët nuk janë të punësuar. Intervistat me disa prej këshilltarëve të nacionalitetit maqedonas, të cilët u takojnë partive të ndryshme politike teksohet fakti, që e vërejtëm edhe nga analiza e vendimeve të marra dhe akteve tjera të këshillit komunal, se sivjet, këshilltarët e nacionalitetit shqiptar si dhe kryetari i komunës më së shumti ishin të interesuar për të a.q. vendime komunale me të cilat ndryshon struktura e pronësisë në komunë. Në fakt, sipas tyre, merren vendime me të cilat ndërmarrjet e komunës të cilat kryejnë shërbime të karakterit publik u jepen pesonave privatë dhe me këtë e ndryshojnë

statusin prej ndërmarrjesh publike në ndërmarrje private. Për këtë lloj ndërmarrjesh nuk zbatohet parimi i “përfaqësimit të drejtë”, por vetëm për ato të cilat akoma janë komunale. Kështu maqedonasit vihen në pozitë të palakmueshme, ashtu që papunësia në kuadër të këtij komuniteti është rritur prej 8.500 në 9300. Bashkëbiseduesit tanë, me të drejtë konsiderojnë se në rast se veprimtaria është e karakterit publik, pavarësisht se çfarë është karakteri i pronësisë, duhet të zbatohet parimi i “përfaqësimit të drejtë”. Ky është një shembull i mirë se si definimi për “participim të plotë dhe efektiv të pakicave”, e cila shkon mbi çështjet kulturore” në sferën socio-ekonomike, pozita e grupeve fiton në kuptim dhe përmbajtje.

Vetë procesi i decentralizimit është vlerësuar si transfer kryesisht teknik i kompetencave, me ç’ rast çështja për kualitetin e shërbimeve që tani i marrin qytetarët aspak nuk është çështje diskutimi, kjo është prolonguar për ndonjë kohë tjetër. Me shuarjen e komunave të cilat tani hynë në përbërjen e komunës së Strugës, një numër i madh i iniciativave të filluara janë ndërprerë, kuadri që krijohet është i pashfrytëzuar ndërsa statusi i tanishëm i bashkësisë vendore është degraduar deri në atë masë, sa bashkësitë lokale nuk mund të kenë as xhiro llogarinë e vet.

Në firmat dhe organizatat, dëshirohet që menjëherë të zbatohet parimi i përfaqësimit proporcional. Pranohen persona pa mos u mbajtur llogari për ekspertizën dhe profesionalizmin; ose maqedonasit janë të pakënaqur, shqiptarët janë të kënaqur. Kjo do të ketë implikime të rënda. Dominanca dhe agresiviteti gjatë krijimit të politikave, punësimit pa rend, fut shqetësim, pakënaqësi dhe i luhat marrëdhëniet ndëretnike

Perceptimi i shqiptarëve është krejtësisht ndryshe.

Në administratë trashëguam 90% maqedonas dhe si ta përmirësojmë gjendjen? Parimi i proporcionalitetit duhet të zbatohet sa më shpejtë, sepse shqiptarët në komunë dhe në institucionet tjera nuk janë të përfaqësuar me 10%. Shqiptarët me të drejtë presin më shumë.

Kemi vepruar që të mos ketë implikacione në marrëdhëniet ndëretnike.

Rrjedh se askush nuk është i kënaqur nga kjo gjendje, të cilën duket qartë se të dy bashkësitë etnike e perceptojnë krejtësisht ndryshe.

2. E drejta e Badenterit

Ja se çfarë të dhëna fituam: këshilltarët nuk dinë se si ta komentojnë “të drejtën e Badenterit”; nuk e kanë sa duhet të qartë kur përdoret e kur jo. Askush prej shërbimeve profesionale ndoshta për motive të ndryshme nuk mund t’u ndihmojë për këtë; deri më tani asnjë vendim nuk është marrë me zbatimin e këtij parimi, madje as ajo për vendosjen e përmendores të njeriut i cili ngriti armët kundër bashkëqytetarëve të vet, komandant Struga, në një qytet në të cilin akoma shumicë janë maqedonasit. Vendimi është marrë në një seancë në të cilën nuk janë thirrur këshilltarët e bashkësisë etnike maqedonase, kurse autoritetet lokale e konsiderojnë si legale (ndërtimi i përmendores (menjëherë pas kësaj filloi edhe ndërtimi). (Maqedonasit këtë e përjetuan si provokim të rëndë dhe kjo e forcoi tek ta ndjenjën se janë të lënë pambrojtje, në një shoqëri në të cilën të tjerët (më të fuqishmit) nuk i respektojnë ligjet.) Nuk ka asnjëfarë koordinimi, as përputhshmëri opinionesh të anëtarëve të këshillit, kryetarëve. Disa vendime të rëndësishme për objekte infrastrukturore (për shembull si ajo për hapjen e rrugës për komunikacion buzë liqenit në lagjen Vreshtat e Liqenit) janë marrë në bazë të një formulimi të shkurtë pa arsyetim ose justifikim me ndonjë dokumentacion tjetër si për shembull plani detal urbanistik etj. Dhe pa votat e maqedonasve në këshill. Kështu, vendimarrja reduktohet në majorizimin e

maqedonasve të cilët janë të përfaqësuar në këshillin e komunës. Madje edhe disa iniciativa të cilat nga shumica e qytetarëve janë vlerësuar si të mira, si për shembull, brezi i gjelbër përgjatë lumit Drin, gjatë realizimit shkaktoi dyshim dhe mosbesim sepse kryhen pa rend të dukshëm dhe pa logjikë, me prishjen e objekteve ekonomike të maqedonasve. Vendimi për vendosjen e deponisë në fushën e Strugës, është theksuar nga bashkëbiseduesit si një tjetër shembull kur një vendim i rëndësishëm merret pa konsultime më të gjëra, vetëm për shkak të faktit se është siguruar shumica në këshillin e komunës. Duket se vërejtjet e ekspertëve dhe të tjerëve për vendin e deponisë si joadekuat, nuk janë përfillur.

Kontrolli më efikas mbi pushtetin lokal është ajo që vjen nga shteti përmes inspektorateve të ndryshme, por ato janë të ngadalshme dhe mjaft efektive, e krahas kësaj, majorizimi është i mbështetur prej “nivellit më të lartë”. Në pyetjen tonë se cili është “niveli më i lartë”, anëtarët e intervistuar të këshillit na sqarojnë se në centralet partiake të koalicionit në pushtet, (deri në zgjedhjet e korrikut 2006) ekziston marrëveshje që të mos problematizohen disa çështje nga marrëdhëniet ndëretnike për të mos u destabilizuar situata politike.

Zbatimi i vetos së pakicës, siç është formuluar tani, nuk ofron mbrojtje të vërtetë nga majorizimi, sepse ka të bëjë jo vetëm me vendimet nga lëmi i kulturës, stemës dhe flamurit në komunë, si dhe përdorimin e gjuhës së bashkësive që janë nën 20% , që varet nga vullneti i mirë dhe llogaritë zgjedhore të partive të përfaqësuara në këshillin e komunave. Sëkëndejmi, as në ligjin, as në statutet nuk janë numëruar në mënyrë më precize situatat në të cilat zbatohet kjo e drejtë, me çka u është dëmtuar puna vetë këshilltarëve dhe varen nga dituria eventuale dhe vullneti i mirë i kryetarit të komunës dhe administrata komunale. Nëse dihet se këshilltarët materialisht nuk janë të stimuluar për këtë funksion të vet shoqëror, bëhet e qartë se janë të vënë në pozitë inferiore në raport me kryetarin e komunës dhe administratën komunale e cila është nën të.

Majorizimi vërehet edhe në atë se janë formuar komisione nga ana e kryetarit të komunës dhe të gjitha udhëhiqen nga shqiptarët. Në të njëjtën mënyrë është formuar edhe komisioni për marrëdhëniet ndëretnike, e cila praktikisht nuk funksionon. Kryetari i komunës ka ingerenca të fuqishme në duart e veta dhe mund të merr vendime madje edhe pa Këshillin. Në rast se ndodh që shumica në këshill të jenë nga e njëjta parti, si edhe ai, atëherë këshilli është reduktuar në “asgjë” (mbretëreshë britanike”) respektivisht “makinë votimi”.

Komunat do të shndërrohen në “pashallëqe” të një njeriu ose të një grupi të ngushtë të “pushtetarëve” komunalë.

Kundërpesha e domosdoshme patjetër të instalohet në formulën “nëse kryetari i komunës është nga bashkësia etnike shumicë – kryetari i këshillit është nga njëra nga bashkësitë pakicë”. Mënyra e dytë e instalimit të sistemit “pengesa dhe baraspeshë” dhe balancë më e mirë etnike është zgjedhja e kryetarit të komunës. Kjo zgjedhje duhet sa është e mundur më shumë të varet nga votat e të gjithë votuesve në komunë. Kjo do të mund të arrihej, në rast se shkohet në koalicion parazgjedhor i cili do ta propozojë kryetarin e komunës dhe kryetarin e këshillit. Pritet se kjo do ta bëjë të matur sjelljen e partive politike të komuniteteve dhe do ta nxisë bashkëpunimin e tyre.

Ja disa deklaratat më karakteristike të të intervistuarve:

E drejta e Badenterit akoma është tabu për komunën tonë

Pushteti i kryetarit të komunës është tepër i madh dhe ai nuk do të kujdeset për të gjitha bashkësitë etnike; do të kujdeset në mënyrë selektive; Secili kryetar komune derisa të ulet në kolltuk është një njeri e më pas një tjetër; Është herët të thuhet nëse kryetari i komunës ka pushtet të mjaftueshëm apo të pamjaftueshëm, është me rëndësi se vallë ai i përmbahet

ligjit: nëse zbatohet ligji gjithçka do të jetë në rregull; Danocionet grumbullohen te strukturat e caktuara në vende të caktuara. Në mjedise të caktuara nuk funksionon inspektorati.

Për ne në Strugë është pa precedencë që ne si maqedonas në shtetin tonë të kërkojmë Badenter.

Siç ndodh zakonisht edhe në vende tjera, shumica konsideron se pakicave u jep shumë të drejta kurse pakica i konsideron të njëjtat si të drejta tepër të vogla, përfaqësuesit e shumicës shqiptare në komunë të cilët i intervistuaam konsiderojnë se mekanizma mbrojtëse, si e drejta e vetos nuk janë të domosdoshme: *"Marrëdhëniet ndëretnike në komunë janë të mira"*. Ata shtojnë se kjo mënyrë e vendimmarrjes e bën pushtetin lokal joefiaks dhe çështjet për të cilat vendoset me "shumicën e Badenterit" jo vetëm që nuk duhet të zgjerohen por duhet të ngushtohen.

Jo "Badenter", sepse paraqitet bllokadë në vendimmarrje;

Shqiptarët vlerësojnë se pushteti i kryetarit të komunës është optimal dhe se ai gjithsesi do të kujdeset njëllor për të gjitha bashkësitë etnike në komunë.

3. Përdorimi gjuhëve, flamujve, simboleve

Seancat e këshillit zhvillohen në gjuhë shqipe me përkthim në gjuhën maqedonase, por disa nga maqedonasit denoncojnë përkthimin e dobët për shkak të të cilit shfaqen mosmarrëveshjet.

Edhe në lidhje me këto rrethana, perceptcionet janë të ndryshme: *Gjuha maqedonase dhe ajo shqipe, si dy gjuhë zyrtare shfrytëzohen barabartë; Seancat udhëhiqen nga ana e Kryetarit të këshillit në gjuhën shqipe që është kundër ligjit.* Përdorimi i gjuhëve në shkollat është sipas ligjit, e për sa i përket emrave, mbishkrimeve, reklamave të personave juridikë, sipas shqiptarëve përdoret gjuha maqedonase, ndërsa sipas maqedonasve në praktikë ka shumë shmangie nga normat ligjore. Një pjesë e maqedonasve të intervistuar deklarojnë se kanë edhe probleme me administratën komunale në këtë plan. Deri më tani nuk ka pasur kërkesa për ndryshime të emrave të shkollave, institucioneve, rrugëve etj. Por në të ardhmen pritet një gjë e tillë.

KONKLUZION

Mund të konkludohet se në rrafshin ndëretnik gjendja në komunë është shumë sensible, që i referohet ndryshimeve të kufijve komunalë në vitin 2005. Ndjenja e padrejtësisë është e dukshme të komuniteti etnik maqedonas. Maqedonasit janë në gjendje të pritjes të pasojave negative nga ndryshimi i tillë me ç' rast frika nga ajo se do të jenë të diskriminuar dhe të braktisur në vetëdëshirën e pushtetit lokal, ku shteti nuk u ofron mbrojtje të mjaftueshme.

Bazuar në faktin se parimi i përfaqësimit të drejtë është në fillimin e vet, së do të pasojnë ndërrimet e emrave të rrugëve, shkollave, fshatrave etj. Ndjenja e tillë e pakënaqësisë do të mund të forcohej akoma më shumë, sidomos nëse paralelisht me këtë nuk ndërtohen masa të mirëbesimit dhe nëse nuk respektohet universaliteti i ligjeve, të cilat janë garancitë për respektimin e të drejtave dhe lirive individuale, por edhe të atyre kolektive dhe nëse organet e pushtetit qendror nuk janë efikase në funksionin e vet mbikëqyrës. Struga përfaqëson komunë ku mund të shihet nëse institucionet dhe procedurat për mbrojtje të pakicave funksionojnë në praktikë, a janë të mira dhe të arsyeshme dhe çka do të duhej të përmirësohet. Në këtë drejtim, vlen të mendohet për institucione dhe rregulla të cilat do ta

Ndarja e pushtetit

Model i ri për vendimmarje në komunat multikulturore

forcojnë sistemin e “pengesave dhe kundërpeshave” dhe sistemin e balancimit etnik, si hipotezë për forcimin e demokracisë dhe shtetit multi-etnik si: nëse është kryetari i komunës nga njëri nacionalitet, atëherë kryetari i komunës është nga nacionaliteti tjetër; nxitja e koalicioneve parazgjedhore multi-etnike koalicione të cilat prodhojnë maturi më të madhe që t’i fitojnë votat e shumicës së qytetarëve; zgjerim i parimit të vetos (“shumicë e dyfishtë” ose parimi i Badenterit) dhe të sferës së arsimit të bashkësive pakicë; zgjerimi i të drejtës së vetos së pakicës gjatë miratimit të Statutit, rregullores dhe buxhetit të komunës; përpunim dhe precizim i të drejtës së vetos së pakicës në ligjin për vetëqeverisje lokale, statuteve dhe rregulloreve të komunave; definimi dhe precizimi i kompetencave dhe mënyrës së zgjedhjes së komisionit për marrëdhënie ndëretnike; rishqyrtim se në cilat institucione dhe situata mund të aplikohet “përfaqësimi i drejtë i bashkësive pakicë”; zgjerim dhe forcimi kapacitetit të administratës komunale me zyrë (ose individ) të ngarkuar me çështjet e pakicave e kështu me radhë.

2.4. KOMUNA DIBËR

Të dhënat elementare për komunën

Komuna e Dibrës pas organizimit territorial të vitit 2005, ka 19.542 banorë dhe përbëhet prej një vendbanimi urban dhe 17 vendbanimeve rurale. Në qytet ka 4 bashkësi lokale. Struktura etnike e popullatës është si në vijim: maqedonas – 3.911; shqiptarë- 11.348; turq – 2.694; romë- 1080; vllleh- 2; serbë - 22, boshnjakë - 3 dhe të tjerë - 492.

Të punësuar në administratën komunale

Nëpunës shtetërorë 23; 10 me arsim të lartë, 11 me arsim të mesëm, 1 KL 1 arsim fillor. 28 shqiptarë. 2 maqedonas dhe 3 truq
Personeli teknik 7; 5 me arsim të mesëm dhe 2 me arsim fillor. 1 maqedonas, 1 rom 5 shqiptarë.

Struktura e administratës komunale

- Sektori për çështje juridike dhe të përgjithshme, buxhet, financa, zhvillim ekonomik lokal dhe bashkëpunim ndërkuftar
- sektori për urbanizëm, çështje dhe mbrojtje të mjedisit jetësor

Institucione dhe ndërmarrje publike

Në komunë punon ndërmarrja komunale publike *Standard* dhe ka 86 të punësuar. Arsimi: *fillor*: në komunë funksionojnë 3 shkolla fillore me 2.784 nxënës dhe një shkollë e mesme e gjimnazit me gjithsej 709 nxënës prej të cilëve 469 nxënës e ndjekin mësimin në gjuhë shqipe, ndërsa 240 në gjuhën maqedonase.

A. Koncepti i ri i vetëqeverisjes lokale

Në përgjithësi, koncepti i ri i vetëqeverisjes lokale vlerësohet si i mirë por theksohet mosefikasiteti i tij sepse shumë ngadalë zbatohet procesi i decentralizimit kurse shteti akoma e ka fjalën vendimtare, ndërsa siç theksojnë bashkëbiseduesit, decentralizimi fiskal shkon në dëm e jo në dobi të vetëqeverisjes lokale.

Decentralizimi ka filluar në shumë kushte të vështira. Komuna funksionon pa një ndërtesë të përbashkët administrative dhe për funksionim normal të aktiviteteve huazohen hapësira plotësuese për të cilat paguhet qira. Kjo kontribuon për mos aprovimin e sistemit njësportelësh dhe për momentin punonjësit janë në lëvizje të vazhdueshme prej njëres në ndërtesën tjetër.

Është pozitive se qytetarët mund të komunikojnë drejtpërsëdrejti me kryetarin e komunës dhe problemet mund të zgjidhen në mënyrë më efikase dhe më shpejtë. Por, problemet më të mëdha janë në disa sfera:

- Në sferën e arsimit janë shkurtuar 30% për mirëmbajtje rrjedhimore krahasuar me vitin e kaluar.
- Shërbimi zjarrfikës akoma nuk është marrë dhe ai mbulon 36.000 banorë dhe tre komuna: Mavrovë-Rostushë, Qendra Zhupë dhe Dibër, që paraqet një hapësirë e madhe dhe ka vetë 4 punonjës dhe dy automjete të vjetra. *Shteti thotë*, i thekson kryetari i komunës, *anëse keni nevojë për punësime, punësoni zjarrfikës të rinj. Deri në vitin 200, megjithatë obligim i shtetit është sigurimi i pagave të zjarrfikësve.*
- Së bashku me ndërmarrjen komunale ka borxh mbi 1.200.000, kurse vetë administrata mbi 750.000 euro që paratë e buxhet disavjeçar të komunës. *Disa*

borxhe janë bërë në bazë të ekspropriimit të tokës që nuk ishte obligim i komunës, siç theksoi kryetari i komunës.

Infrastruktura është zatetur në gjendje shumë të keqe. Vitin e kaluar është bërë një investim me vlerë 1.200.000 euro me atë që janë rindërtuar ambulanca, sistemi i ujëtjes së fushës së Dibrës, pullaz i ri i gjimnazit, kompjuterë ne dy shkolla të mesme, kanalizimi fekal 3 km, ujësjellës 5 km, kanalizim atmosferik 700 m, trotoare 6.000 m², rrugë 1 km, sipërfaqe të gjelbra 1.500m² dhe janë kthyer rreth 130.000 euro borxh.

Si edhe në komunat tjera të cilët ishin caku i këtij hulumtimi, u realizua anketë me qytetarët. Në pyetjen *Si i vlerësoni rezultatet e deritashme të pushtetit qendror?* Numri më i madh i të anketuarve i vlerësojnë kryesisht si të mira. Por, në rast se shihet distribuimi i përgjigjeve në bazë të përkatësisë etnike, mund të konkludohet se përqindja e një përgjigje të këtuillë dallon prej një bashkësie etnike në tjetrën. Në fakt, përgjigje kryesisht të mira kanë dhënë 22% e maqedonasve, 72% e shqiptarëve dhe 16% e bashkësive të tjera etnike. Edhe pse anketa u realizua në qershor të vitit 2006, megjithatë qytetarët patën mundësi të bëjnë ndonjëfarë analize dhe vlerësimi të punës së autoriteteve lokale, përfshirë këtu edhe kryetarin e komunës. Duke pasur parasysh zgjedhjen e drejtpërdrejtë të kryetarit të komunës dhe kompetencat ligjore të cilat i ka ky organ në nivel lokal, u parashtrua pyetja *Sa i plotësoi kryetari i komunës pritjet e juaja?* Në këtë pyetje pjesa më e madhe e të anketuarve japin përgjigjen *deri diku i plotësoi...* Megjithatë, nëse shikohet struktura etnike e të anketuarve, do të vërehet se shqiptarët thuajse dyfish në përqindje japin një përgjigje të këtuillë në krahasim me maqedonasit dhe bashkësitë e tjera etnike. Qytetarët theksojnë arsye të ndryshme se pse kryetari i komunës nuk i ka përmbushur pritjet e tyre. Prej përgjigjeve do të konkludohet se maqedonasit më së shumti gjejnë vëretje te kryetari se ai më shumë merret me punë personale/partiake në dëm të atyre komunale, shqiptarët kanë vëretje më së shumti për atë se kryetari i komunës nuk komunikon me qytetarët kurse pjesëtarët e komuniteteve tjera të cilat jetojnë në komunën e Dibrës, më së shumti i bëjnë vëretje kryetarit sepse ai ka dhënë më shumë premtime por pak ka bërë këtij viti. Është simptomatike se numri më i madh i të anketuarve asnjëherë nuk kanë kërkuar takim me kryetarin e komunës kurse kjo përqindje është më e lartë te pjesëtarët e komuniteti maqedonas (rreth 77%).

Ajo që i lidh të gjitha bashkësitë etnike është qëndrimi në lidhje me problemet themelore të komunës, respektivisht, me një përqindje të madhe të anketuarit nga të gjitha bashkësitë etnike përgjigjen se ato janë investimet e vogla dhe papunësia. Kur të anketuarit u lutën që të japin opinionin e tyre për atë se *Në cilën lëmi pushteti lokal ka arritur progres më të madh* ata konsiderojnë se është përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike, edhe pse nëse shihen përgjigjet në bazë të përkatësisë etnike të të anketuarve, mund të konkludohet se maqedonasit në përqindje më të madhe konsiderojnë se ajo është infrastruktura. Megjithatë, përshtypje e përgjithshme ndërmjet pjesëtarëve të të gjitha bashkësive etnike është se pjesërisht janë përmirësuar shërbimet të cilat ofrojnë autoritetet lokale, pas formimit të pushtetit të ri lokal. Për dallim të një baraspeshe të përafërt të përgjigjeve, ekziston dallim i madh në përgjigjet ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike rreth pyetjes *A mundeni ju personalisht si qytetar kur keni problem të shkoni në komunë dhe të kërkonti zgjidhje*, me ç'rast, pozitivisht janë përgjigjur 74% e shqiptarëve, 11% e maqedonasve dhe 20% nga bashkësitë tjera etnike.

Kur bëhet fjalë për rrezikimin e të drejtave të caktuara të qytetarëve, mund të konkludohet se, pa dallim të përkatësisë etnike, ata në përqindje më të madhe nuk ndjejnë rrezikim të së drejtës së pronës, të drjetë për punësim, të shprehjes së identitetit nacional, të drejtës për arsim dhe të drejtës për informim, kurse përafërsisht aq është edhe përqindja

e të anketuarve të cilët konsiderojnë se në komunën në të cilën jetojnë nuk u është cenuar siguria personale.

B. Aspektet socio-ekonomike të komunës

Para tranzicionit, aktive kanë qenë ndërmarrjet *Radika, Shpile, 8 Shtatori, Progres dhe Deplast* dhe në komunë ka pasur rreth 4.500 të punësuar kurse tani rreth 1.000 të punësuar të cilët marrin rrogë prej buxhetit, rreth 900 në sektorin ekonomik ndërsa janë regjistruar rreth 5.000 të papunësuar.

Si pengesë më e madhe për investim në qytet përmendet infrastruktura e keqe rrugore *Dibra është lënë si ndonjë fshat kurse rruga është e regjistruar si magjistrale dhe ndërkombëtare. Ai i cili dëshiron të investojë dëshiron të ketë infrastrukturë të mirë.* Komuna është e njohur për nga diaspora e shumtë por ajo nuk ka interes të madh të investojë në Dibër sepse biznes-interesi doemos gjithnjë të vihet përpara lokal-patriotizmit. Si potencial më i madh për komunën potencohet lidhja më e mirë infrastrukturore me Shqipërinë përmes hapjes së një kalimi të ri kufitar, sepse *nga ana tjetër ka treg me mbi 200.000 banorë dhe kjo si potencial duhet të shfrytëzohet.* Një nga bashkëbiseduesit, si problem kryesor ekonomik momental e potencon *Shfrytëzimin e resurseve natyrore të firmave të huaja (për shembull Knauf) dhe të pushtetit qendror (për shembull hidrocentralin Shpile).*

Komuna ka përgatitur Strategji për zhvillim ekonomik lokal deri në vitin 2015 dhe si prioritet kryesor janë:

- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- Zhvillimi i turizmit dhe
- Zhvillimi i bujqësisë

V. Marrëdhëniet ndëretnike në komunë

Bashkëbiseduesit e theksojnë faktin se marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Dibrës kanë qenë gjithmonë të mira dhe nuk ka pasur probleme më serioze. Bashkëbiseduesit pozitivisht e vlerësojnë Marrëveshjen e Ohrit, dhe potencojnë se ajo ngadalë implementohet ndërsa si arsye më të madhe, sipas shumicës së bashkëbiseduesve, është gjendja ekonomike në shtet.

Për përfaqësimin e drejtë, kryetari i komunës thekson me sa vijon: Gjatë caktimit të vendeve është shkuar proporcionalisht prej drejtorësh të shkollave, zëvendës drejtorësh e deri në përfaqësues të këshillave drejtues.

Në komunë nuk vendoset me ndihmën e shumicës së dyfishtë sepse nuk ka ardhur një çështje e këtillë në rend dite. Dëshironim të orientohemi drejt ekonomisë dhe infrastrukturës. Nëpërmjet të shoqërimit të ndërsjellë gjatë zgjidhjes së këtyre problemeve ngadalë do të hapen edhe çështjet tjera por ato do të zgjidhen pa paragjykim. Vendosëm që t'i zgjidhim këto çështje pas zgjedhjeve.

Në komisionin për marrëdhënie ndërmjet bashkësive ka 7 anëtarë nga të gjitha komunitetet dhe ajo akoma nuk funksionon.

Në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike dhe në kuadër të anketës e cila u realizua ndërmjet qytetarëve, në pyetje të ndryshme janë fituar përgjigje të ndryshme, varësisht nga përkatësia etnike e të anketuarve. Kështu, rreth 70% e shqiptarëve konsiderojnë se pozitën e bashkësisë së tyre etnike është përmirësuar pas zgjedhjeve lokale të vitit 2005, ndërsa përqindja më e madhe e maqedonasve dhe e pjesëtarëve të bashkësive tjera etnike konsiderojnë se ajo nuk ka ndryshuar. Të anketuarit nga të gjitha bashkësitë etnike në një

përçindje të lartë e ndajnë mendimin se nuk ka bashkësi etnike të diskriminuara në komunë. Pjesa më e madhe e pjesëtarëve të komuniteti shqiptar dhe të bashkësive tjera etnike konsiderojnë se në disa vitet e radhshme do të përmirësohen marrëdhëniet ndëretnike në komunë, ndërsa pjesëtarët e bashkësisë maqedonase konsiderojnë se ato do të mbeten të njëjta. Gjithashtu, frika nga përkeqësimi i marrëdhënieve ndëretnike është më e madhe në mesin e pjesëtarëve të bashkësisë maqedonase (rreth 11%). Gjithashtu, rreth gjysma e të anketuarve maqedonas nuk e shohin perspektivën e vet në komunën e Dibrës kurse rreth 2/3 e të anketuarve shqiptarë dhe të atyre të cilët i takojnë bashkësive tjera etnike perspektivën e vet e shohin në komunën. Kur bëhet fjalë për Marrëveshjen e Ohrit, rreth gjysma e të anketuarve të cilët i takojnë komunitetit maqedonas dhe bashkësive tjera etnike konsiderojnë se ai krijoi ndryshime pozitive kurse një qëndrim të këtuillë me 2/3 e përgjigjeve kanë edhe shqiptarët.

G. Ndarja e pushtetit dhe procesi i vendimarrjes

Këshilli është i përbërë prej BDI- 6 këshilltarë, PDSH- 4 këshilltarë, PPD- 1 këshilltar, PDK- 1 këshilltar, LSDM 1 këshilltar, VMRO DPMNE 2 – këshilltarë. Shumicën e ka BDI, PDK dhe LSDM. Nga seancat që janë vëzhguar, mund të përfundohet se janë plotësuar të gjitha kushtet formale për zhvillimin e seancës së Këshillit të komunës, janë shfrytëzuar gjuha maqedonase dhe shqipe kurse iniciativën për konvokim të seancës e ka dhënë kryesuesi i këshillit. Në mbledhjen e 6-të kanë marrë pjesë 11 nga gjithsej 15 këshilltarë kurse në seancën e 7-të, të gjithë këshilltarët. Në seancën e 6-të është diskutuar për Buxhetin e komunës kurse në seancën e 7-të është miratuar informata për punën e komisionit për siguri në trafikun rrugor, ka marrë vendim për regjimin e trafikut rrugor, është miratuar programi për NPK “Standard” për vitin 2006, me ç’ rast, të gjitha pikat e rendit të ditës janë miratuar. Konstatimi i vëzhguesve është se seancat kanë kaluar qetë. Kryetari i komunës ka qenë prezent në të gjitha seancat e këshillit dhe ka pasur vetëm bojkotim të pjesshëm të 2 seancave nga ana e PSH-së por nuk e kanë bojkotuar punën e grupeve punuese. *Në rast se nuk e dini se cili prej cilës parti është, nuk do të mund të hetoni asnjëfarë përkatësie partiake sepse punohet në mënyrë shumë konstruktive, i theksoi kryetari i komunës.*

Mbipunësim në administratën komunale. 17 punonjës në administratë ndërsa prej 1 korrikut prej Ministrisë për transport dhe lidhje, Ministrisë për financa, Ministrisë për arsim dhe shkencë dhe prej Fondit për rrugë lokale, numri i i të punësuarve u rrit në 33 kurse Qendra Zhupë nuk pranoi asnjë të punësuar edhe pse këta punonjës e mbulonin edhe këtë komunë. *Sipas standardeve të vednit tonë komuna ka 13 punonjës më shumë. Por, në komunën tonë kemi një situatë të këtuillë: disa thonë pranoni punonjësit e ministrive, të tjerët – punësoni të rinj që të respektoni përfaqësimin e drejtë, kurse të tretët thonë çlirohuni nga të punësuarit që të mundeni ato mjete t’i harxhoni më racionalist për qëllim e tjera.*

ANEKSAT

Lista e të anketuarve:

Dibër

PDSH: Anonim

PPD: Ferit Vojnika

Arsim: Nuri Koleci

PDK: Rexhep Qormemeti

Kryetar i këshillit të Komunës së Dibrës: Nizamedin Papraniku

Kërçovë:

BDI: Zylbie Bekteshi

Kandidat i pavarur: Lupce Petkoski – Secerko

TDP: Bedrudin Telak

Kulturë: Marjan Dimoski- Këshilltarë për çështje juridik

SDSM: Vlado Aleksoski

VMRO DPMNE: Elena Poposka

Sekretar i Komunës: Nuhi Jusufi

VMRO NP: Maja Lazareska

Strugë

Sekretar i Komunës: Zoran Gulicoski

Kulturë: Xhemi Hajredini – Udhëheqës Reparti për veprimtari të përgjithshme

Kryetar i Këshillit: Sejfula Hani –

VMRO DPMNE: Kërste Milladinov

LDP: Simon Aleksieski

SDSM: Goran Poposki

VMRO Narodna: Mitre Angjelkoski

Gostivar

Nevzat Bejta – Kryetar komune

Muamer Sadiku – Kryetar i këshillit

Selim Ademi – Sekretar i Komunë

Nexhati Jakupi - BDI

Ismet Beqiri - sovetnik PPD

Muzafer Shabani – PDSH

Darko Dimitrieski - VMRO DPMNE

Valentina Poposka - SDSM

Natasha Sazdoska - VMRO NP

Erxhan Çulezi – TDP

PJESËMARRËSIT NË FOKUS GRUPE

Lista e pjesëmarrësve nga komuna e Gostivarit e fokus grupit të realizuar nga ana e Qendrës për paqe dhe demokraci – IAN Kolins

Nr	Emri e mbiemri	Organizata / Adresa
1	Marijana Veliçkoska	Shoqata e qytetarëve: Qendra e gruas-Gostivar
2	Borjanka Stojkoska	
3	Shukri Toçi	Qendra evropiane për çështje të pakicave
4	Lair Ismaili	ShHBR „Meseçina“ – Gostivar
5	Eroll Beqiri	Shoqata “Milenium”
6	Safet Selemani	OH Nëna Terezë – dega në Gostivar
7	Xheladin Ibraimi	El Hilal – dega në Gostivar
8	Magbule Vreskala	Lidhja e gruas shqiptare në Maqedoni
9	Lazime Ejupi	
10	Bulent Kamberi	IPG-Inter Etnik Program-Gostivar
11	Jetmir Bajrami	PPC – Qendra për permakultura
12	Ebru Kukuq	OGTM
13	Arzu Kain	OGTM
14	Luzim Haziri	ADI
15	Aleksandra Josifovska	CGI

Lista e pjesëmarrësve nga komuna e Gostivarit

Lista e pjesëmarrësve nga komuna e Kërçovës e fokus grupit të realizuar nga ana e Qendrës për paqe dhe demokraci – IAN Kolins

Br	Emri e mbiemri	Organizata / Adresa
1	Irina Stojanoska	Shoqata e gruas shqiptare, Kërçovë
2	Luljeta Ajrullai	
3	Svetlana Veljanovska	Radio Kërçova
4	Lindita Vrangaloska	Aktivi i grave rome „Prerodba“ – Kërçovë
5	Zejnepa Mamudoska	Aktivi i grave rome „Prerodba“ – Kërçovë
6	Anjur Seloski	Shoqata për trajnime dhe zhvillim të qëndrueshëm - ORT
7	Senad Ibraimoski	
8	Enis Idrizov	Organizata e rinisë rome “Bela Kula”
9	Senad Mustafoski	
10	Zenel Zulfeari	Shoqata e personave të verbër të qytetit të Kërçovës
11	Mirushe Tahiri	Shoqata e personave të verbër të qytetit të Kërçovës
12	Maja Lazareska	Anëtar i këshillit të komunës
13	Leonora Iliovska	Anëtar i këshillit të komunës
14	Aleksandar Çiplakovski	Anëtar i këshillit të komunës
15	Biljana Menoska	Televizioni Boem
16	Ratka Trpeska	EJL
17	Beleska Aleksandra	EJL
18	Sandra Stojanovska	EJL
19	Donka Tiposka	EJL
20	Misajlovska Angelina	EJL

Lista e pjesëmarrësve nga komuna e Dibrës e fokus grupit të realizuar nga ana e Qendrës për paqe dhe demokratiç– IAN Kolins

Br	Emri e mbiemri	Organizata / Adresa
1	Sonja Petrushevska	Evromakedonija
2	Lidija Petrushevska	
3	Katica Apostolovska	ADI
4	Ilir Ostreni	Këshilltar, komuna Dibër
5	Nizamedin Papraniku	Këshilltar, komuna Dibër
6	Filip Vasilevski	Këshilltar, komuna Dibër
7	Ismet Sadiku	Këshilltar, komuna Gostivar
8	Muarem Sadiku	Këshilltar, komuna Gostivar
9	Xumali Neziri	Këshilltar, komuna Gostivar
10	Atli Dema	MTV
11	Shaban Dalipi	MTV

PERSONA ME TË CILËT JANË REALIZUAR INTERVISTA NGA ANA E GRUPIT TË EKSPERTËVE TË QENDRËS PËR PAQE DHE DEMOKRACI “IAN KOLINS”

Zydi Xhelili – deputet në Parlamentin e IJRM- së nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike Shqiptare

Ismet Ramadani - deputet në Parlamentin e IJRM-së nga grupi parlamentar i Partisë për Prosperitet Demokratik

Ejup Rustemi - deputet në Parlamentin e IJRM-së nga grupi parlamentar i Bashkimit Demokratik për Integrim dhe Kryetar i Komitetit për marrëdhënie mes bashkësive pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë

Cvetanka Ivanova - deputete në Parlamentin e IJRM-së nga grupi parlamentar i Lidhjes Socialdemokrate dhe Kryetare e komisionit ligjor-juridik pranë Kuvendit të IJRM-së

Ilija Kitanovski - deputet në Parlamentin e IJRM-së nga grupi parlamentar i VMRO-DPMNE

Silvana Boneva - deputete në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë nga grupi parlamentar i VMRO-DPMNE

Kenan Hasipi - deputet në Parlamentin e IJRM-së nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Turqve

Nevzat Bejta – kryetar i komunës së Gostivarit

Argëtim Fida - kryetar i komunës së Dibrës

Eli Çakar – këshilltar shtetëror në Ministrinë e pushtetit lokal

Simon Aleksievski - këshilltar në Këshillin e komunës së Strugës nga grupi i këshilltarëve të Partisë Liberal-demokrate

Ilija Maceski - këshilltar në Këshillin e komunës së Strugës nga grupi i këshilltarëve të LSDM-së

Ndarja e pushtetit

Model i ri për vendimmarje në komunat multikulturore

PERSONA ME TË CILËT JANË REALIZUAR INTERVISTA NGA ANA E MONITOREVE TË ADI – GOSTIVAR

Komuna Dibër

Partia për Prosperitet Demokratik - Ferit Vojnika

Përgjegjës për arsim në Komunën Dibër - Nuri Koleci

Partia Demokratike Kombëtare - Rexhep Qormemeti

Kryetar i Këshillit të Komunës Dibër - Nizamedin Papraniku

Komuna Kërçovë

Bashkimi Demokratik për Integrim - Zulbie Bekteshi

Këshilltar i pavarur - Lupçe Petkovski

Partia Demokratike e Turqve - Bedrudin Telak

Këshilltari për çështje juridike - Marjan Dimovski

Lidhja Social Demokrate - Vlado Aleksovski

VMRO-DPMNE - Elena Poposka

Sekretari i Komunës - Maja Lazareska

Komuna Strugë

Sekretari i Komunës - Zoran Gulicoski

Udhëheqës i Sektorit për veprimtari publike - Xhemi Hajredini

Kryesues i Këshillit të Komunës Strugë - Sejfulla Hani

VMRO-DPMNE - Kërste Milladinov

Partia Liberal-Demokrate - Simon Aleksieski

Lidhja Social – Demokrate - Goran Poposki

VMRO Popullore - Mitre Angjelkoski

Komuna Gostivar

Kryesues i Këshillit - Muhamerr Sadiku

Sekretari i Komunës - Selim Ademi

Bashkimi Demokratik për Integrim - Nexhadi Jakupi

Partia për Prosperitet Demokratik - Ismet Beqiri

Partia Demokratike Shqiptare - Muzafer Shabani

VMRO-DPMNE - Darko Dimitrievski

LSDM - Valentina Poposka

VMRO – PP - Natasha Sazdoska

PDT - Erxhan Çulezi

REZIME

- 1) “Ndarja e pushtetit” është koncept i cili përdoret që të shënojë sistem demokratik politik, por të ndryshëm nga demokracia, e cila kryesisht praktikohet në shoqëritë (më)homogjene etnike. Për dallim nga demokracia e shumicës e njohur për nga parimi themelor zgjedhor ”fitimtari merr gjithçka”, “ndarja e pushtetit”, siç thotë vetë termi është sistem politik i cili funksionon në bazë të marrëveshjes paraprake për ndarje të pushtetit ndërmjet elitave politike të bashkësive etnike në një shtet dhe mund të përdoret si sinonim për “demokraci konsocionale” ose “demokraci me marrëveshje”, në kontekst të asaj që këto koncepte i përdor A.Liphart.⁴⁵ Në teorinë politike konsiderohet se shoqëritë plurale janë viktima potenciale të konfliktit ndëretnik . Ato janë shoqëritë në të cilat dominojnë ndarje më të thella përgjatë linjave etnike (prejardhje etnike, gjuhë, kulturë dhe religjion) ndërsa ndarjet tjera, për shembull, partiake, ideologjike, sindikale, qytetare etj. nuk i presin ndarjet etnike, duke u mundësuar kohezion më të madh shoqëror, por kryesisht i përcjellin. Në këto shoqëri do të zvogëlohet rreziku nga konflikti etnik, nëse pushteti nuk i neglizhon ose diskriminon pakicat e veta. Siç shkruan V.Zartman, “konfliktet e brendshme janë aq të ndryshme, në raste të ndryshme, por të gjitha problemet mund të përmblihen në dy kategori – neglizhencë dhe diskriminim, ose problem i distribuimit dhe problem i identitetit”⁴⁶ . Ky gjeneralizim, në masë të madhe mund të zbatohet edhe në shtetin tonë, në të cilin ndarjet përgjatë linjave etnike, në këtë moment akoma duken shumë të fuqishme, në krahasim me ato të cilat i presin nëpër to. Shkurtimisht, modeli i pastër teorik “ndarja e pushtetit” (diku përdoret koncepti “demokracia participative”) përmban disa parime themelore dhe institucione siç janë: (1) koalicioni i madh në pushtet; (2) shkallë të ndryshme të autonomisë territoriale; (3) përfaqësim i drejtë ose proporcional i pakicave në organet e pushtetit (administrata, ushtria dhe policia); (4) e drejta e pakicës në veto; (5)sistemi proporcional zgjedhor (5) kushtetuta e shkruar. Nga ky model, ekzistojnë devijime më të mëdha ose më të vogla varësisht nga situatat konkrete, por “demokracia konsocionale” është përgjigja paraprake ndërmjet elitave të bashkësive etnike rreth ndarjes së pushtetit dhe “rregullave të tjera të lojës”, ndaj të cilave është e domosdoshme që të gjithë t’u përmbahemi. Vetë modeli ka ithtarë por edhe kritizër të ashpër, të cilët ngritin shumë dilema, ndërmjet të cilave më serioze është ajo nëse elitat janë të sinqertë në qëllimin që ta ruajnë unitetin e shtetit dhe bashkëjetesës. Megjithatë, më e rëndësishme është që të kuptohet se sistemi i “ndarjes së pushtetit” zakonisht vendoset ose imponohet në situata paskonfliktuoze, si kornizë për ndërtim të paqes, stabilitetit dhe mirëbesimit ndërmjet grupeve të cilat në një moment të dhënë janë gjetur në konflikt.
- 2) Vendi ynë, pas përfundimit të konfliktit të armatosur në vitin 2001 dhe arritjen e Marrëveshjes Paqësore të Ohrit, fitoi kornizë politike, e cila i përmban të gjitha institucionet më të rëndësishme të të a.q. demokraci konsocionale dhe/ose “ndarja e pushtetit”. Akoma më e rëndësishme është ajo se Marrëveshja është nënshkruar nga partitë më të mëdha parlamentare në vend, kurse implementimi i saj është i garantuar nga ana e “bashkësisë ndërkombëtare”(BE, SHBA, NATO)

⁴⁵ Arend Lijphart: “**Democracy in Plural Societies**”, Yale University Press

⁴⁶ William Zartman, ed. “**Elusive peace: negociatat dhe fundi i luftës qytetare**”, Brookings Institution

- 3) Që të dekurajohet politika sipas së cilës zgjidhje më e mirë për konfliktet etnike është ndarja territoriale, vendi ynë është shtet unitar. Në zgjidhjet tjera të Marrëveshjes së Ohrit, mund të identifikohen institucionet dhe parimet kyçe të modelit konsocional: (1) qeveritë prej viti 1991 janë koalicionet, në të cilat rol të rëndësishëm luajnë partitë politike të shqiptarëve. Këto nuk janë “koalicionet e mëdha në pushtet”, në kuptim në të cilin këtë term e përdor A.Liphart (përveç gjatë kohës së konfliktit të armatosur të vitit 2001, kur kishim “koalicionin vërtet të madh”, të përbërë prej partive më të mëdha parlamentare të bashkësive etnike në shtet), por megjithatë kontribuonin për legjitimitet më të madh të pushtetit; (2) përfshirje të drejtë të bashkësive në shtet, ashtu edhe në komunat ku ekzistojnë pakica (ushtri, polici dhe administratë publike); (3) vetoja e pakicës ose “shumica e dyfishtë” (e njohur në popull si shumica e Badenterit); (4) sistemi zgjedhor proporcional (5) shkalla e lartë e decentralizimit të pushtetit dhe (6) kushtetutë e shkruar ku janë të garantuara të drejtat individuale dhe kolektive të pakicave. Të gjitha këto parime dhe instrumente politike janë pjesë e planit paqësor për arritjen e stabilitetit më të madh dhe sigurisë në vend dhe pikërisht për atë shkak është e rëndësishme që universitetet, organizatat shkencore dhe joqeveritare si dhe institucionet e shtetit, ta përcjellin zbatimin e tyre, vazhdimisht të tërheqin vëmendjen për problemet gjatë zbatimit dhe të kërkojnë dhe iniciojnë debat për këto çështje dhe gjetjen e zgjidhjeve më të mira.
- 4) **“Nuk ka zgjidhje territoriale për konfliktet etnike”**: Marrëveshja Paqësore e Ohrit fillon me këtë mesazh të fuqishëm, drejtuar të gjithë qytetarëve të vendit tonë. Mirëpo, mesazhi ka kuptim vetëm nëse në mënyrë efektive janë mbrojtur të drejtat e pakicave në shtet dhe në komunat. *Me këtë rast është me rëndësi të theksohet dhe të afirmohet se këto të drejta janë komplementare me parimin fundamental të mosdiskriminimit.* Pakënaqësia më e madhe, të cilën e regjistruam gjatë hulumtimit vjen nga ndjenja e padrejtësisë, jodinjitetit dhe diskriminimit. Thuhet aspak nuk është e rëndësishme se vallë dikujt i janë cenuar të drejtat për diçka të rëndësishme ose për ndonjë procedurë, në shikim të parë, të parëndësishme e cila është kërcyer, sepse thyhet mirëbesimi ndërmjet bashkësive etnike.
- 5) Aspekt kyç i mirëbesimit modern të të drejtave të pakicave është parimi i participimit të pakicave në procesin e vendimarrjes *për çështje të cilat drejtpërdrejt i shqetësojnë* si në nivel nacional ashtu edhe në atë lokal. „Participimi i plotë dhe efektiv“ si e drejtë e formuluar në Konventën Kornizë për mbrojtjen e të drejtave të pakicave (neni 15) ka të bëjë me pjesëmarrjen e pakicave në procesin e formulimit të politikës së shtetit ose komunës dhe pjesëmarrja në marrjen e vendimeve që *ata i shqetësojnë*. Në konferencën e mbajtur në Strazbur, me rastin e pesëvjetorit të miratimit të kësaj Konvente, në interpretimin e nenit 15 komentohet se „participimi i plotë dhe efikas“ nënkupton jo vetëm pjesëmarrje të pakicave në marrjen e vendimeve politike të cilat i shqetësojnë ata, por edhe në ato ekonomike. Shkurtimisht konsiderohet se duhet që merret parasysh pozita e përgjithshme socio-ekonomike e pakicave.⁴⁷

⁴⁷ “Filling the Frame, Five years of monitoring the Framework Convention of the protection of National Minorities”, Council of Europe Publishing

- 6) E drejta e „participimit të plotë dhe efikas“ është aspekti më i rëndësishëm i modelit të „ndarjes së pushtetit“ në komunat multietnike në venditn tonë.⁴⁸ Qëllimi i hulumtimit tonë ishte që të shohim se si në praktikë është zgjedhur mostër e komunave multietnike në të cilat funksionojnë aspektet më të rëndësishme të „ndarjes së pushtetit“: (1) „participimi i plotë dhe efikas“ i pakicave në formulimin e politikës së komunave dhe participimi i tyre në vendimmarrjen në Këshillin e komunës; (2) e drejta e vetos ose marrja e vendimeve me „ shumicë të dyfishtë“ (3) përfaqësimi i drejtë i pakicave në administratën e komunës dhe (4) përdorimin e gjuhës dhe simboleve të pakicave në komunat, si komponentë e rëndësishme e aftësisë së tyre për participim të plotë dhe efektiv. Çka konkluduar?⁴⁹
- 7) Pakica më të rrezikuara, posaçërisht për nga aspekti „participimi i plotë dhe efikas në vendimmarrje“ janë pakica turke dhe ajo rome. Statusi i „pakicave shumë të vogla dhe të disperzuara“ u pamundëson peshë më të madhe politike në qendrat e vendimmarrjes si në shtet, ashtu edhe në komunat e sipërpërmendura të mostrës sonë. Vetoja e pakicës (e a.q. shumica e Badenterit) për këto bashkësi nuk ka domethënie, sepse në grupin e deputetëve në Kuvendin e IRJM-së, të cilët votojnë si „ shumicë e veçantë“, shqiptarët kanë shumicë për të marrë vendime, nuk u nevojiten votat e përfaqësuesve të bashkësive tjera pakicë. Kjo është arsyeja që një nga përfaqësuesit e intervistuar të bashkësisë turke në Kuvend, në mënyrë të rezignuar deklaroi: „Vendi ynë u bë shtet binacional“. Në komunat e hulumtuara, ndikimi i kësaj bashkësie në procesin e vendimmarrjes është gjithashtu shumë i vogël, veçanërisht për arsye se disa komuna tradicionale me shumicë turke, i janë bashkëngjitur komunave tjera (Xhepçisht, për shembull).
- 8) Sa i përket gjendjes së vështirë ekonomike dhe sociale të romëve, kjo pjesërisht i referohet pozitës së tyre marginale në qendrat në pushtet, si në shtet ashtu edhe në komunat, me përjashtim të komunës Shuto Orizarë. Në këtë kontekst, propozojmë që të hapet debat politik dhe profesional për përmirësimin e pozitës së këtyre bashkësive, përfshirë këtu edhe propozimet për „ulëse të rezervuara në Kuvendin e IRJM-së (Vendi ynë si një njësi zgjedhore për bashkësinë turke dhe rome), suprimim të pragjeve zgjedhore për pakicat shumë të vogla (e a.q. „saving clause“); miratimi i programeve nacionale për mbrojtjen e tyre, arsimim dhe zhvillim ekonomik; aprovimi i zyrave për të drejtat e pakicave në shtet dhe komuna; përbërje pariteti të Komitetit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive në Kuvendin e IRJM-së; përbërje pariteti të Komisioneve komunale për marrëdhënie ndërnacionale etj.
- Edhe pse në shtet bëhen përpjekje për t’u përmirësuar pozita e romëve, megjithatë duhet pasur parasysh edhe disa përvoja nga shtete tjera të cilat aprovuan:

⁴⁸ Është zgjedhur mostër prej katër komunash, Gostivar, Kërçovë, Dibër dhe Strugë, ku jetojnë përfaqësues të nacionalitetit maqedonas, shqiptar, turk dhe rom. Në komunat Gostivar, Strugë dhe Dibër shumicën e përbëjnë shqiptarët, por ekziston edhe komuniteti i konsiderueshëm turk, ndërsa maqedonasit janë shumicë në Kërçovë. Romët janë të përfaqësuar në numër më të vogël në këto. Treguesit e saktë mund të gjenden në Raportin

⁴⁹ Hulumtimi në terren zhvillohej prej drejtorit 2005 deri në maj 2006, me zbatimin e metodave në vijim: vëzhgim i drejtpërdrejtë i seancave të Këshillave të komunave nga mostra; b) mbledhja e treguesve objektiv; v) intervista dhe g) anketë me 600 të anketuar e realizuar nga agjencia profesionale për hulumtimin e opinionit publik“ Brima-Galup”.

- Zyra speciale që merren me çështje të pakicave dhe të cilat mundën të zhvillojnë politikë koherente në këtë lëmi;
 - Ministër i cili është emëruar që të merret ekskluzivisht me këtë çështje;
 - Komisar Special i Kryetarit, si institucion i instaluar për të ngritur çështjen e pakicave në nivel më të lartë;
 - Emërimi i funksionarëve në Ministrinë e vetëqeverisjes lokale të cilët merren me të drejtat e pakicave nëpër komuna;
 - Këshill nacional konsultativ i cili mund të funksionojë në nivel nacional por edhe regjional ose komunal dhe i cili do ta lehtësonte komunikimin ndërmjet pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv pas një sere të këtyre çështjeve etj.
- 9) Institucioni Avokat Popullor e arsyetoi ekzistimin e vet. Propozojmë që edhe më tutje këtij institucioni t'i jepet përkrahje dhe afirmim i gjerë shoqëror. Në ingerencat e Avokatit popullor, krahas „përfaqësimit të drejtë të komuniteteve”, si e drejtë kolektive, duhet të numërohet edhe përcjellja dhe përkujdesja e të drejtave tjera kolektive të pakicave siç janë përdorimi i gjuhëve dhe simboleve, e drejta e vetos së pakicës, e drejta për arsimim në gjuhën amtare etj.
- 10) Hulumtimi ynë tregoi se në periudhën e monitoruar (dhjetor 2005 - qershor 2006) në komunat e mostrës, shumë pak janë shfrytëzuar format e demokracisë së tërthortë ose të drejtpërdrejtë, si referendume, iniciativa, iniciativa të bashkësive vendore etj. që paraqet “deficit” të madh demokratik i cili drejtpërsëdrejti ndikon mbi mundësinë për participim më të madh të komuniteteve pakicë. Propozojmë, programeve të organizatave joqeveritare (qytetare) t'u kushtohet vëmendja e nevojshme për këtë konstatim, posaçërisht për shkak se për nga natyra e punëve, këto organizata ekzistojnë ndërmjet tjerash që ta forcojnë ndikimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve mbi vendimet e pushtetit.
- 11) Hulumtimi tregoi se Këshillat e komunave, vetëm pjesërisht i kënaqin standardet për vendimarrje demokratike. Forma është respektuar dhe këshilltarët informohen për mbledhjen, relativisht në kohë. Megjithatë, disa këshilltarë bënë konstatuan se propozim vendimet për çështje të rëndësishme, nuk janë seriozisht të justifikuar dhe argumentuara, sepse është siguruar shumicë. Në qoftë se edhe kryetari është nga e njëjta parti, si edhe shumica e Këshillit, për një afat të shkurtë arrihet efikasitet i pushtetit komunal, por për një afat të gjatë rritet pakënaqësia, sepse fuqia “derdhet” jashtë Këshillit dhe ai më në fund shndërrohet në „makinë votimi”. Në një situatë të këtillë, shumë ngushtohet mundësia për participim efikas të anëtarëve të këshillit nga radhët e pakicave, ashtu që në disa raste orientohen drejt metodave, si bojkot ose braktisje e seancave, që çon drejt përkeqësimit të mirëbesimit ndërmjet pakicave.
- 12) Gjuha në të cilën zhvillohen seancat, mund ta vështirësojnë punën e Këshillit të komunës, madje edhe të bëhet mjet për manipulim. Duke qenë se pajisja për përkthim simultan është e shtrenjtë, ajo deri më tani akoma nuk është e siguruar nëpër komunat e mostrës sonë. Kjo, këshilltarët të cilët e flasin gjuhën e pakicës, i vë në një pozitë të palakmueshme të vëzhguesve dhe e zvogëlon motivimin e tyre për “participim të plotë dhe efikas” në punën e Këshillit të komunës dhe në disa raste, ata vetë tërhiqen nga pjesëmarrja aktive në punën e Këshillit të komunës.

- 13) Gjatë hulumtimit disamujor, konstatuam se vetëm në dy raste vendimet është dashur të merren me „shumicë të posaçme”. Vendimi për futjen e gjuhës turke në punën e Këshillit të komunës në Gostivar, është marrë njëri, si rezultat i i marrëveshjes paraprake ndërmjet BDI-së dhe PDT-së. Vendim tjetër për ndërtimin e përmendores së pjesëtarit të UÇK-së në Strugë, është marrë pa aplikimin e „shumicës së posaçme”. Gjegjësisht, për këtë vendim nuk kanë votuar këshilltarët maqedonas, por vendimi ka filluar të realizohet, gjë që shkaktoi rritjen e pakënaqësisë së maqedonasve në Strugë, kështu që në shtyp u paraqitën informata se do të organizohet referendum për shkarkimin e kryetarit të komunës. Sot është e qartë se koalicioni i atëhershëm në pushtet (LSDM-BDI) qëllimisht ka hezituuar të iniciojë para Këshillit të komunës çështje të cilat eventualisht do të mund të dilnin jashtë kontrolli dhe të krijojnë situatë konfliktuozë.
- 14) Në rast se në komunë, për çfarëdo arsye e posaçërisht nëse do që ta kontestojë legjitimitetin e shtetit, i bëhet obstrukcion të drejtës së vetos së pakicës për çështje të caktuara (kulturë, gjuhë, simbole), pakica nga ana e vet, do të reagojë ashtu që do të kërkojë zgjerim të kësaj të drejte mbi të gjitha vendimet. Kjo është një hyrje e sigurt në krizë dhe vendi ynë në këtë moment e ndjen.
- 15) Hulumtimi, gjithashtu tregoi se këshilltarët shumë pak e dinë se kur, si dhe pse zbatohet kjo „e drejtë e dyfishtë” (ose e drejta për të drejtën e pakicës) dhe se është e nevojshme që të afirmohet ky institucion, i cili në parim duhet ta mbrojë pakicën nga majorizimi.
- 16) **Normativet problematike ligjore:** Në raste të caktuara, zbatimi informativitet ligjor të nenit 41 pika 3 nga LVL mund të jetë problematike. Gjegjësisht, kërkohet “shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Këshillit të cilët u takojnë komuniteteve të cilat nuk janë popullatë shumicë në komunat”. Çka do të thotë kjo praktikisht? Në komuna të caktuara, ku në këshill ka 4-5 anëtarë të komuniteteve pakicë, kjo do të thotë se duhet prej tyre të jenë të pranishëm tre vota, respektivisht vendimi të merret me 2 vota nga komunitetet pakicë. Nëse përkundër kësaj kihet parasysh ajo se shumica e këshilltarëve, si dhe kryetari i komunës, i cili gjithashtu (parimisht) i takon komunitetit shumicë, është evidente se (të paktët në numër) pjesëtarët e bashkësive pakicë do të jenë nën *presion të madh*. (Ky konstatim nuk i referohet vetëm zbatimit të të a.q. e drejtë e Badenterit, por në përgjithësi vendimarrjes në Këshill, në rastet kur bashkësitë pakicë janë të përfaqësuar me një numër më të vogël të këshilltarëve). Në këto raste, propozojmë që të kërkohet shumica nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve (shumica absolute) dhe me këtë rast Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive të shihet si një nga zgjidhjet për tejkalimin e këtij disbalanci të fuqive në Këshill.
- 17) **Vetoja e pakicave: të ngushtohet ose të zgjerohet?** Hulumtimi vuri në dukje se participimi efektiv i bashkësive pakicë në vendosjen e qëllimeve të politikës së komunave dhe vendosjes vihet në pyetje me zbatim shumë restriktiv të vetos së pakicës, vetëm në lidhje me çështjet e kulturë, stemës, flamurit dhe gjuhës. Qëllimet e politikës së komunës formulohen në Programin e saj dhe mbështeten me financa nga buxheti. Për këto arsye propozojmë që për çështjet të cilat i shqetësojnë pakicat kurse gjenden në Statutin, Programin dhe Buxhetin e komunës të sillen me “shumicë të dyfishtë”.

18) **Arsimi dhe vetoja e pakicës:** *Participimi i plotë dhe efektiv, gjithashtu nuk mund të realizohet pa të drejtën e vetos së pakicës mbi vendimet nga sfera e arsimit e cila i shqetëson pakicat.* Kjo e drejtë ekziston në nivel shtetëror ku deri më tani zhvillohej politika arsimore. Tani kjo situatë ndryshon dhe autoritetet komunale do t'i sjellin vendimet më të rëndësishme nga lëmi i arsimit të qytetarëve të saj. Sipas kësaj, propozim, “shumica e dyfishtë” të zgjerohet mbi çështjet nga arsimi që i shqetësojnë pakicat. Kategoria “që i shqetësojnë”, do të ishte e justifikuar.

19) **Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive: ndërmjet normativit dhe praktikës**

Zgjidhjet ligjore për formimin e këtij Komisioni (neni 55 i Ligjit për vetëqeverisje lokale) janë të palogjikshme dhe kundërtënëse dhe propozojmë që të ndryshohen. Në statutet e komunave, baza për zgjedhje të anëtarëve të këtij Komisioni është tepër e ngushtë dhe nën ndikim të fuqishëm partiak. Propozojmë të fitohet përbërje e Komisionit, e cila do të dilte nga kornizat e ngushta partiake/politike, të cilat jo gjithmonë dhe jo ekskluzivisht i shprehin interesat e qytetarëve në komunitetin vendor. Sa i përket praktikës, në të katër komunat e mostrës sonë këto Komisione kanë mbetur vetëm në seancat konstitutive, nuk kanë mbajtur asnjë mbledhje. Pse? Morëm përgjigje se për këtë nuk ka pasur nevojë. Fitohet përshtypja se, shumicës së bashkëbiseduesve tonë nuk u është e qartë se ky Komision a duhet të ekzistojë dhe nëse ekziston si do të funksionojë, respektivisht a nuk do të jetë vetëm burim i konfrontimeve dhe problemeve të reja. Kjo kërkon përcjellje të punës, ndihmë dhe mbështetje të këtij Komisioni.

Komisioni, as ligjërisht, as statutarisht nuk është vendosur si organ i rëndësishëm i cili do t'i zbusë konfrontimet eventuale rreth këtyre çështjeve për të cilat vendoset me veto të pakicës. Duke pasur parasysh faktin se nëpër komuna ani do të zhvillohen proceset e ndryshimit të simboleve, emrave të rrugëve, shkollave, fshatrave etj, se komunat ani do të duhet ta zbatojnë parimin e përfaqësimit të drejtë, dhe përfundimisht, se procesi i decentralizimit do të thellohet duke forcuar pozitën dhe fuqinë e autoriteteve lokale në administrimin me komunat, mund të pritet që marrëdhëniet ndëretnike të bëhen gjithnjë e më të ndjeshme para sprovave të reja. Për këto shkaqe, në publik, Kuvend dhe BNjLV duhet t'i kushtohet vëmendje serioze dispozitave ligjore dhe statutare për formim të këtij komisioni si dhe praktika e deritanishme.

20) **Roli i Komisionit:** Roli i Komisionit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive do të fitojë rëndësi në rast se plotësohen disa kushte:

- kandidimi dhe zgjedhja e anëtarëve të jetë e vendosur në bazë të gjerë (të del nga kornizat e ngushta të Këshillit dhe partive politike: të involvohen edhe OJQ-të, publiku, mediat etj.)
- të vendosë me konsensus
- të përbëhet prej numrit të njëjtë të anëtarëve nga të gjitha komunitetet, me ç'rast kryetari të mos jetë nga bashkësia shumicë në komunë
- ingerencat të jenë qartë të përcaktuara, por edhe më gjerë se neni 41 i LVL (respektivisht të ketë të drejtë të debatojë dhe të sjell konkluzione edhe për probleme të caktuara në komunë: do me thënë të tërheq vërejtjen, e jo vetëm të merr qëndrim për një çështje e cila është në rend dite të seancës së këshillit, e për

të cilën parashihet shumicë e dyfishtë; të luajë rol të këshilldhënësit të kryetarit të komunës në lidhje me këto çështje)

- Këshilli dhe kryetari i komunës të kenë për obligim që t'i shqyrtojnë dhe të prononcohen për to, por edhe me shkrim t'i arsyetojnë se pse nuk pajtohen me konkluzionet e Komisionit

- 21) Kryetari i komunës:** Komponenta më e fuqishme e demokracisë konsocionale “ndarja e pushtetit ekzekutiv”. Kjo nëpër komuna mungon, sepse kryetarin e komunës drejtpërsëdrejti e zgjedhin qytetarët dhe ata dëshirojnë që ai të jetë nga komuniteti shumicë. Përjashtimi i pakicave nga pushteti ekzekutiv është i legalizuar dhe tani duhet të mendohet se si të vendoset baraspesha ndëretnike. Propozojmë, kryetari i Këshillit t'i takojë ndonjërit nga komunitetet pakicë, që tani nuk është rast. Me këtë rast propozojmë që të hapet debat për ndryshime në ligjvënien zgjedhore gjë që do të iniciojë koalicione parazgjedhore. Ata do të detyrohen të bashkëpunojnë dhe të sillen në mënyrë më të matur, që t'i fitojnë këto dy vende kryesore në komunën, kryetarin e komunës dhe kryetarin e Këshillit të komunës.
- 22) Përfaqësimi i drejtë i komuniteteve:** efikasiteti i procesit të decentralizimit objektivisht është i ngarkuar, me një sërë rrethanash të pavolitshme (moszhvillim ekonomik i komunave dhe të shtetit, probleme me funksionimin e parimit të sundimit të së drejtës, korrupsioni etj, probleme të cilat nuk janë vetëm lokale, por nacionale), dhe në këtë kontekst bashkësitë pakicë do të kenë më shumë arsye për të konsideruar se janë të marginalizuar (me të drejtë ose pa të drejtë), ose ndoshta të diskriminuar. Resurset shtetërore të cilat tani duhet të pësojnë rishpërndarje (edhe në komunat e mostrës sonë është evidente se një përqindje e madhe e punësimeve janë në sektorin publik), pritet që të jenë faktor shtesë për tensione. Prandaj është e nevojshme ngritja e vetëdijes publike sepse pa zhvillim ekonomik të shtetit e posaçërisht pa një zhvillim të njëjtë të komunave multietnike, shpërndarja (më)korrekte e resurseve shoqërore, do të shndërrohet në politikë zero-sum-game, në të cilën njëri humb e tjetri fiton, që patjetër do t'i keqësojë marrëdhëniet ndëretnike
- 23) Simboli:** Grupet etnike manifestojnë të drejtën e prestigjit, përmes shprehjes së simboleve (flamujve, mbishkrimeve, gjuhës etj.). Pasi që simbolet janë kod transparent i “prestigjit dhe vetërespektimit”, politika përveç tjerash, bëhet ritual në të cilin determinohet statusi i grupit. Për këtë fenomen mund të përdoret koncepti “alokacion autoritativ i prestigjit” ose “konflikt simbolik”. Që të shmanget “konflikti simbolik” i cili për shembull, në vitin 1997 në Gostivar përfundoi me gjakderdhje, është miratuar ligj për përdorimin e flamujve, në të cilin është saktësisht e përcaktuar procedura e theksimit të flamujve. Megjithatë, hulumtimi tregoi se një skajshmëri, çon në tjetrën dhe se ligji jo gjithmonë respektohet. Për shembull, gjatë krenimit të flamurit shqiptar, flamurit shtetëror maqedonas u theksua më vonë, nën presion të ashpër të publikut.
- 24) Politika gjuhësore:**
Gjuha e shënon statusin e grupit i cili e flet dhe e përfaqëson simbolin e dominimit. Grupi i cili lufton për prioritet, kërkon që gjuha e tij të fitojë “vend të drejtë” që do të thoshte të fitojë status ekskluziv. Kërkesat për status zyrtar janë indikacion tipik se disa njerëz kanë kërkesa legjitime për respekt më të madh, rëndësi dhe vlerë në

shoqëri, sesa që kanë disa të tjerë. Ashtu sikurse kërkesa për gjuhë zyrtare, demonstroi dëshirën për dominim, ashtu kërkesa për paritet gjuhësor është kod transparent për barabarësi në një kuptim më të gjerë të fjalës. Me Marrëveshjen kornizë të Ohrit shkohet në këtë kahe. “Gjuha tjetër të cilën e flasin të paktën 20% e qytetarëve është gjithashtu gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj”...”Në njësitë e vetëqeverisjes lokale gjuha dhe shkrimi që e përdorin së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik”. Kështu administrata bilinguale ekziston në komunat Gostivar, Kërçovë, Strugë dhe Dibër. Në komunë e Gostivarit edhe gjuha turke është gjithashtu gjuhë zyrtare.

Në këtë kontekst dëshirojmë të tërheqim vëmendjen për disa njohuri nga hulumtimi në lidhje me prapësinë prej 20% të cilin komuniteti turk dhe komunitetet tjera më të vogla e konsiderojnë si diskriminues dhe se i janë nënshtruar asimilimi. Vendimi për futjen e gjuhës zyrtare në komunat, të komuniteteve të cilat janë nën 20%, varet prej maqedonasve, që është gjithashtu një prej gjërave të palogjikshme të LVL. Gjegjësisht, në rast të një vendimi të këtyllë zbatohet shumica e Badenterit, respektivisht vetoja të cilën mund ta përdorin ose të mos e përdorin, shumica e përfaqësuesve të pakicave të Këshillit, e ata janë maqedonasit (Gostivar, Strugë dhe Dibër) dhe shqiptarët (Kërçovë), por jo edhe turqit ose romët të cilëve u referohet kjo e drejtë. Prandaj është e nevojshme, këto zgjidhje të vihen në pajtueshmëri me natyrën e Konventës kornizë të pakicave.

25) Pritjet dhe druajtjet: Ajo që e zatetëm në komunat gjatë hulumtimit, e që u tregua edhe në anketën e opinionit publik, është atmosfera e pritjeve dhe druajtjeve. Pritjet e shumicës së popullatës shqiptare se “punët përfundimisht do të shkojnë nga e mira” (para së gjithash lidhur me “përfaqësimin e drejtë”, zhvillimin ekonomik, punësimin, standardin), dhe druajtja të popullata maqedonase se tani si pakicë ata do të jenë të diskriminuar dhe do të gjenden në rrugë, pikërisht për shkak të asaj se janë maqedonas. Bashkësia turke ndjehet ngjashëm, ndërsa ajo rome është plotësisht e marginalizuar socialisht dhe politikisht. Vënia në funksion e mekanizmave të cilat do ta stimulojnë participimin efikas politik të pakicave, për të cilat ky hulumtim flet, mund që deri diku të ndihmojë në tejkalimin ose zbutjen e atmosferës së pasigurive dhe druajtjeve dhe t’i zvogëlojë mosmarrëveshjet eventuale ndëretnike. *Duhet të mbështeten të gjitha përpjekjet të cilat bëhen në rrafsh të ndryshme (BNjLV, forume politike dhe shkencore) që të ndërtojnë vetëdije se në një komunë multietnike, matura, durimi, mirëkuptimi dhe kompromisi janë shenja të paevitueshme të çdo procesi të vendimarrjes, pa marrë parasysh nëse gjithmonë dhe në çdo vend ekzistojnë mekanizma formalë, të cilat e mbrojnë komunitetin pakicë nga majorizimi.* Nënkuptohej ky është një proces dhe për të nevojitet kohë.

26) Projekti është i arsyeshëm? Do të thoshim, po. Qëllimi ynë ishte që të shohim se a jemi në rrugën e vërtetë, t’i regjistrojmë fillimet e një formule e cila tani për tani ofron paqe dhe nivel të lakmueshëm të stabilitetit në vendin tonë dhe e cila ndoshta do të shërbejë si përvojë e shteteve të ngjashme multietnike; t’i cekim mangësitë strukturore, institucionale dhe kulturore; të tërheqim vërejtjen për kahet eventuale të zhvillimit të modelit dhe praktikës. Shteti, nga ana e vet, gjithashtu patjetër të zhvillojë mekanizëm monitorimi dhe t’i shpall rezultatet ose të iniciojë organizatat shkencore dhe joqeveritare të zhvillojnë hulumtime të këtylla dhe të ngjashme.